***REPUBLIKA E SHQIPËRISË***
**KUVENDI**
**Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë**

*Dokument parlamentar*

Tiranë më, 3 tetor 2016

# RAPORT
# PËR PROJEKTLIGJIN
# "PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

## 1. HYRJE

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, i krijuar me vendimin nr. 96/2014, të Kuvendit të Shqipërisë, në përputhje me objektin e veprimtarisë së tij, realizoi analizën e gjendjes aktuale të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë dhe hartoi një dokument strategjik për objektivat e reformës në sistemin e drejtësisë, bazuar në analizën e gjendjes aktuale të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë. Bazuar në analizën e bërë, u propozua për miratim një paketë e plotë projektligjesh të nevojshme për reformimin e legjislacionit, që rregullon organizimin dhe funksionimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë, përfshirë ato kushtetuese. I gjithë ky proces është realizuar me kontributin dhe mbështetjen e institucioneve të sistemit të drejtësisë, ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, subjekteve të tjera të interesuara dhe opinionit publik.

Me vendimin nr.14, datë 30.07.2015, Komisioni i Posaçëm miratoi Dokumentin "Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri", dokument i cili përmbylli fazën e I-rë të procesit dhe përbën të parin dokument gjerësisht të konsultuar në publik që analizon mbi baza objektive, shkencore dhe profesionale, nga pikëpamja ligjore dhe zbatueshmërisë së ligjit, gjendjen aktuale të sistemit dhe të gjitha ato problematika që kanë prekur këtë sistem në drejtim të organizimit, funksionimit, mirëqeverisjes, efiçencës dhe administrimit të tij.

Komisioni i Posaçëm, me vendimin nr.15, datë 30.07.2015 miratoi në parim dokumentin "Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë" si dhe Planin e Veprimit për zhvillimin e strategjisë për reformimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, dokumente të cilat përmbyllën Fazën e II-të të procesit dhe që kanë zbërthyer në masa konkrete objektivat strategjikë të reformës në sistemin e drejtësisë, duke përcaktuar gjithashtu ligjet të cilat do t'i nënshtrohen ndërhyrjes në fazën e tretë të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm.

Faza e tretë e veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm, filloi me punën e grupit të ekspertëve të nivelit të lartë (vendas dhe ndërkombëtarë) për hartimin e ndryshimeve kushtetuese dhe një pakete projektligjesh, midis të cilëve dhe të projektligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

## 2. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT MË PARIMIN E KUSHTETUTSHMËRISË, QASJA ME AKTET NDËRKOMBËTARE, SI DHE ME PROGRAMIN E DOKUMENTAT POLITIKE TË REFORMËS NË DREJTËSI

Projektligji është në përputhje me ndryshimet kushtetuese të miratuara në datë 22 korrik 2016, konkretisht me nenet 135 - 147/ë të Kushtetutës. Ai respekton parimin e kushtetueshmërisë dhe standardet që vendosin aktet ndërkombëtare në lidhje me këtë fushë. Në frymën e tij dhe në përmbajtjen e tërësisë të dispozitave, ai reflekton parimet dhe është në përputhje me opioninet e Komisionit të Venecias.

Projektligji është në përputhje të plotë me "Strategjinë e Reformës në Sistemin e Drejtësisë", dhe me "Analizën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri", të cilat janë miratuar nga Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë.

Gjithashtu, projektligji është në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe ligjet e tjera në fushën e gjyqësorit. Ai është harmonizuar edhe me projektligje të tjera që po hartohen dhe do të miratohen në mbështetje dhe në zbatim të paketës kushtetuese.

Një komponent shumë i rëndësishëm i proçesit të hartimit të këtij projektligji ka qenë referimi dhe huazimi i standardeve ndërkombëtare dhe praktikave ligjore më të mira të vendeve të zhvilluara lidhur me statusin e gjyqtarëve dhe proikurorëve. Adoptimi i këtyre standardeve është një garanci jo vetëm për përmbushjen e aspiratave integruese të vendit drejt familjes evropiane, por në radhë të parë funksionimin e një sistemi drejësise në mënyrë efiçente, profesionale, të pavaruar të mundësuar nga gjyqtarë dhe prokurorë të emëruar, të ngritur në karrierë, me etikë dhe aftësi profesionale sipas standardeve europiane.

Hartimi i këtij ligji sipas standardeve dhe praktikave më të mira, duke i përshtatur ato me kontekstin në vendin tonë, është një fillim i mbarë drejt ngritjes së një sistemi gjyqësor të përafruar dhe të ngjashëm me ato sisteme që i përkasin vendeve me demokraci të konsoliduar.

Fusha që rregullon ky projektligj përfshihet në gërmën "e" të pikës 2 të nenit 81 të Kushtetutës sipas të cilës miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit "e*) ligji për statusin e funksionarëve publikë*". Për pasojë miratimi i këtij projektligji i nënshtrohet rregullit të miratimit me shumicë të cilësuar prej 3/5 (tre të pestat).

## 3. QËLLIMI DHE DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" përcakton statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të emërtuar ndryshme magjistratë si dhe statusin e ndihmës magjistratëve. Projektligji parashikon të drejtat dhe detyrimet e tyre, kriteret dhe

procedurën për pranimin dhe emërimin e tyre, për zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit të tyre, për vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të tyre si dhe kriteret dhe procedurën për përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Në thelb, statusi i gjyqtarëve dhe prokurorëve është një sistem garancish personale në funksion të pavarësisë dhe llogaridhënies së pushtetit gjyqësor. Garancitë ligjore për statusin e gjyqtarit lidhen kryesisht me mënyrën e emërimit të tyre, të menaxhimit të karrierës, garancitë për qëndrimin në detyrë (patundshmërinë), përveç rasteve dhe situatave të parashikuara qartë në ligj, si dhe lidhen edhe me përfitimet financiare dhe jo financiare të magjistratit gjatë ushtrimit të detyrës dhe pas përfundimit të detyrës. Ligji parashikon një sistem garantues të drejtash dhe llogaridhënie që synon ndërtimin e një sistemi drejtësie të pavarur ndaj çdo influence politike, të paanshëm, të përgjegjshëm, të drejtë e profesional, të besueshëm dhe të orientuar drejt shërbimit ndaj qytetarit.

Projektligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” përbëhet nga 6 Pjesë, të ndara në krerë dhe seksione, shpërndarë në 175 nene. Projektligji përmban përkufizime të koncepteve të ndryshme të përdorura në projektligj me qëllim shmangien e zbatimit jo korrekt dhe në mënyrë të njëjtë të tij. Kështu, projektligji përkufizon koncepte të tilla si: çështje pa palë ndërgjyqëse, dokument ligjor, funksion politik në administratën publike, gjyqtar relator, i emëruar, i diplomuar, koha mesatare e vendimit gjyqësor, magjistrat, ndihmësmagjistrat, periudha e vlerësimit, rendimenti i përfundimit të çështjeve, standardet minimale të afatit, veprimtari jashtë funksionit, vlerësues, vendimi jo përfundimtar, etj.

### 3.1 Nevoja për hartimin e projektligjit

Në Analizën e Sistemit të Drejtësisë janë identifikuar probleme që lidhen me të gjitha aspektet e statusit të gjyqtarit dhe prokurorit, duke filluar që nga emërimi, promovimi, vlerësimi, disiplinimi dhe trajtimi financiar i tyre. Konkretisht, bazuar mbi një analizë të detajuar të kuadrit ligjor në fuqi, për statusin e magjistratëve është vërejtur se:

- ✓ Dispozitat që rregullojnë statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve janë të shpërndara në akte ligjore, nënligjore të ndryshme dhe me natyrë rregullatore. Vërehet se mungon një ligj gjithëpërfshirës që të parashikojë në mënyrë të detajuar dispozitat për statusin e gjyqtarëve, si dhe të institucioneve përgjegjëse dhe procedurave që ndiqen në vendimmarrjet mbi këtë status.
- ✓ Parashikimet në fuqi lidhur me papajtueshmëritë specifike të funksionit të gjyqtarit dhe ndalimet ndaj tyre për të ushtruar veprimtari të caktuara publike e private janë shumë të përgjithshme. Ligji nuk parashikon shprehimisht, qartë dhe mjaftueshëm rastet që lidhen me veprimtaritë e ndaluara dhe të papajtueshme me funksionin e gjyqtarit.
- ✓ Kriteret dhe procedurat për emërimin si gjyqtar nuk janë parashikuar tërësisht nga ligji në përputhje me kërkesat e objektivitetit, meritokracisë, procesit të rregull ligjor dhe transparencën.
- ✓ Ka mangësi në legjislacionin dhe mekanizmin institucional lidhur me kriteret dhe procedurat e testimit dhe të verifikimit të domosdoshëm që duhet të zbatohen për pranimin në karrierë gjyqësore dhe emërimin si gjyqtar ose prokuror të atyre që, përjashtimisht, nuk i nënshtrohen trajnimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, si në aspektin e njohurive profesionale, ashtu edhe në drejtim të cilësive të nevojshme të personalitetit e të integritetit për t’i shërbyer publikut dhe posaçërisht për të ushtruar funksionin kushtetues të gjyqtarit.

- ✓ Mungon një mekanizëm efektiv, verifikues dhe ankimues ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë mbi emërimet e gjyqtarëve.
- ✓ Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë janë shoqëruar në vazhdimësi nga politizime të procesit dhe vonesa në plotësimin e vendeve vakante.
- ✓ Praktika ka evidentuar se procesi i konkurrimit për gjyqtarët administrativë nuk ka rezultuar në një sistem eficient dhe stimulues.
- ✓ Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për t'u emëruar në gjykatat e apelit vlerësohet se është bërë jashtë kritereve objektive.
- ✓ Ligji nuk parashikon shprehimisht, qartë dhe mjaftueshëm çështjet që lidhen kriteret, procedurat dhe kompetencat për vlerësimin profesional të gjyqtarëve. Nga ana tjetër, me ndonjë përjashtim, këto çështje përgjithësisht janë trajtuar me akte nënligjore të nxjerra nga vetë Këshilli i Lartë i Drejtësisë, gjë që nuk kënaq standardin e parashikimit nga ligji të çështjeve që lidhen me statusin e gjyqtarit.
- ✓ Ligji nuk parashikon shprehimisht, rregulla të mjaftueshme dhe të qarta për vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë lidhur me vlerësimin profesional të gjyqtarit si edhe të drejtën e gjyqtarit të vlerësuar për të ankimuar edhe në gjykatë vendimin e këtij Këshilli.
- ✓ Ligji nuk parashikon procedura të qarta dhe të mjaftueshme, objektive e transparente për krijimin, shpalljen dhe plotësimin e vendeve vakante në gjykata, të cilave Këshilli i Lartë i Drejtësisë duhet t'u përmbahet në procesin e plotësimit të vendeve vakante në gjykata *nëpërmjet transferimit* të gjyqtarëve të interesuar nga gjykatat e tjera të të njëjtin nivel.
- ✓ Transferimi i përhershëm i gjyqtarëve duket më problematik, shpesh ngatërrohet me promovimin. Kuadri ligjor nuk është i qartë në lidhje me kompetencat ndërmjet Ministrit të Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë për transferimin, procedurat standarde për përcaktimin e numrit optimal të gjyqtarëve për çdo gjykatë.
- ✓ Ligji nuk parashikon rregullime të mjaftueshme lidhur me kompetencën, rastet dhe kriteret mbi të cilat vlerësohet dhe vendoset për *delegimin e gjyqtarëve* për shqyrtimin e çështjeve të caktuara për një kohë të caktuar në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë rregullisht detyrën. Ligji nuk i parashikon afatet maksimale të delegimit dhe rastin e delegimit për caktimin e përkohshëm të gjyqtarit në funksione drejtuese.
- ✓ Ligji nuk parashikon shprehimisht se delegimi nuk mund të vendoset pa pëlqimin e gjyqtarit. Deri më sot KLD-ja nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur këtij aspekti të parimit të palëvizshmërisë së gjyqtarit nga detyra, i cili duhet të respektohet.
- ✓ Ligji nuk parashikon kompetenca dhe procedura të qarta dhe të mjaftueshme, objektive e transparente për rastet kur *transferimi i gjyqtarëve* duhet të bëhet edhe *pa pëlqimin e tij* për rrethana të lidhura me riorganizimin e gjykatave, sipas ligjit dhe në funksion të garantimit të shërbimit gjyqësor në territor dhe në lëndë gjyqësore.
- ✓ Ligji nuk parashikon shprehimisht, me rregulla të mjaftueshme dhe të qarta, se ngritja në detyrë ka të bëjë vetëm me rastet e “transferimit” të gjyqtarit nga detyra aktuale e tij në një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, në një gjykatë të fushës së veçantë të të njëjtit nivel, si dhe me rastet e caktimit të tyre në funksionet drejtuese të gjykatave.
- ✓ Vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë lidhur me ngritjen në detyrë të gjyqtarëve nuk janë subjekt i verifikimit të brendshëm administrativ dhe as i ankimit ndaj tyre në rrugë gjyqësore nga gjyqtarët e interesuar.

✓ Vërehet mbivendosje dhe paqartësi e konsiderueshme ndërmjet kompetencave të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe ministrit të Drejtësisë në lidhje me inspektimet e gjykatave, rishikimin e ankesave ndaj gjyqtarëve dhe procedimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve.

✓ Ligji aktual "Për pushtetin gjyqësor" përmban një klasifikim e renditje të pazakontë dhe konfuze të shkeljeve disiplinore, të cilat rezulton se nuk i përgjigjen dhe nuk i ndihmojnë synimit të parashikimit të përshkallëzuar, ezaurues e të qartë të shkeljeve disiplinore sipas llojit dhe rëndësisë së tyre.

✓ Praktika e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në zbatimin e masave disiplinore ka treguar se kufijtë ndërmjet shkeljeve të ndryshme disiplinore të parashikuara nga ligji nuk janë gjithmonë të qartë. Po kështu, duket se gama e sanksioneve disiplinore është relativisht e vogël dhe, si e tillë, nuk lejon gjithmonë përcaktimin e sanksioneve proporcionale.

✓ Ligji nuk bën dallimin dhe klasifikimin e nevojshëm ndërmjet shkeljeve disiplinore që kryhen gjatë ushtrimit të funksionit gjyqësor, jashtë funksionit gjyqësor dhe atyre që pasojnë/shoqërojnë kryerjen e veprës penale nga gjyqtari. Afati 5-vjeçar i parashkrimit nga dita e kryerjes së shkeljes është tepër i gjatë.

✓ Hetimi disiplinor është pjesërisht nën ombrellën e ekzekutivit dhe pjesërisht në kompetencën e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili ushtron funksionin e tij nën mbikëqyrjen e nënkryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Rregullat procedurale janë të dobëta dhe nuk janë në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare.

✓ Anëtarët e Gjykatës së Lartë nuk janë nën juridiksionin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për sa u përket çështjeve të procesit disiplinor. Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë janë subjekt i procedimit disiplinor vetëm për shkelje ekstreme, për të cilat gjen zbatim vetëm masa disiplinore ekstreme e shkarkimit nga detyra.

✓ Ligji nuk parashikon shprehimisht, qartë dhe mjaftueshëm çështjet që lidhen me rastet e mbarimit të karrierës gjyqësore, si çështje thelbësore të lidhura me parimin e palëvizshmërisë së gjyqtarit nga detyra. Ligji nuk parashikon veprimet dhe procedurat që duhet të ndiqen në raste të caktuara të mbarimit të mandatit të gjyqtarit.

✓ Sistemi i pagave, shpërblimeve dhe të kujdesit social e shëndetësor të gjyqtarëve, si një nga mjetet për garantimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së tyre në detyrë, nuk i përgjigjet domosdoshmërisë së trajtimit financiar të përshtatshëm dhe dinjitoz të tyre.

✓ Ligji nuk ofron kushte, mënyra dhe mjete efektive që të garantojnë sigurinë e gjykatave dhe sigurinë e gjyqtarëve, me qëllim mbrojtjen nga shteti të jetës dhe pasurisë së tyre dhe të familjes kundrejt presioneve, kërcënimeve dhe akteve të dhunës që mund të vijnë për shkak të ushtrimit të detyrës, në ambientet e gjykatës dhe jashtë saj.

✓ Ligji për pushtetin gjyqësor nuk parashikon shprehimisht kushtet e posaçme të ushtrimit të së drejtës së gjyqtarit për të kërkuar shkëputje dhe leje të pagueshme për motive të ndjekjes së programeve të profilizimit profesional brenda dhe jashtë vendit, për përgatitjen dhe mbrojtjen e gradave shkencore, si edhe të lejeve të pa pagueshme për motive të caktuara.

***Përsa i përket statusit të prokurorëve, nga analiza e kryer, u vu re se:***

✓ Emërimet, në veçanti ato jashtë Shkollës së Magjistraturës, si dhe vendimet lidhur me prokurorët e karrierës nuk janë udhëhequr gjithmonë nga kritere objektive dhe procedura transparente. Vendimet e transferimit të prokurorëve nuk janë të bazuara në kritere të mirë - përcaktuara.

- ✓ Vlerësimi paraprak i punës së prokurorit kryhet nga drejtuesi i prokurorisë. Nuk ka një procedurë të standardizuar vlerësimi, të shoqëruar me kriteret specifike për matjen e aftësive, kompetencës dhe integritetit. Gjithashtu, nuk ofrohet mundësia për të ankimuar rezultatet e vlerësimit ose vendimin e emërimit.
- ✓ Emërimi i drejtuesve të prokurorive mund të kryhet nga Prokurori i Përgjithshëm, në bazë të kritereve të përgjithshme. Shkarkimi i tyre në bazë të mos përmbushjes së detyrave funksionale, pavarësisht rëndësisë së tyre dhe nuk parashikon mundësinë e apelimit kundër vendimit përkatës të shkarkimit.
- ✓ Mungojnë kriteret objektive dhe procedurat transparente në lidhje me vendimin e emërimit, karrierës, promovimit dhe disiplinimit të prokurorëve.
- ✓ Ka mungesë llogaridhënie të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.
- ✓ Mungojnë mekanizmat efikas të llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë, për të shmangur ndërhyrjen e papërshtatshme në veprimtarinë e prokurorisë.

## 3.2 Rezultatet e pritshme të zbatimit të projektligjit

Bazuar në problematikat e evidentuara dhe të analizuara në Dokumentin e Analizës së Sistemit të Drejtësisë, projektligji parashikohet të sjellë disa efekte të pritshme:

- ✓ Qartëson, përmirëson, konsolidon dhe përmbledh në një ligj të vetëm duke kodifikuar dispozitat e shpërndara që lidhen me statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve.
- ✓ Garanton një proces emërimi dhe promovimi të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të bazuar në kritere transparente, objektive dhe meritokratike të tilla si: kualifikimet, integriteti, aftësitë profesionale dhe pastërtia që do të rezultojë nga procesi i vlerësimit dhe rivlerësimit.
- ✓ Rikoncepton sistemin e trajnimit vazhdues dhe të vlerësimit periodik të gjyqtarëve dhe prokurorëve për efekt karriere, duke zgjeruar e forcuar më tej kriteret objektive për matjen e aftësisë profesionale, si dhe duke konceptuar e zbatuar kritere dhe teste për matjen e integritetit moral e psikologjik të tyre.
- ✓ Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë përfshihen në skemën e vlerësimit dhe të përgjegjësisë disiplinore.
- ✓ Qartëson dhe detajon të gjitha shkeljet disiplinore të kryera nga gjyqtarët dhe prokurorët dhe sanksionet proporcionale në përputhje me shkeljet, duke e orientuar sistemin e përgjegjësisë disiplinore mbi kritere sa më objektive.
- ✓ Procedimi disiplinor rikonceptohet si një sistem garantues ku janë të ndara përgjegjësitë e institucioneve që kryejnë hetimin, institucioneve që marrin vendimin dhe institucioneve që shqyrtojnë ankimin e ushtruar ndaj vendimeve për masat disiplinore, duke i garantuar magjistratit në të gjitha hallkat e kësaj procedure, të drejtën për një proces të rregullt.
- ✓ Përcakton në mënyrë të detajuar procedurat që sigurojnë përzgjedhjen e kandidatëve për magjistratë (gjyqtarë dhe prokurorë) dhe konfirmimin e tyre në karrierë, duke u bazuar në kritere objektive e transparente.
- ✓ Përcakton në mënyrë të qartë dhe të plotë të drejtat, detyrimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe papajtueshmëritë me ushtrimin e funksionit.

✓ Përmirëson në mënyrë rrënjësore trajtimin financiar mes rritjes së pagës dhe përfitimeve të tjera financiare.

✓ Ofron garancitë e nevojshme për magjistratët dhe ndihmës magjistratët të cilët janë në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, dhe që kalojnë me sukses procesin e vlerësimit të pasurisë dhe të figurës dhe rivlerësimit.

## 4. RISITË KRYESORE TË PROJEKTLIGJIT

Disa nga risitë e këtij projektligji, të cilat synojnë të adresojnë dhe zgjidhin problematikat e evidentuara në Analizën e Sistemit të Drejtësisë dhe të trajtuara më lart paraqiten si vijon:

### 4.1 Vlerat themelore, të drejtat dhe detyrimet e përgjithshme

Projektligji parashikon ato që quhen vlera themelore mbi bazën e të cilave duhet të mbështetet e gjithë veprimtaria e magjistratëve, të tilla si: ushtrimi i funksionit, në zbatim me Kushtetutën dhe ligjin; ushtrimi i funksionit në mënyrë të pavarur, duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin sipas bindjes së tij të brendshme, i lirë nga çdo ndikim i drejtëpërdrejtë ose i tërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye; ndalimi për të krijuar lidhje e kontakte të papërshtatshme dhe nuk duhet të ndikohet nga pushteti ekzekutiv ose nga pushteti legjislativ; ushtrimi i funksioneve gjyqësore në mënyrë të paanshme, pa ndikim dhe pa paragjykime, ushtrimi i funksionit me drejtësi, në mënyrë korrekte, në kohë të arsyeshme, të ndërgjegjshme, të kujdesshme, të zellshme dhe sistematike, me objektivitet, vetëpërmbajtje dhe maturi.

Projektligji parashikon shprehimisht standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së magjistratit duke e ngarkuar shprehimisht atë me detyrimin për të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtaritë e kryera edhe kur magjistrati nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare. Magjistrati merr të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar dinjitetin dhe standardet e funksionit të tij, reputacionin e organeve të drejtësisë dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe atë të prokurorisë si dhe statusin e funksionit të magjistratit.

### 4.1 Rekrutimi i kandidatëve magjistratë

Në disa vende, proçesi i rekrutimit dhe emërimit të magjistratëve bazohet në rezultatet e arritura nga një proces konkurrues, ndërsa në vende të tjera ky proçes kryhet nëpërmjet përzgjedhjes nga radhët e praktikantëve me përvojë të ligjit. Projektligji synon të kombinojë të dyja këto sisteme rekrutimi. Ai përcakton në mënyrë të detajuar procedurat që sigurojnë përzgjedhjen e kandidatëve për magjistratë (gjyqtarë dhe prokurorë) dhe konfirmimin e tyre në karrierë, duke u bazuar në kritere objektive e transparente.

Duke qenë se standardet ndërkombëtare rekomandojnë se personat që janë përgjegjës për trajnimin nuk duhet të jetë drejtpërdrejtë përgjegjës për emërimin ose promovimin e gjyqtarëve[1], projektligji parashikon se trajnimi dhe konkursi është një detyrë që i takon Shkollës së Magjistraturës, ndërsa emërimi i magjistratëve, respektivisht i takon Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

#### 4.1.1 Kandidimi dhe pranimi në formimin fillestar

[1] Opinioni nr. 4 i CCJE, mbi trajnimin e duhur fillestar dhe vazhdues të gjyqtarëve në nivlel kombëtar dhe Europian.

Pranimi i kandidatëve në Shkollën e Magjistraturës si dhe emërimi i tyre do të bazohet në kritere transparente, objektive dhe meritës si: kualifikimet, integriteti, aftësitë profesionale, pastërtia e gjendjes gjyqësore (mungesa e precedentëve penalë), disiplina në ushtrimin e funksionit (mungesa e një mase disiplinore), mosqënia anëtar i një partie politike në kohën e kandidimit, mosqënia anëtar i Sigurimit të Shtetit përpara vitit 1990, si dhe verifikimi i pasurisë dhe figurës etj.
Procesi i pranimit në Shkollën e Magjistraturës sjell disa risi nga procesi i tanishëm të cilat mund të përmblidhen si vijon: a) afate të mjaftueshme dhe që fillojnë shumë kohë më parë se fillimi i formimit fillestar si dhe procedura transparente të publikimit të thirrjes për aplikim; b) kritere të mirëpërcaktuara të vlerësimit paraprak; c) koha e zhvillimit të provimit të pranimit ndryshon; d) parashikimi i vlerësimit të pasurisë dhe të figurës; e) e drejta për të kandiduar vetëm kur personi ka të paktën tre vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë në profesion në sektorin publik ose privat ose në organizatat ndërkombëtare.
Projektligji parashikon rregulla të qarta dhe të hollësishme për procesin e thirrjes së kandidaturave për formimin fillestar nga Shkolla e Magjistraturës, pasi Këshillat kanë përcaktuar numrin maksimal të kandidatëve; kryerjen e vlerësimit paraprak mbi përmbushjen e kritereve të kandidimit (duke marrë në konsideratë komentet ose kundërshtimet e Këshillave); miratimin e publikimin e raportit të vlerësimit përfundimtar; organizimin e provimit për pranimin në formimin fillestar; si dhe hartimin dhe publikimin e listës së renditjes së kandidatëve sipas rezultateve të provimit.

Sikurse është theksuar edhe më lart, projektligji sjell si risi verifikimin e pasurisë së kandidatit për të filluar formimin fillestar dhe pas diplomimit të tij në Shkollën e Magjistraturës, para kandidimit për emërim. Verifikimi i pasurisë dhe figurës për kandidatët me rezultatet më të larta që mund të pranohen në formimin fillestar, do të bëhet nëpërmjet bashkëpunimit mes Këshillave dhe institucioneve të tjera të përcaktuara në ligj. Periudha e mjaftueshme që nga momenti i shpalljes së publikimit për kandidim deri në fillimin e programit të formimit fillestar mundëson një përzgjedhje të kandidatëve me integritet dhe mundëson verifikimin e pasurisë.

Praktika profesionale e kandidatëve për magjistratë, në vitin e tretë të formimit fillestar, me një kohëzgjatje 12 muaj, në gjykatat dhe në prokuroritë e përcaktuara nga këshillat bazohet në tregues të tillë si: disponueshmëria e gjyqtarëve dhe prokurorëve udhëheqës; infrastruktura e gjykatës dhe të prokurorisë; disponueshmëria e hapësirës dhe mjediseve të punës për kandidatët magjistratë; dhe, mundësia për t'u njohur me një numër të madh ligjesh dhe shumëllojshmëri çështjesh gjatë praktikës profesionale. Në projektligj parashikohet trupa e magjistratëve udhëheqës gjatë praktikës profesionale, të cilët do të caktohen nga këshillat mbi bazën e kritereve të tilla si: përvoja, rezultatet e vlerësimit etik dhe profesional, rezultatet e trajnimit udhëheqës, disiplina në ushtrimin e funksionit si dhe respektimi i afateve ligjore për hetimin ose gjykimin e çështjeve.

### 4.1.2 Emërimi i kandidatit magjistrat të diplomuar

Emërimi i magjistratit të diplomuar bëhet duke u bazuar në kritere si: diplomimi në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me të paktën 70 përqind të pikëve maksimale të mundshme; vlerësimi minimalisht mirë për të gjitha detyrat e dhëna gjatë praktikës profesionale

që zhvillohet në vitin e tretë të formimit fillestar; dhe rikalimi i verifikimit të pasurisë dhe figurës.

Në projektligj parashikohen rregulla të hollësishme dhe afate për emërimin nga ana e Këshillave të kandidatit magjistrat të diplomuar duke nisur nga marrja e ftesës, kërkesës më shkrim drejtuar Këshillit lidhur me preferencën për emërimin për gjyqtar apo prokuror, dhe gjykatën apo prokurorinë në të cilën kërkon të emërohet. E njëjta procedurë emërimi parashikohet edhe për emërimin magjistrat për ish gjyqtarët dhe ish prokurorët të cilët duhet të përmbushin të gjitha kriteret e sipërpërmendura për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës si dhe dy kritere të tjera shtesë si: a) të jenë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës dhe të kenë ushtuar funksionin e magjistratit për të paktën 5 vjet në 15 vitet e fundit; b) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 viteve të fundit përpara kërkesës për riemërim si magjistrat.

### 4.1.3 Formimi vazhdues i magjistratëve

Projektligji rikoncepton sistemin e trajnimit vazhdues dhe të vlerësimit periodik të gjyqtarëve dhe prokurorëve për efekt karriere, duke zgjeruar e forcuar më tej kriteret objektive për matjen e aftësisë profesionale, si dhe duke konceptuar e zbatuar kritere dhe teste për matjen e integritetit moral e psikologjik të tyre.

Për sa më sipër, parashikohet e drejta dhe detyrimi i magjistratit për të marrë pjesë në programet e formimit vazhdues, kur ato janë të përshtatshme për funksionin e tij dhe të organizuara dhe çertifikuara nga Shkolla e Magjistraturës ose nga çdo institucion trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar të njohur nga Këshilli.

## 4.2 Statusi i magjistratëve dhe veprimtarita e tyre

### 4.2.1 Statusi i gjyqtarëve dhe prokurorëve rregullohet në një ligj të vetëm

Projektligji qartëson, përmirëson, konsolidon dhe përmbledh në një ligj të vetëm të gjitha rregullat duke kodifikuar dispozitat e shpërndara që lidhen me statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Projektligji rregullon statusin e magjistratëve duke parashikuar: të drejtat dhe detyrimet e tyre; kriteret dhe procedurën për pranimin dhe emërimin e tyre; kriteret dhe procedurën për zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit të tyre; kriteret dhe procedurën për vlerësimin etik dhe profesional të tyre; kriteret dhe procedurën për përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile të tyre.

### 4.2.2 Papajtueshmëria dhe kufizimi i veprimtarive të tjera

Në projektligj përcaktohen qartë dhe në mënyrë të plotë parimet të cilat udhëheqin ushtrimin e funksionit të magjistratit[2], të drejtat, detyrimet e magjistratëve, duke përmbushur standardet europiane të përcaktuara në rekomandimin e Këshillit të Europës, të vitit 2010. Dokumentat

[2]Rekomandimi CM/Rec (2010) 12 i Komitetit të Ministrave.

ndërkombëtare rekomandojnë që të gjendet një ekuilibër i arsyeshëm midis aktiviteteve përtej funksionit dhe parimit të paanshmërisë.[3]

Projekligji parashikon si të papajtueshëm me funksionin e magjistratit: **anëtarësimin në parti politike si dhe pjesëmarrjen në veprimtari politike** të organizuara nga një parti politike; kryerjen e çdo veprimtarie politike, pavarësisht nëse veprimtaria kryhet në bashkëpunim me ndonjë parti politike ose jo, që mund të ndikojë në pavarësinë e magjistratit, të krijojë ndonjë konflikt interesi ose, në çdo rast, të krijojë përshtypjen që magjistrati është i paanshëm dhe i pandikuar.

Projektligji parashikon si **kufizime për shkak të funksionit**: publikimin e të dhënave ose informacioneve për çështjet që i janë caktuar; publikimin e mendimeve të dhëna gjatë hetimeve ose seancave gjyqësore; si dhe, deklarimet në publik që mund të krijojnë përshtypjen mbi njëanshmërinë e tij në një çështje të caktuar. Magjistrati e ka të ndaluar të marrë pjesë në grevë.

Projektligji ka parashikuar për herë të parë konceptin e **papajtueshmërisë ambjentale**, pra rastet e papajtueshmërisë që krijohen për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile si dhe përcakton rregullat me qëllim shmangien e tyre dhe zgjidhjen e situatave të tilla me përparësi.

Projektligji ka parashikuar ndalimin e ushtrimit të funksionit të magjistratit në një gjykatë ose prokurori, nëse një magjistrat tjetër me të cilin/cilën ka lidhje të ngushta familjare ushtron funksionin respektivisht në të njëtjën gjykatë ose prokurori; në një Gjykatë Administrative të Shkallës së Parë nëse një gjyqtar tjetër me të cilin/cilën ka lidhje të ngushta familjare ushtron funksionin në Gjykatën Administrative të Apelit, si dhe anasjelltas; në seksionin civil të gjykatës së zakonshme të shkallës së parë nëse një gjyqtar tjetër me të cilin/cilën ka lidhje të ngushta familjare ushtron funksionin në seksionin civil të gjykatës së apelit, që ka nën juridiksion gjykatën e zakonshme të shkallës së parë, si dhe anasjelltas; në seksionin penal të gjykatës së zakonshme të shkallës së parë dhe në prokurorinë në juridiksion të kësaj gjykate, nëse një magjistrat tjetër me të cilin/cilën ka lidhje të ngushta familjare ushtron funksionin në prokurorinë pranë gjykatës së apelit ose në seksioni penal të gjykatës së apelit, që ka nën juridiksion gjykatën dhe prokurorinë e shkallës së parë, si dhe anasjelltas.

Në Gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme nëse një magjistrat tjetër me të cilin/cilën ka lidhje të ngushta familjare ushtron funksionin në këto struktura. Të gjitha këto përcaktime janë të lidhura ngushtësisht me problematikën e evidentuar në praktikën e deritanishme.

Në projektligj janë parashikuar kritere të qarta mbi **veprimtaritë që mund të kryejë magjistrati jashtë funksionit** si dhe rregulla të hollësishme mbi ushtrimin e tyre. Magjistrati lejohet të kryejë veprimtari jashtë funksionit, vetëm nëse këto veprimtari janë në përputhje me dinjitetin e ushtrimit të funksionit, nuk krijojnë perceptime të ndikimit ose njëanshmëri gjatë ushtrimit të funksionit, nuk bien ndesh me interesat thelbësorë të funksionit, duke mos cënuar afatet dhe ushtrimin në mënyrë efiçiente të funksioneve. Në çdo rast veprimtaritë jashtë

[3] Opinion nr. 3 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (CCJE) (2002), mbi rregullat dhe parimet që normojnë sjelljen profesionale të gjyqtarëve, në veçanti etikën, paanshmërinë dhe papajtueshmërinë me detyrën.

funksionit të paguara, duke përfshirë dhe punën përgatitore për realizimin e kësaj veprimtarie, nuk i kalojnë 200 orë gjatë dhe jashtë orarit të punës për vit; nuk bien ndesh me qëllimin për të cilin është ulur ngarkesa e punës; në rast se shpërblimi për veprimtaritë jashtë funksionit përfshin çdo lloj dhe forme pagese, shpërblim financiar ose kompensimi, të cilat nuk i tejkalon rregullat e zakonshme të tregut; nuk janë të papajtueshme me ushtrimin e funksionit të magjistratit dhe nuk ndalohen sipas këtij ligji.

Projektligji parashikon **lirinë e organizimit dhe të shprehjes** në mënyrë të tillë që u njeh të drejtën magjistratëve të themelojnë shoqata ose organizata, të marrin pjesë në to me qëllim për të mbrojtur të drejtat dhe interest e tyre ose duke synuar ngritjen e tyre profesionale. Shoqata ose organizata e magjistratëve në ushtrimin e aktivitetit nuk duhet të bien ndesh me kompetencat e institucioneve te drejtësisë.

### 4.2.3 Emërimi dhe promovimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në kritere transparente, objektive dhe meritës

Projektligji garanton një proces emërimi dhe promovimi të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të bazuar në kritere transparente, objektive dhe meritës të tilla si: kualifikimet, integriteti, aftësitë profesionale dhe pastërtia që do të rezultojë nga procesi i vlerësimit dhe rivlerësimit.

***Caktimi në pozicione i magjistratit të emëruar dhe caktimi i përkohshëm***

Në ndryshim nga kuadri ligjor ekzistues, projektligji rregullon në mënyrë të detajuar caktimin e magjistratëve në pozicionet e lira, mbas diplomimit dhe emërimit të tyre si magjistrat. Caktimi në pozicione i të emëruarve të sapodiplomuar në Shkollën e Magjistraturës, vlerësohet parësor dhe bazohet në renditjen e tyre në listën e të diplomuarve dhe përmbushjen e preferencave të deklaruara nga të diplomuarit në formimin fillestar. Në këtë mënyrë, merr fund praktika e lënies pa punë të magjistratëve të diplomuar, një problem i hasur në praktikë. Projektligji rregullon caktimin e përkohshëm në pozicione të komanduara

***Transferimi i magjistratëve***

Transferimi është rregulluar në mënyrë të detajuar në projektligj. Në projektligj jepet kuptimi i “transferimit”, rastet dhe pozicionet ku një magjistrat mund të transferohet. Sipas projektligjit, magjistrati nuk transferohet pa pëlqimin e tij, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në projektligj; magjistrati nuk transferohet pa pëlqim në gjykata të një shkalle më të ulët se gjykata në të cilën magjistrati ushtron funksionet.

Projektligji parashikon në mënyrë shteruese rastet përjashtimore të transferimit të magjistratëve pa pëlqimin e tyre, për shkaqe disiplinore, për shkaqe që lidhen me suprimimin e pozicionit të magjistratit si rezultat i ndryshimeve në strukturën administrative ose në kompetencën tokësore të gjykatave ose prokurorive, bazuar në kritere objektive dhe transparente, për shkak të krijimit të marrëdhënieve familjare që çojnë në papajtueshmëri ambientale ose për shkak të mungesave të përkohshme të magjistratëve në gjykata dhe prokurori. E drejta e të emëruarit për të ankimuar vendimin e caktimit në pozicion njihet në ligj.

*Procedura e lëvizjes paralele*

Projektligji rregullon në mënyrë të detajuar rastet kur mund të hapet procedurat e lëvizjes paralele, kriteret ligjore që duhet të përmbushë magjistrati; rastet e ndalimit të përfshirjes në procedurë të lëvizjes paralele për anëtarët e Këshillave gjatë kohës së ushtrimit të funksionit si antër ose edhe pas tre viteve tnga mbarimi i mandatit; procedura e shqyrtimit të kërkesave nga Këshillat.

*Skema e delegimit*

Një nga format e emërimit është shërbimi i magjistratit me të paktën një vit përvojë në funksion të shërbejë në skemën e delegimit në një gjykatë ose prokurori ose të shërbejë në strukturat administrative të Këshillave, ndërkohë që është në pritje për t'u caktuar.

*Ngritja në detyrë e magjistratit*

Ngritja në detyrë është një element i rëndësishëm i promovimit në karrierë. Projektligji përcakton kritere të qarta dhe transparente për përmbushjen e kritereve minimale përsa i përket përvojës profesionale që duhet të këtë magjistrati në rast të ngritjes në detyrë.

Sipas projektligjit pozicionet në Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme dhe Gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar[4], plotësohen nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, duke parashikuar ndër të tjera rregulla për kryerjen e kësaj procedure nga ana e këshillave.
Projektligji ka parashikuar kritere objektive profesionale dhe merite që duhet të ketë magjistrati për tu ngritur në detyrë, a) për pozicionin gjyqtar në Gjykatën e posaçme të shkallës së parë për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar; b) për pozicionin gjyqtar apeli në Gjykatën e posaçme të apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar; c) për pozicionin prokuror në Prokurorinë e Posaçme.

*Emërimi i kandidatëve jo gjyqtarë në Gjykatën e Lartë*

Sipas nenit 136, paragrafi 3 të Kushtetutës, një e pesta e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, mund të përzgjidhen mes juristëve të spikatur, që kanë gradë shkencore në drejtësi, me jo më pak se 15 vjet[5] përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, jurist të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Në përputhje me kriteret ligjore kushtetuese, projektligji parashikon kritere shtesë dhe mënyrën e vlerësimit të përmbushjes së tyre.

[4] Shiko Nenin e 47(7) të këtij ligji duke kërkuar që lëvizja paralele në gjykatat administrative të apelit janë të hapura vetëm për gjyqtarët të cilë kanë të paktën një eksperiencë 5 vjeçare si gjyqtar i gjykatës administrative.
[5] Neni 136(3) i Kushtetutës

Vlerësimi i aftësive profesionale të kandidatit që plotëson kriteret ligjore bëhet nga Këshilli. Edhe kandidatët jogjyqtarë i nënshtrohet vlerësimit të aftësive profesionale, të pasurisë dhe figurës. Moskalimi me sukses njërit prej këtyre vlerësimeve ndalon kandidimin.

***Zgjedhja/ emërimi i kryetarëve të gjykatave***

Projektligji sjell një ndryshim rrënjesor lidhur me zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës së Lartë dhe të kryetarit të saj. Ndryshe nga deri tani, që kryetari i Gjykatës së Lartë emërohet nga Presidenti i Republikës me pëlqim të Kuvendit, projektligji parashikon se kryetari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga mbledhja e përgjithshme e Gjykatës, me një mandat 3 vjeçar, pa të drejtë rizgjedhje, nga mandati 9 vjeçar që ka aktualisht.
Mandati i kryetarëve të gjykatave dhe prokurorive të tjera, me përjashtim të prokurorit të Përgjithshëm është 3 vjet me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë. Mandati i kryetarit të Prokurorisë së Posaçme është 3 vjet pa të drejtë rizgjedhje.

***Komandimi i magjistratëve***

Projektligji parashikon parimet e komandimit të magjistratëve në një pozicion jo magjistrati.
Projektligji parashikon se pozicioni duhet të jetë brenda sistemit të drejtësisë dhe të jetë i pajtueshëm me pavarësinë dhe mbajtjen e statusit të magjistratit.

Në ligj listohen institucionet ku komandohet magjistrati si: Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, ose Prokuroria e Përgjithshme; për pozicionet si inspektorë është Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; dhe për pozicione të tjera janë Këshillat, Ministria e Drejtësisë, Avokatura e Shtetit, Shkolla e Magjistraturës, ose çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë. Për interes publik dhe kur nuk cënohen afatet e ushtrimit në mënyrë efeicente të funksioneve, kërkesa për komandim mund të paraqitet nga institucione të tjera. Projektligji parashikon të drejtat dhe detyrimet e njëjta të magjistratit të komanduar, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në këtë ligj. Komandimi bëhet për një periudhë të caktuar jo më shumë se 5 vjet me të drejtë.

***Caktimi i përkohshëm i magjistratit***

Projektligji rregullon caktimin e përkohshëm të magjistratit në pozicione të përkohshme të krijuara për arsye të ndryshme. Ligji parashikon rastet e plotësimit të përkohshëm të pozicionit dhe rregullat sesi veprohet nëse ka më shume se një magjistrat që dëshiron këtë pozicion. Caktimi i përkohshëm është kompetencë e Këshillit.

Ai parashikon gjithashtu rregulla në lidhje me mandatin e kufizuar e që kanë të bëjnë me caktimin e përkohshëm, të drejtën e kthimit, kufizimin e mandatit me ligj, të drejtën për t'u caktuar në nivel apeli, mbarimi i mandatit të Kryetarit.

## 4.3 Vlerësimi i magjistratëve dhe promovimi në karrierë

Bazuar në Opinionin e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë, nr. 17 (2014) *"Mbi Vlerësimin e Punës së Gjyqtarëve, Cilësinë e Drejtësisë, dhe Respektin për Pavarësinë e*

*Gjyqësorit"*, në projektligj parashikohet një sistem promovimi për magjistratët, bazuar në kritere objektive të tilla si aftësitë profesionale, integriteti dhe përvoja e punës.

***Parimet e procesit të vlerësimit***

Sikurse standardet ndërkombëtare rekomandojnë[6], projektligji parashikon se ky sistem vlerësimi do të bazohet mbi parimet e pavarësisë, meritokracisë, efikasitetit, parimi i procesit të rregullt ligjor, i konfidencialitetit.

Parimi i pavarësisë, sipas të cilit procesi i vlerësimit nuk duhet të ndërhyjë në pavarësinë e magjistratit; parimi i meritokracisë dhe i zhvillimit të karrierës, sipas të cilit vlerësimi i veprimtarisë së magjistratit kryhet duke i dhënë rëndësinë më të madhe vlerave profesionale dhe cilësisë në punë, në funksion të zhvillimit të karrierës profesionale; parimi i efikasitetit, sipas të cilit vlerësimi i veprimtarisë kryhet nëpërmjet një procesi të shpejtë, me anë të procedurave të thjeshta dhe në afate kohore të arsyeshme për të siguruar të dhëna në kohën e duhur për karrierën e magjistratit; parimi i procesit të rregullt ligjor, sipas të cilit në procedurën e vlerësimit respektohen standardet e procesit të rregullt ligjor për magjistratin, duke përfshirë të drejtën për t'u njohur me aktet, të drejtën e aksesit në dosjen e vlerësimit, të drejtën për të marrë pjesë në proces, të drejtën e kontradiktoritetit, të drejtën për t'u dëgjuar, të drejtën për t'u mbrojtur, të drejtën për të pasur një akt vlerësimi të arsyetuar dhe të drejtën për t'u ankuar mbi aktin e vlerësimit; parimi i konfidencialitetit, sipas të cilit subjektet e ngarkuara me detyrën e vlerësimit janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave të magjistratit që vlerësohet, si dhe të dhënat e tij personale sipas legjislacionit në fuqi.

***Qëllimet dhe dobishmëria e vlerësimit***

Sistemi i vlerësimit synon:
a) Të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë profesionale dhe etike të magjistratëve;
b) Të vendosë standarde të qëndrueshme për cilësinë dhe sasinë e veprimtarisë së magjistratëve
c) Rezultatet e vlerësimit orientojnë Këshillat lidhur me vendimet për statusin e magjistratit, në funksion të zhvillimit të karrierës bazuar mbi meritat;
d) Të orientojnë Këshillat dhe Shkollën e Magjistraturës në lidhje me nevojat për trajnim të magjistratëve dhe për të lehtësuar planifikimin e trajnimit të tyre;
e) Të identifikojë magjistratët që mund të kenë aftësi të veçanta profesionale për sistemin e drejtësisë;
f) Të kontribuojë në përmirësimin e strukturës organizative të gjykatave dhe prokurorive, ashtu si dhe të kushteve të punës të magjistratëve.

Projektligji parashikon rregulla për vlerësimin etik dhe profesional për të gjithë magjistratët, përfshirë kryetarët e gjykatave dhe prokurorive. Periudha e vlerësimit parashikohet të jetë një herë në tre vjet, gjatë pesëmbëdhjetë viteve të para të përvojës profesionale, përfshirë edhe përvojën profesionale si ndihmës magjistrat ose magjistrat i komanduar; një herë në pesë vjet, pas 15 viteve të para të përvojës profesionale si magjistrat.

---

[6]Opinioni i CCJE nr. 17 (2014), Mbi Vlerësimin e Punës së Gjyqtarëve, Cilësinë e Drejtësisë, dhe Respektin për Pavarësinë e Gjyqësorit, par. 27.

Kryetari vlerësohet të paktën një herë gjatë kohëzgjatjes së mandatit si kryetar. Në çdo rast, veprimtaria e kryetarit vlerësohet nga Këshilli të paktën gjashtë muaj para përfundimit të këtij mandati. Magjistrati i cili ushtron funksionin si anëtar i një Këshilli, nuk vlerësohet sipas parashikimeve të këtij ligji. Këshilli miraton rregulla të detajuara për vlerësimin e veprimtarisë gjatë funksionit në Këshill. Në rast të kandidimeve për transferim dhe ngritje në detyrë tre vjet pas këtij funksioni, Këshilli merr në konsideratë veprimtarinë e magjistratit gjatë funksionit si anëtar i Këshillit.

***Procedura e fillimit të vlerësimit***

Projektligji ka parashikuar një procedurë të detajuar sa i takon fillimit të procedurës së vlerësimit, e cila nis me miratimin nga ana e Këshillit të programit që përcakton listën e magjistratëve dhe kryetarëve për të cilët do të kryhet vlerësimi i veprimtarisë, njoftimi i tij, vetëvlerësimi etik dhe profesional, mendimi i kryetarit të gjykatës ose prokurorisë mbi veprimtarinë e magjistratit, dërgimi i akteve të vlerësimit të Kryetarit në Këshill. Ecuria e procesit të vlerësimit vijon me përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm lidhur me periudhën e vlerësimit, krijimin e dosjes së vlerësimit nga ana e administratës së Këshillit, përzgjedhja me short e çështjeve për vlerësim, përfshirja në dosjen e vlerësimit të informacionit nga institucione të tjera, hartimi nga relatori i projekt raportit të vlerësimit. Gjatë procedurës së vlerësimit të magjistratit në Këshill, ai ka të drejtë të aksesojë dosjen e vlerësimit, të paraqesë prova, të dëgjohet dhe të kundërshtojë projektraportin e vlerësimit.
Projektligji parashikon mundësinë dhe procedurën e vlerësimit të magjistratit më kërkesë të tij në rastet kur kërkohet të transferohet ose ngrihet në detyrë dhe kur vlerësimi i fundit është realizuar para më shumë se dy viteve.

***Subjektet e vlerësimit***

Projektligji parashikon si subjekte të vlerësimit të gjithë magjistratët, përfshirë kryetarët e gjykatave dhe prokurorive, janë subjekt i vlerësimit të tyre etik dhe profesional në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë ligj. Kryetarët vlerësohen gjithashtu edhe për veprimtarinë e tyre si kryetar gjykate apo prokurorie. Magjistratët, të cilët janë në skemën e delegimit, ose janë komanduar në Këshilla, Gjykatën e Lartë ose Prokurorinë e Përgjithshme vlerësohen sipas parashikimeve të këtij ligji. Magjistratët, të cilët janë komanduar në struktura të tjera dhe ruajnë statusin e magjistratit, vlerësohen sipas sistemit të vlerësimit në strukturën ku janë komanduar.

***Kriteret, burimet dhe nivelet e vlerësimit***

Projektligji parashikon se kriteret e vlerësimit të magjistratit do të jenë aftësitë gjyqësore ose të punës si prokuror, aftësitë organizative, të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave gjyqësore dhe të prokurorisë si dhe aftësitë vetjake dhe angazhimi profesional. Vlerësimi i magjistratëve parashikohet të bëhet mbi bazë të disa burimeve: dosja personale e magjistratit; të dhënat statistikore; dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim, duke përfshirë edhe regjistrimet e seancave me mjete audio ose video në lidhje me dosjet gjyqësore, të cilat duhet të mbulojnë plotësisht të gjitha llojet e çështjeve të gjykuara dhe të hetuara; vlerësimi i kryer nga magjistrati dhe vendimet gjyqësore ose aktet të hartuara prej prokurorit dhe të përzgjedhura dhëna prej tij.

Në çdo rast, numri i vendimeve/akteve të hartuara dhe të përzgjedhura prej prokurorit nuk duhet të jetë jo më shumë se 2 në vit; të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj magjistratit gjatë periudhës së vlerësimit; infomacioni me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në veprimtaritë trajnuese; vendimet përfundimtare për masat disiplinore ndaj magjistratit që janë dhënë gjatë periudhës së vlerësimit, në mënyrë të pavarur nëse masa disiplinore është shuar ose jo; raportet e kërkuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit ose institucione të tjera ose audituese ose kontrolluese; kundërshtimet e magjistratit dhe çdo procesverbal ose dokument i seancës dëgjimore gjatë procesit të vlerësimit; çdo e dhënë tjetër, që tregon ngritjen profesionale të magjistratit.

Nivelet e vlerësimit parashikohet të jenë "Shkëlqyeshëm", "Shumë mire", "Mirë", "Mjaftueshëm" dhe "I pamjaftueshëm".

### 4.4. Raportimi dhe transparenca e vlerësimit të gjyqtarëve

Sipas projektligjit parashikohet që Këshillat çdo vit kalendarik, hartojnë raportin e vlerësimit për veprimtarinë e vlerësimit të magjistratëve që kanë kryer në vitin paraardhës, i cili publikohet në fund të muajit mars të vitit pasardhës. Gjithashtu, Këshillat publikojnë çdo 3 vjet, një raport periodik për sistemin e vlerësimit, në të cilin pasqyrohet: përshkrim i përgjithshëm i vlerësimeve të kryera gjatë periudhës që mbulon ky raport; analiza e përfundimeve të vlerësimit duke identifikuar dobësitë dhe përparësitë e trupës së magjistratëve dhe të sistemit gjyqësor ose prokurorisë; analiza e efikasitetit të rekomandimeve të miratuara në periudhën raportuese pararendëse; rekomandimet për masat që duhen marrë për të kapërcyer dobësitë e identifikuara.
Raporti periodik publikohet deri në fund të muajit Mars të vitit që vjen pas periudhës që mbulohet nga ky raport.

### 4.5 Paga dhe përfitimet e tjera financiare dhe shoqërore

Projektligji përmirëson në mënyrë rrënjësore trajtimin financiar dhe masat mbështetëse për gjyqtarët dhe prokurorët si dhe vendos garancitë për trajtim financiar të gjyqtarëve pas lënies së detyrës, duke u mbështetur në parimin se niveli i shpërblimit për magjistratët duhet të jetë i tillë që t'i mbrojë ata nga presionet që dëmtojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit.[7]

Në këtë projektligj parashikohen kriteret në bazë të të cilave caktohet paga e magjistratit, siç janë: a) shkalla e gjykatës ose prokurorisë ku magjistrati ushtron funksionin; b) vjetërsia në ushtrimin e funksionit; c) fusha e veçantë e kompetencës lëndore në të cilën magjistrati ushtron funksionin; si dhe d) pozicioni drejtues. Projektligji reflekton standartet e Kartës Evropiane, sipas së cilës, niveli i shpërblimit të një gjyqtari në krahasim me një tjetër mund të jetë subjekt i faktorëve të tillë si kohëzgjatja e shërbimit, natyra dhe rëndësia e detyrave, vështirësia e tyre, etj.[8]

Janë parashikuar përfitimet e tjera financiare, të cilat përfshijnë: a) kompensim për transferimin e përkohshëm ose në skemën e delegimit; b) shpërblim për aftësi; c) pension suplementar sipas

[7] Rekomandimi (2010) 12 i Komisionit të Ministrave.
[8] Po aty, par. 6.2.

legjislacionit për pensionet suplementare; d) kredi për shtëpi; e) paga e magjistratëve në pozicione drejtuese; f) bursa shkollimi për kandidatë magjistratë. Janë parashikuar me saktësi rregullat për përfitimet e tjera financiare për magjistratin. Gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij, magjistrati dhe familja e tij gëzojnë të drejtën të kenë mbrojtje të veçantë nga shteti për jetën, shëndetin dhe pasurinë e tyre. Duke u mbështetur në Kartën Evropiane mbi Statusin e Gjyqtarëve[9], projektligji parashikon që magjistratët të përfitojnë nga sigurimet shoqërore, me fjalë të tjera mbrojtje kundër rreziqeve të zakonshme sociale, të tilla si sëmundje, barrëlindje, invaliditet, pleqëri dhe vdekje.

Projektligji garanton paprekshmërinë e pagës dhe përfitimeve të tjera financiare të magjistratit, duke përcaktuar se ato nuk mund të ulen me përjashtim të rasteve kur: a) ka situata të vështira financiare në vend ose emergjenca të tjera kombëtare, duke marrë parasysh faktorët si vijon: një mospërputhje e qartë midis dinamikës së pagave të magjistratëve dhe dinamikës së pagave standarde në shërbimin civil; indeksi i pagesave ashtu si dhe indeksi i çmimeve të konsumatorit. Këto faktorë është e nevojshme që të vlerësohen, për të gjetur balancën mes paprekshmërisë së pagës dhe nevojës për të shmangur marrjen e borxheve të reja; b) magjistrati ushtron të drejtën për t'u kthyer nga një pozicioni i mëparshëm më të lartë ose më të specializuar ose me mandat të kufizuar dhe me pagesë më të lartë; c) magjistrati ka masë disiplinore; d) vjen si pasojë e një vlerësimi të ulët etik dhe profesional sipas parashikimeve të këtij ligji.

Sipas projektligjit magjistrati gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm nëse: a) ka mbushur të paktën moshën 60 vjeç; b) ka ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 30 vjet, duke përfshirë edhe periudhën e komandimit; dhe c) nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin e tij, për shkak të sëmundjes të vërtetuar nga komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë në punë. Në lidhje me magjistratin që ushtron funksionin në Gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe Prokurorinë e Posaçme, projektligji parashikon se ai gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm tre muaj më parë, për çdo vit të ushtrimit të funksionit në këto struktura.

***Leja dhe ulja e kohës së punës dhe të drejta të tjera***

Kohëzgjatja e lejes vjetore parashikohet të jetë 25 ditë pune. Për magjistratët që ushtrojnë funksionin në Gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme, projektligji parashikon të drejtën e tyre për të përfituar pesë ditë pune shtesë leje vjetore.
Pushimet vjetore mund të merren njëherësh ose në periudha të ndryshme, sipas kërkesës së magjistratit dhe në përputhje me kërkesat e funksionit. Në lidhje me magjistratin e sapo caktuar në pozicion, projektligji parashikon se ai përfiton pushime vjetore vetëm pasi ka ushtruar funksionin për një periudhë tre mujore. Në lidhje me magjistratin që kalon sëmundje gjatë pushimeve vjetore, të cilat mund ta pengonin atë në ushtrimin e funksionit nëse nuk do të ishte me pushime, projektligji parashikon se ai përfiton shtyrje të kohëzgjatjes së pushimeve vjetore, të njëjtë me kohëzgjatjen e sëmundjes, me kushtin që kjo e fundit të vërtetohet me raport mjekësor.

[9] Karta Evropiane mbi Statusin e Gjyqtarëve, 8-10 Korrik 1998.

Për magjistratin që nuk merr pushimet e plota vjetore deri në fund të vitit përkatës kalendarik, për arsye që nuk lidhen me kërkesa të funksionit, projektligji parashikon se ai mund të shtyjë kohëzgjatjen e mbetur të pushimeve në vitin pasardhës, me kushtin që kohëzgjatja e mbetur të jetë deri në pesë ditë. Magjistrati gëzon të drejtën të marrë pushime të tjera dhe leje prindërore në përputhje me Kodin e Punës. Në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë, projektligji parashikon zbatimin e dispozitave të legjislacionit ër sigurinë dhe shëndetin në punë.
Në lidhje me të drejtat e tjera, projektligji parashikon një risi: **të drejtën e uljes së ngarkesës dhe të drejtën e pensionit të parakohshëm**. Projektligji parashikon të drejtën e uljes së ngarkesës së çështjeve në rastet e sëmundjes së përkohshme, për një kohëzgjatje të kufizuar deri në dy vjet; ose studime jashtë kursit të formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës, për një kohëzgjatje të kufizuar deri në tre vjet.

### 4.6 Përgjegjësia disiplinore, penale dhe civile e magjistratëve

Standardet ndërkombëtare rekomandojnë që parashikimet normative të mos lenë hapësirë për paqartësi ose dykuptueshmëri, pasi në të kundërtën masat disiplinore nuk i shërbejnë qëllimit të tyre në funksion të llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së magjistratëve, por mund të përdoren në mënyrë abuzive si një mjet për të cënuar pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit.[10] Kështu, sikurse Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (CJE) rekomandon, projektligji liston të gjitha veprimet/mosveprimet që përbëjnë shkelje disiplinore, garanton elementët e procesit të rregullt ligjor për shqyrtimin e shkeljeve, dhe vendosjen e sanksioneve proporcionale në përputhje me shkeljen e kryer, si dhe të drejtën e ankimit në një organ tjetër më të lartë e të pavarur.[11]
Bazuar në standardet ndërkombëtare, projektligji përcakton në mënyrë të qartë dhe objektive dispozitat materiale dhe proceduriale lidhur me **procedimin disiplinor** ndaj magjistratëve. Për herë të parë në ligj parashikohen parimet që udhëheqin Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në procedimin disiplinor. Në këtë frymë janë ndërtuar të gjitha dispozitat ligjore për fillimin e hetimit disiplinor dhe deri tek vendimmarrja e masës disiplinore. Parimet kryesore janë ato të procesit të rregullt ligjor, ligjshmërisë, akuzës, barazisë, pafajësisë, proporcionalitetit, ruajtja e të dhënave personave, etj.

#### 4.6.1 Procedimi disiplinor dhe risitë lidhur me të

Disa nga risitë e projektligjit për procedimin disiplinor janë:

✓ Përcaktimi për herë të parë në ligj të përgjegjësisë disiplinore dhe civile të magjistratëve.
✓ Parashikimi në projektligj, i llojeve të shkeljeve disiplinore të cilat janë të ndara në tre kategori, kur magjistrati vepron me pakujdesi në ushtrimin e detyrave që rrjedhin nga funksioni, kur haptazi nuk i referohet ligjit ose fakteve për shkak të pakujdesisë së rende, si dhe në çdo rast tjetër që kryen akte dhe sjellje të papërshtatshme gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj kur diskretitojnë pozitën dhe figurën e magjistratit ose dëmtojnë rëndë besimin e publikut.

---

[10] Raport i ENCJ, Zhvillimi i Standarteve Minimale Gjyqësore, Hagë 5 Qershor 2015, par. 3, fq. 17.
[11] Opinion nr. 3 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (ÇJE) (2002), mbi rregullat dhe parimet që normojnë sjelljen profesionale të gjyqtarëve, në veçanti etikën, paanshmërinë dhe papajtueshmërinë me detyrën, par. 74.

- ✓ Përcaktimi në mënyrë të qartë, me qëllim që të mos ketë keqinterpretim dhe zbatim jo të drejtë të dispozitave, se në çfarë konsistojnë secila nga kategoritë dhe nënkategorizimi i tyre. Përcaktimi i qartë i shkeljeve disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit vë përpara përgjëgjësisë disiplinore të gjithë magjistratët që nuk respektojnë parashikimet e këtyre dispozitave.
- ✓ Zvarritjet dhe vonesat e shkaktuara nga magjistratët të veprimeve proceduriale dhe e nxjerrjes së akteve do të jetë një shkelje disiplinore. Ashtu si dhe shkelja e përsëritur ose e rëndë e rregullave të solemnitetit do të jetë shkelje disiplinore. Në mënyrë eskplicite përcaktohet vonesa e përsëritur dhe e pajustifikuar të fillimit të seancës gjyqësore si shkelje disiplinore deri në detaj.
- ✓ Parashikimi se çfarë përbëjnë shkelje disiplinore gjatë ose në lidhje me funksionin e gjyqtarit ose jashtë tij, duke përfshirë moszbatimin e vendimeve të KLGJ-së, KLP-së, si dhe mosushtrimi i detyrave dhe i funksionit të tij si magjistrat, si drejtues, si magjistrat shtypi, etj.
- ✓ Një element i ri i përfshirë në veprimet e magjistratëve është edhe në rastet e mosnjoftimit të Këshillit për papajtueshmëritë ambientale, ndikimet e papërshtatshme, ndërhyrjet, rasteve të papajtueshmërisë, etj. Si shkelje disiplinore janë vendosur në mënyrë specifike rastet e shkeljeve të ligjit procedurial dhe material. Mosarsyetimi i akteve dhe vendimeve në kohën e duhur përbën gjithashtu një shkelje disiplinore.

### 4.6.2 Llojet e masave disiplinore

Përcaktimi i saktë i shkeljeve disiplinore, i llojit të tyre, do të sjellë përgjegjshmëri nga magjistratët, duke mos shtyrë seancat gjyqësore, për të respektuar orarin, respektuar ligjin procedurial dhe material, respektimin e rregullave të solemnitetit, arsyetimin dhe argumentimin e vendimeve brenda afteve të përcaktuara. Këto parashikime do të sjellin një gjyqësor me të efektshëm, eficent, pa vonesa dhe zvarritje. Nëpërmjet këtyre dispozitave synohet t'i jepet fund ndërhyrjeve dhe ndikimeve të paligjshme, veprimeve korruptive dhe kërkimit të favoreve të tjera.
Projektligji përcakton në mënyrë të qartë masat disiplinore, përfshirë masa të reja, si: vërejtje konfidenciale, vërejtje publike, ulja e përkohshme e pagës, ulja në detyrë në një pozicion më të ulët, pezullim nga detyra dhe shkarkim nga detyra. Risi e këtij projektligji janë edhe masat plotësuese, si trajnimi ose ulja në detyrë e kryetarit. Projektligji ka përcaktuar në mënyrë të detajuar kriteret të cilat do të ndikojnë drejtëpërdrejtë për caktimin e masës disiplinore, rrethanat lehtësuese dhe rënduese.
Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë është organi që jep masën disiplinore për magjistratët.

Projektligji parashikon qartazi përgjegjësinë penale të magjistratëve. Ai ndiqet penalisht sipas dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu përcaktohet detyrimi i organit të prokurorisë për njoftimin e Këshillit respektiv, në rast të nisjes së hetimeve penale ndaj magjistratit.
Projektligji parashikon dënimin administrativ në rastet kur magjistrati ose perfaqësuesi i tij cënojnë dinjitetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ose Këshillit.

### 4.6.3 Procedurat hetimore të shkeljeve disiplinore dhe respektimi i procesit të rregullt ligjor

Projektligji parashikon që hetimi i shkeljeve disiplinore të magjistratëve të bëhet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me inciativën e ankuesit ose me iniciativë të vetë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili fillon hetimin nëse ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer bazuar në faktet dhe provat e mbledhura, që justifikojnë fillimin e hetimit.
Në projektligj është parashikuar në mënyrë të qartë dhe të plotë procedura hetimore, duke parashikuar afatet e parashkrimit të hetimit të shkeljes disiplinore, afatet e procedimit të shkeljes, procedurën e paraqitjes së ankesave pranë këtij Inspektori, kriteret për pranueshmerinë e ankesës, shqyrtimi fillestar, vlerësimi dhe verifikimi i ankesës, vendimi që Inspektori merr për fillimin e hetimit bazuar në ankesë ose kryesisht, zgjerimi ose ndryshimi i objektit të hetimit, rastet e pezullimit të hetimit, të drejtat dhe detyrimet e magjistratit gjatë hetimit, ecuria e hetimeve, marrja në pyetje e magjistratit ose e dëshmitarëve, marrja e provave që i shërbejnë hetimit nga institucione të tjera, dokumentimi dhe mbyllja e hetimit, zgjidhja me marrëveshje të përbashkëte shkeljes disiplinore që i atribuohet magjistratit dhe paraqitja e kësaj marrëveshje për shqyrtim të mëtejshëm pranë Këshillit (Gjyqësor ose të Prokurorisë).
Kështu, parashikohet nisja e hetimit për shkeljen e pretenduar brenda tre muajve nga marrja e ankesës. Projektligji përcakton një afat hetimi 6 mujor dhe parashikon gjithashtu të drejtën e Inspektorit të Lartë për zgjatjen e këtij afati edhe me tre muaj në disa raste.
Një parashikim i tillë do të garantojë një siguri më të madhe të normës duke shmangur keqinterpretimin e saj në lidhje me fillimin ose mosfillimin e hetimit.Në projektligj parashikohet e drejta e ankimit të magjistratëve në rast tejkalimi të afatit të mësipërm. Ky parashikim do tu garantonte magjistratëve mbrojtje nga një hetim i pakufizuar në kohë.

Në projektligj, përcaktohet gjithashtu fillimi i procedurës disiplinore që realizohet nga Këshilli përkatës (Gjyqësor ose i Prokurorisë). Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë është i bindur që ka shkaqe të arsyeshme për të besuar që një magjistrat ka patur sjellje të papërshtatshme, depoziton pranë Këshillit kërkesën për të filluar procedimin disiplinor së bashku me dosjen hetimore.

Magjistrati ndaj të cilit ka filluar një procedurë disiplinore gëzon të drejtën për të paraqitur parashtrimet me shkrim pranë Këshillit brenda një afati të caktuar, të marrë pjesë në seancë, të thërrasë dëshmitarë, të paraqesë dokumente, të marrë masa të tjera për paraqitjen e provave në favor të mbrojtjes së tij, të përfaqësohet me avokat ose përfaqësues, etj.

Pas shqyrtimit të të gjithë fakteve dhe provave, Këshilli mund të rrëzojë kërkesën për procedim disiplinor ose ta pranojë atë duke vendosur një ose më shumë masa disiplinore. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin e dhënë nga Këshilli për masë disiplinore. Këshillat marrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e masave disiplinore dhe janë përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të të gjitha masave që vendosen në procedimin disiplinor.

Projektligji siguron respektimin e procesit të rregullt ligjor, nëpërmjet parashikimit të të drejtave të magjistratëve gjatë procedurës hetimore, të tilla si aksesi në dosjen e hetimit në atë masë që është në përputhje me objektin e hetimit, e drejta e magjistratit për ankimin e vendimit, e drejta e magjistratit ose ankuesit për të paraqitur parashtresa dhe dokumenta mbështetëse.

### 4.7 Kohëzgjatja e mandatit të magjistratëve

Projektligji garanton kohëzgjatjen e statusit të magjistratëve. Ky është një nga parimet bazë që siguron pavarësinë e gjyqësorit. Ashtu sikurse standardet ndërkombëtare rekomandojnë[12], projektligji parashikon një listë ezauruese të rasteve kur përfundon mandati i magjistratit, të tilla si: dorëheqja, vërtetimi i kushteve të pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit, dalja në pension, shkarkimi nga funksioni për përgjegjësi disiplinore sipas ligjit, si dhe për arsye të pamundësisë për të ushtruar detyrën. Të gjitha rastet janë të mirëpërcaktuara në projektligj pasi mungesa e qartësisë së këtyre dispozitave mund të përbëjë shkak për ndikime në ushtrimin e funksionit të magjistratit.
Projektligji parashikon edhe rastet e kufizimit me ligj të mandatit, kështu, mandati i gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë është nëntë vjet pa të drejtë rizgjedhjeje. Mandati i Prokurorit të Përgjithshëm është shtatë vjet pa të drejtë rizgjedhjeje. Mandati i prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme është nëntë vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje.

Gjithashtu, parashikohet se mandati i Kryetarit të Gjykatës së Lartë është 3 vjet pa të drejtë rigjedhjeje. Në lidhje me mandatin e kryetarëve të gjykatave dhe prokurorive të tjera, me përjashtim të Prokurorit të Përgjithshëm, projektligji parashikon se ai është është tre vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë, kurse mandati i Kryetari i Prokurorisë së Posaçme është tre vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje.
Gjithashtu, në projektligj parashikohet se jo më vonë se 6 muaj përpara mbarimit të mandatit të parë, kryetari i gjykatës ose prokurorisë me të drejtën e rizgjedhjes, mund të kandidojë për një mandat të dytë. Kur kryetari nuk kandidon për një mandat të dytë brenda afatit të përcaktuar, konsiderohet që ka dhënë dorëheqjen si kryetar në fund të mandatit.

### 4.8 Dispozita të fundit dhe kalimtare

Projektligji parashikon në këtë kre regjimin që do të zbatohet për organet përgjegjëse që kanë qënë përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe kompetencat e tyre deri ne krijimin e organeve të reja, përkatësisht Këshilli i Lartë Gjyqësor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Në projektligj parashikohen kompetencat që do të ushtrohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe inspektoriatet ekzistuese, deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ushtrimi i kompetencave nga organet e mësipërmë gjatë periudhës tranzitore do të bëhet sipas rregullave të përcaktuara në projektligj.

Projektligji parashikon dispozita kalimtare që mundësojnë vazhdimin e qëndrimit në detyrë të anëtarëve në detyrë dhe Kryetarit në detyrë të Gjykatës së Lartë.

## 5. PROCESI I HARTIMIT TË PROJEKTLIGJIT, METODOLOGJIA DHE PARIMET KRYESORE

[12] Karta Evropiane mbi Statusin e Gjyqtarëve, Strasburg 8 - 10 Korrik 1998, par. 7.1.

Duke vlerësuar rëndësinë e reformës në drejtësi si një reformë në dobi të zhvillimit të demokracisë, shtetit të së drejtës, në dobi të qytetarëve, të zhvillimit ekonomik dhe mirëqënies së vendit, inicimi i këtij procesi dhe zhvillimi i tij jashtë korpusit ekzekutiv qeverisës, në organin përfaqësues të popullit, në Kuvend, ishte pjesë e vizionit për procesin e kësaj reforme. Procesi i reformës në sistemin e drejtësisë është ndërtuar në mënyrë të tillë që të respektojë parimet e gjithëpërfshirjes, transparencës, profesionalizmit, pajtueshmërisë më standartet ndërkombëtare dhe konsultimit të gjerë midis aktorëve në këtë proces.

### 5.1 Gjithëpërfshirja

Projektligji u hartua gjatë periudhës Tetor 2015 – Qershor 2016 nga ekspertët e nivelit të lartë, vendas dhe ndërkombëtar pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, të cilët përfaqësojnë institucionet më të rëndësishme të sistemit të drejtësisë, institucionet akademike që kontribuojnë në sistemin e drejtësisë si dhe përfaqësuesit e misioneve dhe organizatave e partnerëve ndërkombëtarë.

Në përbërje të grupit të punës për hartimin e projektligjit "Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë" kanë qenë ekspertë të nivelit të lartë (vendas e ndërkombëtarë), si përfaqësues të Misionit Euralius IV, Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Gjykatës së Lartë.

Grupi i punës është asistuar nga ekspertët e Sekretariatit Teknik, i përbërë nga juristë, përfaqësues të Kuvendit, Gjykatës së Lartë, Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme, Misionit Euralius, Prezencës së OSBE-së në Shqipëri si dhe juristë të fushës.

Duke ndjekur të njëjtën metodologji për secilën shtyllë të reformës në drejtësi, pranë çdo grupi që u ngarkua me hartimin e projektligjeve më të rëndësishme organike të sistemit të drejtësisë, është ngritur dhe ka funksionuar një grup konsultimi i ngushtë Think Tank ku janë atashuar gjyqtarë, prokurorë, noterë, avokatë, oficerë të policisë gjyqësore, juristë, etj.

Grupi i punës për hartimin e projektligjit "Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë", ka zhvilluar konsultime të vazhdueshme me grupin e konsultimit Think-Tank për këtë projektligj, i përbërë nga ekspertë të opozitës parlamentare, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Gjyqtarë, Prokurorë, pedagogë të së drejtës, ekspertë të Prezencës së OSBE në Shqipëri, përfaqësues të shoqërisë civile etj.

Gjatë hartimit të këtij projektligji janë marrë parasysh standardet ndërkombëtare dhe praktikat ligjore më të mira të vendeve me demokraci të konsoliduar. Në mënyrë të veçantë, për hartimin e dispozitave janë mbajtur parasysh konventat ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, aktet udhëzuese ndërkombëtare, Raportet e organizmave ndërkombëtare, rekomandime të Komisionit të Venecias, etj. Është treguar kujdes që këto standarde dhe praktika të përshtaten me kontekstin e zhvillimeve dhe dinamikave të vendit tonë, me synimin që dispozitat e këtij ligji të jenë të zbatueshme.

### 5.2 Transparenca dhe konsultimi publik

Projektligji është konsultuar vazhdimisht me grupin e konsultimit Think-Thank[13], dhe është rishikuar disa herë nën dritën e komenteve dhe sugjerimeve të aktorëve të sistemit të drejtësisë nga grupi i punës së ekspertëve. Konsultime dhe takime të vazhdueshme janë zhvilluar me grupe të ndryshme interesi, përkatësisht me gjyqtarë të Gjykatës së Shkallës së Parë, me inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me pedagogë të Shkollës së Magjistraturës dhe me përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme. Këto konsultime janë bërë për kapituj të veçantë të projektligjit, sipas fushave përkatëse që ka prekur këto grupe interesi, përkatësisht për zhvillimin e karrierës së magjistratëve, për vlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe për dispozitat përfundimtare dhe tranzitore.

Krahas konsultimit me grupet Think-Tank, për paketën e projektligjeve prioritare është zhvilluar një proces i gjerë konsultimi dhe në tryezat e konsultimit publik të zhvilluara në Tiranë dhe rrethe të ndryshme të vendit. Kështu, gjatë muajit Maj-Qershor 2016, për konsultimin publik të shtatë projektligjeve që shoqërojnë projektin kushtetues, dhe disa projektligje të tjera, u zhvilluan 7 tryeza konsultative, nga të cilat 5 tryeza u zhvilluan në Tiranë, 1 tryezë në Vlorë dhe 1 tryezë në Durrës.

Projektligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, së bashku me dy projektligjet e tjera të shtyllës së gjyqësorit, u konsultuan gjerësisht gjatë muajit Maj 2016 me aktorë të sistemit të drejtësisë, gjyqtarë dhe prokurorët në sistem dhe krerët e gjykatave dhe prokurorive, përfaqësues të institucioneve shtetërore si Ministria e Drejtësisë, dhe përfaqësues të shoqërisë civile aktive në fushën e drejtësisë. Procesi i parë i konsultimit u zhvillua në Tiranë, në datë 11 Maj 2016, dhe procesi i dytë në Vlorë, në datë 16 maj 2016.

Në këto tryeza morën pjesë gjyqtarë, prokurorë, pedagogë të së drejtës të universiteteve publike e private, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, shoqëria civile, media, etj.

Komentet e marra nga pjesëmarrësit si gjatë konsultimeve publike dhe kontributet me shkrim janë shqyrtuar dhe vlerësuar në mbledhjet e grupit hartues dhe janë reflektuar në tekstin e projektligjit.

## 6. SHQYRTIMI I PROJEKTLIGJIT NË KOMISIONIN E POSAÇËM PËR REFORMËN NË DREJTËSI

Në datën 24 qershor 2016, është bërë prezantimi dhe diskutimi në parim i *projektligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*" në Komisionin e Posaçëm Parlamentar. Paralelisht me diskutimin nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm, në vijim të praktikës së ndjekur nga Komisioni dhe Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë për konsultimin e të gjitha produkteve të reformës në drejtësi, projektligji i'u përcoll për konsultim nëpërmjet postës elektronike, rrjetit të konsultimit publik, i përbërë nga gjithë gjyqtarët në çdo shkallë të gjykimit, prokurorë të të gjitha niveleve, pedagogë të së drejtës në universitetet publike e private,

[13] Pranë grupeve të punës për hartimin e çdo projektligji janë ngritur dhe funksionojnë grupet e konsultimit të ngushtë Think-Tank, të përbëra përgjithësisht nga përfaqësues të grupeve të interesit, përfaqësues të opozitës parlamentare, profesionistë të fushës, gjyqtarë, prokurorë, avokatë, noterë, përmbarues, përfaqësues të shoqërisë civile, pedagogë të së drejtës si dhe përfaqësues të institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe institucione të tjera të lidhura me to.

shoqërisë civile etj, të cilët u ftuan për të dhënë kontributet e tyre për përmirësimin e projektligjit.

Kontributet e ardhura janë vlerësuar nga grupi i ekspertëve hartues në bashkëpunim me relatorin e caktuar nga Komisioni, dhe në një masë të konsiderueshme janë reflektuar në projektligj, i cili edhe në këtë fazë, ka qënë në proces të vazhdueshëm ndryshimi dhe përmirësimi. Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komision, relatori i këtij projektligji dhe anëtarët e maxhorancës parashtruan një sërë pyetjesh dhe çështjesh për diskutim gjatë seancës së diskutimit në parim dhe nen për nen të projektligjit.

Në mbledhjet e datave 1, 4 , 6 dhe 8 korrik 2016 projektligji u shqyrtua nen për nen në Komision, dhe pasi u diskutua gjerësisht mbi përmbajtjen e projektligjit, u vendos që pas reflektimit të ndryshimeve dhe riformulimeve të propozuara nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, të vazhdonte shqyrtimi i projektligjit dhe miratimi në tërësi.

Në mbledhjen e datës 23 shtator 2016, Komisioni miratoi nen për nen dhe në tërësi tekstin e rishikuar të projektligjit në plotësim të detyrave të lëna nga Komisioni në mbledhjet e kaluara si dhe në reflektim të ndryshimeve kushtetuese të miratuara në datë 22 korrik 2016, duke lënë të hapura dispozitat e Kreut III në lidhje me pagat dhe përfitimet e tjera financiare dhe shoqërore, për të cilat nevojitej dakordësimi dhe konsultimi me Ministrinë e Financave dhe Departamentin e Administratës Publike, si dhe një grup dispozitash të tjera që kanë të bëjnë kryesisht me dispozitat e pjesës VI në lidhje me dispozitat e fundit dhe kalimtare.

Në datë 30 shtator 2016, Komisioni i Posaçëm Parlamentar pasi u njoh me mendimin e Këshillit të Ministrave mbi faturën financiare të gjashtë projektligjeve të reformës në drejtësi, miratoi dispozitat e mësipërme të riformuluara dhe tekstin përfundimtar të projektligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

## 7. EFEKTET FINANCIARE TË PROJEKTLIGJIT

Mbështetur në nenin 82 pikat 2 dhe 3 të Kushtetutës, dhe në nenin 68 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni kërkoi mendimin e Këshillit të Ministrave lidhur me efektet financiare të këtij projektligji. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit të Posaçëm, Këshilli i Ministrave me Vendimin nr.667, datë 28.9.2016 depozitoi në Kuvendin e Shqipërisë mendimin mbi efektet financiare të gjashtë projektligjeve të reformës në drejtësi. Komisioni u njoh me këtë mendim dhe bërë reflektimet e nevojshme në projektligj.

## 8. PËRFUNDIM

Në përfundim të procesit të hartimit, konsultimit dhe diskutimit të këtij projektligji, Komisioni i Posaçëm Parlamentar "Për reformën në Sistemin e Drejtësisë" miratoi projektligjin "Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit Republikën e Shqipërisë" dhe ia paraqet seancës plenare të Kuvendit për votim, sipas tekstit integral bashkëlidhur këtij raporti.

**RELATORE** **KRYETARI**

**Vasilika HYSI** **Fatmir XHAFAJ**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**Kuvendi**

**P R O J E K T L I GJ**

**Nr._____/2016**

**PËR**

**STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 81 pika 2 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozim të një grupi deputetësh, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**VENDOSI:**

## PJESA I
## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Objekti i Ligjit

1. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i statusit të magjistratëve, duke parashikuar rregulla në lidhje me:
a) të drejtat dhe detyrimet e tyre;
b) pranimin dhe emërimin e tyre;
c) zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit të tyre;
ç) vlerësimin etik dhe profesional të tyre;
d) përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile të tyre;
2. Sipas parashikimeve të këtij ligji, statusi gëzohet ligjërisht nga një person që sapo emërohet në funksion dhe përfundon me mbarimin e statusit të magjistratit.

### Neni 2
### Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtme kanë këto kuptime:
a) **“Çështje pa palë ndërgjyqëse”** për qëllim të vlerësimit etik dhe profesional është çdo çështje gjyqësore e regjistruar në gjykatë, e paraqitur në formën e kërkesës, me të cilën nuk kërkohet zgjidhja në themel e një mosmarrëveshjeje. Në këto çështje përfshihen çështjet civile dhe çështjet administrative pa palë kundërshtare, çështjet administrativo-penale dhe masat e sigurimit;
b) **“Dokument ligjor”** për qëllim të vlerësimit të aftësive profesionale nënkupton çdo dokument i përgatitur nga personi gjatë ushtrimit të detyrës profesionale, si vendim gjykate, kërkesë për gjykim, raport/relacion, padi, mendim/opinion ligjor si dhe akte të tjera që provojnë kapacitetet profesionale të personit;
c) **“Ditë”** janë ditë kalendarike, me përjashtim të afateve nën 10 ditë të cilat llogariten me ditë pune;
ç) **“nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike”**, do të thotë që nuk ka qenë deputet, Kryeministër, Zëvendëskryeministër, ministër, zëvendësministër ose nëpunës pjesë e kabinetit të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit, ose ministrit që kryen detyrën e drejtorit të kabinetit, këshilltarit, ndihmësit, zëdhënësit ose sekretarit personal të titullarit të kabinetit.
d) **“Gjyqtar relator”** është gjyqtari, i caktuar me short në cilësinë e relatorit të trupit gjykues për gjykimin e një çështje gjyqësore;
dh) **“I diplomuar”** është personi, i cili është përfshirë në listën e renditjes të diplomuarve nga Shkolla e Magjistraturës, por nuk është emëruar ende si magjistrat;
e) **“I emëruar”** është personi, i cili është diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës dhe është emëruar si magjistrat nga Këshilli ose një ish gjyqtar ose prokuror që është riemëruar nga Këshilli, por nuk është caktuar ende në pozicion;
ë) **“Këshillat”** janë:
i) Këshilli i Lartë i Gjyqësor i cili është organi që merret me çështje që lidhen me gjyqtarët, të emëruarit, të diplomuarit dhe kandidatët për magjistratët që ndjekin Shkollën e Magjistraturës me qëllim që të bëhen gjyqtarë;
ii) Këshilli i Lartë i Prokurorisë është organi që merret me çështje që lidhen me prokurorët, të emëruarit, të diplomuarit dhe kandidatët për magjistratët që ndjekin Shkollën e Magjistraturës me qëllim që të bëhen prokurorë.
f) **“Koha mesatare e vendimit gjyqësor”** është treguesi mesatar i kohës për arsyetimin e të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit deri në datën e depozitimit të vendimit në sekretari;
g) “Kryetar” i referohet kryetarit të gjykatës ose të prokurorisë, përfshirë Kryetarin e Gjykatës së Lartë, Prokurorin e Përgjithshëm dhe drejtuesit e Prokurorisë së Posaçme;
gj) **“Magjistrat”** është gjyqtari me përjashtim të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, prokurori dhe kryetarët në kuptim të gërmës “g” të këtij neni;
h) **“Ndihmës magjistrat”** është gjyqtari i komanduar për të ndihmuar gjyqtarët në Gjykatën e Lartë ose në Gjykatën Kushtetuese, si dhe prokurori i komanduar për të ndihmuar Prokurorin e Përgjithshëm, në trajtimin e çështjeve. Për këtë qëllim, veprimtaria e tyre përfshin në veçanti, kryerjen e kërkimit ligjor dhe përgatitjen e opinioneve me shkrim për çështje ligjore materiale ose procedurale;
i) **“Ndryshimi i strukturës administrative ose kompetencave tokësore të gjykatës ose prokurorisë”** është:
i) ndryshimi i rretheve gjyqësore dhe kompetencave territoriale sipas parashikimeve të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, me vendim të Këshillit të Ministrave;

ii) ndryshimi i numrit të magjistratëve për çdo gjykatë ose prokurori me vendim të Këshillave bazuar në një analizë afatgjatë të nevojave.
j) **“Paga bruto fillestare”** në kuptim të këtij ligji, përfaqëson pagën referuese bazë dhe shtesën e pagës në grup.
k) **“Periudha e vlerësimit”** është periudha gjatë së cilës bëhet vlerësimi etik dhe profesional i magjistratit;
l) **“Rendimenti i përfundimit të çështjeve”** për një magjistrat është raporti i numrit të çështjeve gjyqësore të përfunduara prej tij me numrin e çështjeve gjyqësore të caktuara brenda një viti kalendarik;
ll) **“Skema e vlerësimit”** i referohet tërësisë së rregullave të vlerësimit etik dhe profesional, sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij;
m) **“Standardet minimale të afatit”** janë afate orientuese brenda së cilës një çështje duhet të përfundojë. Këshillat miratojnë dhe rishikojnë standardet minimale të afatit në mënyrë të veçantë për lloje të ndryshme çështjesh, duke vlerësuar natyrën, kompleksitetin dhe sasinë e çështjeve të regjistruara në gjykatë ose në prokurori, si dhe infrastrukturën e gjykatës ose të prokurorisë;
n) **“Vendimi jo përfundimtar”** është vendimi, i cili nuk e zgjidh çështjen në themel, si vendimi për pushimin e një kërkese ose vendimi për përfundimin ose për mbylljen e procedurës për shkaqe formale.
nj) **“Veprimtari jashtë funksionit”** është veprimtari e paguar ose e papaguar, e cila nuk përfshihet në veprimtarinë e gjyqtarëve ose prokurorëve, në veprimtarinë administrative që kryhen nga magjistrati sipas parashikimeve të ligjit ose që kërkohen nga një person ose institucion përgjegjës;
**“Vlerësues”** është çdo person i përfshirë në përgatitje dhe vendimmarrje me qëllim të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional.
o) Shprehja **“nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike”** do të thotë që nuk ka qenë anëtar i organeve drejtuese të parashikuara në statutin e partisë politike.

## PJESA II
## TË DREJTAT DHE DETYRIMET E MAGJISTRATËVE

### KREU I
### VLERAT THEMELORE DHE TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PËRGJITHSHME

#### Neni 3
#### Vlerat themelore

1. Magjistrati ushtron funksionet e tij, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.
2. Magjistrati ushtron funksionet në mënyrë të pavarur, duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin sipas bindjes së tij të brendshme, i lirë nga çdo ndikim i drejtëpërdrejtë ose i tërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye.
3. Magjistrati nuk duhet të krijojë kontakte të papërshtatshme dhe nuk duhet të ndikohet nga pushteti ekzekutiv ose nga pushteti legjislativ. Magjistrati duhet të marrë çdo masë për të qenë dhe të duket se është jashtë çdo ndikimi prej tyre. Magjistrati njofton menjëherë Këshillin dhe Kryetarin, në rast se evidenton ndërhyrje ose ushtrim të ndikimit të papërshtatshëm ndaj tij.

4. Magjistrati ushtron funksionet gjyqësore në mënyrë të paanshme, pa ndikim dhe pa paragjykime.
5. Sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor dhe palëve në proces. Magjistrati ushtron funksionet me drejtësi, në mënyrë korrekte, në kohë të arsyeshme, të ndërgjegjshme, të kujdesshme, të zellshme dhe sistematike, me objektivitet, vetëpërmbajtje dhe maturi.

**Neni 4**
**Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes**

1. Magjistrati merr të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtaritë e kryera edhe kur magjistrati nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare.
2. Magjistrati merr të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar:
a) dinjitetin dhe standardet e funksionit të tij;
b) reputacionin e organeve të drejtësisë dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe atë të prokurorisë;
c) statusin e funksionit të magjistratit.
3. Në përputhje me parashikimet e këtij neni, Këshillat publikojnë standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes.
4. Secili Këshill emëron magjistratin si Këshilltarin e etikës, sipas parashikimeve të ligjit "Për Organet e Qeverisjes të Sistemit të Drejtësisë në Republikën e Shqipërisë".

**Neni 5**
**Të drejtat dhe detyrimet për formimin vazhdues**

1. Magjistrati ka të drejtë dhe detyrimin të marrë pjesë në programet e formimit vazhdues. Magjistrati ka të drejtë të propozojë tema trajnimi dhe të bashkëpunojë me Këshillin me qëllim përmirësimin e programeve të trajnimit.
2. Magjistrati duhet:
a) të ndjekë formimin vazhdues në përputhje me legjislacionin në fuqi;
b) të marrë çdo masë tjetër të arsyeshme për t'u përditësuar me ndryshimet legjislative dhe të jurisprudencës.
3. Periudha e formimit vazhdues duhet të jetë:
a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve;
b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve.
4. Magjistrati duhet të përmbushë detyrimin për të marrë pjesë në fomimin vazhdues vetëm në ato raste kur programet e trajnimit janë:
a) të përshtatshme për funksionin e tij,
b) të organizuara dhe çertifikuara nga Shkolla e Magjistraturës ose nga çdo institucion trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar të njohur nga Këshilli. Një kopje e çertifikatës vendoset në dosjen personale të magjistratit.
5. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për ndjekjen e programeve të formimit vazhdues të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, mbulohen me fonde nga buxheti i parashikuar për këtë qëllim të Shkollës së Magjistraturës, si dhe nga burime të tjera financiare, të paracaktuara për këto veprimtari. Këshilli mund të mbulojë nga buxheti i tij, shpenzimet e udhëtimit dhe të

qëndrimit për ndjekjen e trajnimeve të organizuara nga çdo institucion trajnimi i njohur nga Këshilli.
6. Këshillat bashkëpunojnë me Shkollën e Magjistraturës për analizën e nevojave për trajnim, zhvillimin e kurrikulave dhe programeve trajnuese. Këshillat miratojnë rregulla më të hollësishme për përshtatshmërinë dhe përmbajtjen e programeve të formimit vazhdues, shërbimet lehtësuese të lejuara, si dhe për procedurën e paisjes me leje për ndjekjen e këtyre trajnimeve.

## KREU II
## PAPAJTUESHMËRITË, KUFIZIMET DHE VEPRIMTARITË E TJERA

### Neni 6
### Papajtueshmëritë me funksionin e magjistratit

1. Funksioni i magjistratit është i papajtueshëm me:
a) anëtarësinë në parti politike dhe pjesëmarrjen në veprimtari politike të organizuara nga një parti politike;
b) kryerjen e çdo veprimtarie politike, pavarësisht nëse veprimtaria kryhet në bashkëpunim me ndonjë parti politike ose jo, që mund të ndikojë në pavarësinë e magjistratit, të krijojë ndonjë konflikt interesi ose, në çdo rast, të krijojë përshtypjen që magjistrati është i paanshëm dhe i pandikuar.
2. Kryetari njofton Këshillin në rast se ka dyshime të bazuara për të besuar se një magjistrat i gjykatës ose prokurorisë përkatëse nuk i përmbush kërkesat e kësaj dispozite.

### Neni 7
### Kufizimet për shkak të funksionit

1. Gjatë ushtrimit të funksionit, magjistrati nuk duhet:
a) të bëjë publike të dhëna ose informacione për çështjet që i janë caktuar;
b) të bëjë publike mendimet që ka dhënë gjatë hetimeve ose seancave gjyqësore, përveç rasteve kur mendimi është publikuar nëpërmjet një vendimi;
c) të bëj deklarata publike që mund të krijojnë përshtypjen që magjistrati është i njëanshëm ose i ndikuar në një çështje të caktuar.
2. Parashikimet e pikës 1 të këtij neni nuk e ndalojnë magjistratin të ushtrojë përgjegjësitë si magjistrat shtypi lidhur me marrëdhëniet me publikun në gjykata dhe në prokurori.
3. Magjistrati nuk mund të marrë pjesë në grevë.
4. Magjistratit i ndalohet:
a) të administrojë, drejtojë ose të ushtrojë ndikim në shoqëritë tregtare ose fitimprurëse, personalisht ose nëpërmjet përfaqësimit;
b) të zotërojë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit;
c) të zotërojë në mënyrë pasive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, nëse shoqëria ka fitime ose të mira nga kontratat publike në përputhje me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit në fuqi.

ç) të zotërojë në mënyrë pasive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare në të cilën veprimtaria e magjistratit është e ndaluar, për shkak se mund të ndikojë në pavarësinë e magjistratit, krijon konflikt interesi ose krijon përshtypjen që magjistrati është i njëanshëm ose i ndikuar;
d) të jetë ekspert në gjykatat vendase ose arbitër në arbitrazhin tregtar.
5. Kryetari njofton Këshillin në rast se ka dyshim të arsyeshëm për të besuar që një magjistrat i gjykatës ose prokurorisë përkatëse nuk plotëson kriteret e parashikuara në këtë dispozitë.

**Neni 8**
**Papajtueshmëria ambientale**

1. Këshillat marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale që krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose persona të tjerë në lidhje të ngushtë nga gjaku ose me ligj, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile.
2. Për këtë qëllim, në gjykatat dhe prokuroritë zbatohen parashikimet e mëposhtme:
a) Magjistrati nuk ushtron funksionin në një gjykatë ose prokurori, nëse një magjistrat tjetër me të cilin ka lidhje të ngushta familjare ushtron funksionin respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori;
b) Gjyqtari nuk ushtron funksionin në një Gjykatë Administrative të Shkallës së Parë nëse një gjyqtar tjetër me të cilin ka lidhje të ngushta familjare ushtron funksionin në Gjykatën Administrative të Apelit, si dhe anasjelltas;
c) Gjyqtari nuk ushtron funksionin në seksionin civil të gjykatës së zakonshme të shkallës së parë nëse një gjyqtar tjetër me të cilin ka lidhje të ngushta familjare ushtron funksionin në seksionin civil të gjykatës së apelit, që ka nën juridiksion gjykatën e zakonshme të shkallës së parë, si dhe anasjelltas;
ç ) Magjistrati nuk ushtron funksionin në seksionin penal të gjykatës së zakonshme të shkallës së parë dhe në prokurorinë në juridiksion të kësaj gjykate, nëse një magjistrat tjetër me të cilin ka lidhje të ngushta familjare ushtron funksionin në prokurorinë pranë gjykatës së apelit ose në seksionin penal të gjykatës së apelit, që ka nën juridiksion gjykatën dhe prokurorinë e shkallës së parë, si dhe anasjelltas.
2. Magjistrati nuk duhet të ushtrojë funksionin në Gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme nëse një magjistrat tjetër me të cilin ka lidhje të ngushta familjare ushtron funksionin në këto struktura.
3. Magjistrati duhet të njoftojë Këshillin pa vonesë në çdo rast papajtueshmërie ambientale para emërimit për herë të parë të tij. Magjistrati dhe Kryetari njoftojnë Këshillin pa vonesë në rast se kjo papajtueshmëri lind gjatë ushtrimit të funksionit.
4. Në rast të evidentimit të rasteve të papajtueshmërisë ambientale gjatë ushtrimit të funksionit në një gjykatë, magjistrati caktohet në një seksion tjetër. Në rast pamundësie, Këshilli respektiv transferon një nga magjistratët në gjykatën ose prokurorinë më të afërt të mundshme të të njëjtit nivel, në rast se magjistrati përmbush të gjitha kriteret e parashikuara për këtë pozicion. Këshilli transferon atë magjistrat, i cili:
a) jep miratimin për transferimin;
b) ka shkaktuar papajtueshmërinë ambientale, në rast se asnjë nga magjistratët përkatës nuk jep miratimin për transferim;

c) ka më pak eksperiencë pune si magjistrat në gjykatë ose prokurori në krahasim me magjistratin tjetër, në rast se nuk arrihet një zgjidhje midis tyre.
5. Transferimi për shkak të papajtueshmërisë ambientale ka përparësi ndaj lëvizjeve paralele.

**Neni 9**
**Veprimtaritë jashtë funksionit**

1. Magjistrati lejohet të kryejë veprimtari jashtë funksionit, vetëm nëse këto veprimtari:
a) janë në përputhje me dinjitetin e ushtrimit të funksionit;
b) nuk krijojnë perceptime të ndikimit ose njëanshmëri gjatë ushtrimit të funksionit;
c) nuk bien ndesh me interesat thelbësorë të funksionit, duke mos cënuar afatet dhe ushtrimin në mënyrë efiçiente të funksioneve. Në çdo rast veprimtaritë jashtë funksionit të paguara, duke përfshirë dhe punën përgatitore për realizimin e kësaj veprimtarie, nuk i kalojnë 200 orë gjatë dhe jashtë orarit të punës për vit;
ç) nuk bien ndesh me qëllimin për të cilin është ulur ngarkesa e punës;
d) në rast se shpërblimi për veprimtaritë jashtë funksionit përfshin çdo lloj dhe forme pagese, shpërblim financiar ose kompensim, të cilat nuk tejkalojnë rregullat e zakonshme të tregut;
dh) nuk janë të papajtueshme me ushtrimin e funksionit të magjistratit dhe nuk ndalohen sipas këtij ligji.
2. Me përjashtim të botimeve shkencore ose trajnimeve, magjistrati ndalohet të përdor titullin e magjistratit në veprimtaritë jashtë funksionit si dhe merr masa që palët e treta të mos e përdorin titullin e tij në këto veprimtari.
3. Magjistrati mund të shkruajë, të publikojë, të japë leksione dhe mësimdhënie për çështjet ligjore dhe të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me çështje ligjore, sistemin ligjor, administrimin e drejtësisë dhe çështje të tjera të lidhura me to, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni.
4. Magjistrati, para se të fillojë kryerjen e një veprimtarie të paguar jashtë funksionit sipas përcaktimeve të këtij neni, duhet të njoftojë Këshillin dhe t'i paraqesë dokumentacionin e nevojshëm që:
a) përshkruan natyrën dhe kohëzgjatjen e këtyre veprimtarive;
b) vërteton masën e shpërblimit të këtyre veprimtarive;
c) evidenton ngarkesën në punë në gjykatë ose prokurori, ngarkesën totale të punës në gjykatë ose prokurori, si dhe përmbushjen në kohë të detyrave përgjatë 12 muajve të mëparshëm.
5. Magjistrati merr miratimin e Këshillit përkatës, përpara se të pranojë kryerjen e veprimtarive të paguara jashtë funksionit.
6. Këshilli vendos brenda tre javëve nga marrja e kërkesës dhe e dokumentacionit të plotë dhe jep miratimin nëse veprimtaria dhe çdo shpërblim për kryerjen e saj janë në përputhje me pikën 1 të këtij neni. Në rast se Këshilli brenda afatit 3 javor nga marrja e kërkesës dhe e dokumentacionit të plotë nuk shprehet me vendim, nuk njofton të interesuarin si dhe nuk merr vendimin për zgjatjen e afatit, kërkesa konsiderohet e aprovuar, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Administrative.
7. Magjistrati duhet të njoftojë kryetarin për veprimtaritë jashtë funksionit të papaguara, të cilat nuk janë në kompetencë të Këshillit, ku magjistrati:
a) vepron si përfaqësues i gjyqësorit ose prokurorisë;
b) bën deklarata publike të përgjithshme për çështje që prekin gjyqësorin ose prokurorinë;
c) merr pjesë në diskutime për çështje të ligjit.

8. Kryetari raporton të paktën një herë në vit në Këshillat përkatës për natyrën dhe numrin e orëve, për veprimtaritë e papaguara jashtë funksionit të magjistratëve në gjykatën ose prokurorinë respektive.
9. Brenda muajit janar të çdo viti, Këshillat publikojnë në faqen zyrtare, si dhe i dërgojnë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe organeve të administratës tatimore një raport me shkrim të arsyetuar për veprimtaritë jashtë funksionit të paguara të magjistratëve, duke përcaktuar pagesën ose shpërblimin e përfituar gjatë vitit paraardhës dhe vlerën përkatëse të tregut. Institucionet përkatëse bashkëpunojnë me Këshillat për përcaktimin e vlerave normale të tregut.
10. Bazuar në parimin e barazisë dhe të proporcionalitetit, Këshilli miraton rregulla të detajuara për veprimtaritë jashtë funksionit.

**Neni 10**
**Liria e organizimit dhe e shprehjes**

1. Magjistratët kanë të drejtë të themelojnë shoqata ose organizata dhe të marrin pjesë në to, me qëllim:
a) mbrojtjen të drejtat dhe interesat e tyre;
b) ngritjen e tyre profesionale.
2. Shoqata ose organizata e magjistrateve në ushtrimin e aktivitetit nuk duhet të bien ndesh me kompetencat e institucioneve të drejtësisë.

## KREU III
## PAGA DHE PËRFITIMET E TJERA FINANCIARE DHE SHOQËRORE

**Neni 11**
**Parimet e caktimit të pagës dhe përfitimeve financiare të magjistratit**

1. Paga e magjistratit dhe përfitimet e tjera financiare duhet të jenë në përputhje me dinjitetin e detyrës së magjistratit dhe të përshtatshme për të garantuar pavarësinë dhe mbrojtjen nga ndërhyrjet e jashtme në ushtrim të funksionit të tyre.
2. Paga e magjistratit caktohet në bazë të kritereve të mëposhtme:
a) shkalla e gjykatës ose prokurorisë ku magjistrati ushtron funksionin;
b) vjetërsia në ushtrimin e funksionit;
c) fusha e veçantë e kompetencës lëndore në të cilën magjistrati ushtron funksionin;
ç) pozicioni drejtues.
3.Përfitimet e tjera financiare përfshijnë:
a) kompesim për transferimin e përkohshëm, ose skemën e delegimit;
b) shpërblim për aftësi;
c) pension shtetëror suplementar sipas parashikimit të këtij ligji dhe legjislacionit për pensionet shtetërore suplementare;
ç) çdo përfitim tjetër duke u bazuar në kushtet e veçanta të punës ose gjendjen personale dhe atë familjare të magjistratit të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

## Neni 12
## Caktimi i pagës së magjistratit

1. Paga e magjistratit caktohet sipas përkatësisë së magjistratit në grupin dhe nivelin e pagës.
2. Paga e magjistratit ndahet sipas grupeve të pagave (G), bazuar në këto tregues:
a) Magjistrati që ushtron funksionin në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ ose prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë (G1);
b) Magjistrati që ushtron funksionin në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ, prokuroritë pranë gjykatave së Apelit, magjistratët që ushtrojnë funksionin në Gjykatën e Posaçme për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar shkalla e parë (G2);
c) Magjistrati që ushtron funksionin në Gjykatën e Lartë dhe Prokurorinë e Përgjithshme, ashtu si dhe magjistratët që ushtrojnë funksionin në Gjykatën e Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të organizuar si dhe Prokurorinë e Posaçme (G3).
3. Shtesa për vjetërsi në ushtrimin e funksionit llogaritet në masën 2% të pagës referuese bazë për çdo vit shërbimi në funksion, por jo më shumë se 25 vjet shërbim.
4. Në rastin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, të emëruar nga radhët e juristëve që nuk vijnë nga karriera gjyqësore, për efekt të përcaktimit të vjetërsisë së ushtrimit në detyrë, shtesa për vjetërsi llogaritet në mënyrë të barazvlefshme me atë të 15 vjetëve karrierë gjyqësore.
5. Paga mujore bruto e magjistratit përbëhet nga elementët si vijon:
a) Paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë, e cila është e njëjtë me "pagën për funksion" të punonjësve të shërbimit civil të kategorisë së parë, klasa e tretë në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme në Kryeministri, ose me çdo pozicion tjetër të barazvlefshëm me të, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave. Referimi i pagës mujore bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë me "pagën për funksion", sipas përcaktimeve të mësipërme, nuk ka si qëllim të përcaktojë vlerën relative të funksioneve gjyqësore dhe të prokurorisë me pozicionet e punës në shërbimin civil ose të mundësojë klasifikimin e tij në kategorinë ose klasën përkatëse.
b) Shtesa për pagën në grup, e cila është shuma që rezulton nga shumëzimi i pagës referuese bazë me koeficientin në përqindje sipas funksionit që magjistrati ushtron referuar pikës 2, të këtij neni, përkatësisht:
i) G1 90%;
ii) G2 98%;
iii) G3 106%.
c) Shtesa për vjetërsi e llogaritur mbi pagën referuese bazë sipas pikës 3 dhe 4 të këtij neni.
d) Shtesa për pozicionin drejtues, e përcaktuar sipas parashikimeve të nenit 14 të këtij ligji.
dh) Shtesë për vështirësi pune sipas parashikimeve të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"

## Neni 13
## Pagat e magjistratëve të komanduar dhe ndihmës magjistratëve

1. Me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe, magjistratët e komanduar, të cilët kanë ushtruar më parë funksionin e magjistratit, vazhdojnë të marrin pagën në përputhje me kriteret e karrierës dhe vjetërsisë për funksionet e kryera më parë.
2. Me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe, për magjistratët e komanduar, të cilët nuk kanë ushtruar më parë funksionin e magjistratit, zbatohen rregullat për caktimin e pagës së magjistratit të shkallës së parë.
3. Në rastet kur për pozicionet e komanduara zbatohet një skemë e veçantë pagash, magjistrati, përfiton pagën sipas kësaj skeme të veçantë gjatë komandimit. Pas mbarimit të mandatit të komandimit, magjistrati paguhet në bazë të pagës së pozicionit në të cilën kthehet, transferohet, caktohet ose ngrihet në detyrë.
4. Magjistrati i komanduar merr pagën më të lartë ndërmjet dy pagave. Në rastet kur pozicioni i komanduar nuk paguhet nga buxheti gjyqësor ose i prokurorisë, paga e parashikuar për pozicionet e komanduara në institucione të tjera, mbulohet nga buxheti i këtij institucioni, ndërsa diferenca në pagën përkatëse të magjistratit mbulohet nga buxheti gjyqësor ose i prokurorisë.

**Neni 14**
**Paga e magjistratëve në pozicione drejtuese**

1. Për ushtrimin e funksionit të kryetarit të gjykatës ose të prokurorisë, magjistrati përfiton 10% shtesë page mbi pagën bruto fillestare të tij.
2. Për ushtrimin e funksionit të nën kryetarit, kryetarit të seksionit, magjistratit të shtypit, këshilltari i etikës ose të magjistratit udhëheqës, magjistrati përfiton 5% shtesë page mbi pagën bruto fillestare të tij.
3. Këshillat miratojnë rregulla të hollësishme për kompensimin e shpenzimeve të magjistratëve të deleguar për të ushtruar funksionin e tyre në një degë të gjykatës dhe të prokurorisë.
4. Këshilli i Lartë i Prokurorisë miraton rregulla të hollësishme për kompensimin e punës jashtë orarit të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme të organizuar në raste të veçanta.
5. Për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, ose funksione të tjera të magjistratëve parashikuar në këtë ligj, do të ndiqen rregullat e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave për shpërblimin e anëtarëve të organeve kolegjiale.

**Neni 15**
**Kompesimi i magjistratëve në skemën e delegimit**

1. Magjistrati i deleguar merr një kompesim prej 60 % të pagës referuese bazë për pozicione si magjistrat në skemën e delegimit. Në rastet kur magjistrati që është në skemën e delegimit, caktohet të punojë në Tiranë ose në gjykata dhe në prokurori me një distancë jo më shumë se 45 km, kompesimi shtesë ulet me 1% për çdo ditë pune në këto zona qendrore. Ky kompensim është shuma që jepet për mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit dhe të transportit të magjistratit në skemën e delegimit. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë në konsultim me Ministrinë e Financave miraton rregulla më të detajuara.
2. Magjistrati, i cili transferohet përkohësisht sipas nenit 51 të këtij ligji, përfiton kompesim shtesë në vlerën jo më pak se 2% të pagës referuese bazë, për çdo ditë të ushtrimit të funksionit në gjykatën ose prokurorinë ku transferohet.

**Neni 16**
**Shpërblimi për aftësi**

1. Çdo vit, magjistratët, të cilët në vitin paraardhës kalendarik, në mënyrë të veçantë kanë patur vlerësimin më të lartë etik dhe profesional, marrin një shpërblim të barabartë me një pagë referuese bazë.
2. Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara lidhur me shpërblimin sipas pikës 1 të këtij neni duke:
a) kufizuar të drejtën e përfitimit për 5% të magjistratëve në vit të vlerësuar gjatë vitit të kaluar kalendarik;
b) përcaktuar kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e magjistratëve që gëzojnë këtë të drejtë.

**Neni 17**
**Kredi për shtëpi**

1. Magjistrati ka të drejtë që një herë gjatë ushtrimit të funksionit të tij, pasi të ketë ushtruar jo më pak se tre vjet të detyrës, të përfitojë kredi për shtëpinë të financuar nga shteti, në shumën e vlerës mesatare të një apartamenti prej 50 m2 në zonën e qendrës së qytetit ku magjistrati ushtron detyrën.
2. Për çdo anëtar të familjes, sipas parashikimeve të pikës 5 të këtij neni, i cili jeton në të njëjtën banesë me magjistratin, masa referuese e sipërfaqes së banesës shtohet me 10 m2 për person. Në rast se në një familje, dy persona kanë të drejtë të përfitojnë kredi për shtëpi të subvencionuar nga shteti, do të përfitohet vetëm nga një prej tyre.
3. Banesa e blerë nëpërmjet kredisë, lihet kolateral në bankë për sigurimin e kredisë.
4. Magjistrati ka të drejtën të gëzojë pronën për nevojat e tij, si dhe të familjes së tij për nevojat për strehim. Magjistrati ka të drejtë të shesë pronën gjatë kohës së amortizimit të kredisë dhe të blejë një banesë tjetër. Në rastet kur shuma e përfituar nga shitja është me e madhe se rritja e vlerës së tregut të pronës, atëherë diferenca do t'i kthehet shtetit. Magjistrati nuk ka të drejtë të japë me qira banesën e përfituar me kredi.
5. Magjistrati detyrohet t'i rimbursojë shtetit shumën e marrë dhe interesat e kredisë në rast se ndaj tij është dhënë masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.
6. Në rastin kur magjistrati, ose bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/sja, fëmija e tij nën moshën 18 vjeç, ka në pronësi pasuri pa kolateral që përmbush nevojat e strehimit ose kur ata kanë pasuri të mjaftueshme për të blerë një pronë të tillë, nuk gëzon të drejtën për kredi për shtëpi, sipas këtij neni.
7. Këshilli i Ministrave miraton legjislacionin mbështetës për marrëveshjet me bankat për skemën e huamarrjes, në të cilën do të parashikohen kriteret dhe kushtet për kontratën e kredisë, si dhe detyrimet e shtetit lidhur me interesat e huamarrjes. Këshilli i Ministrave miraton rregulla më të detajuara për procedurën e dhënies së kredisë për shtëpi, si dhe kriteret dhe kushtet që magjistrati përmbush në përputhje me parashikimet e këtij neni.

**Neni 18**
**Rregulla të hollësishme për pagat dhe përfitimet e tjera financiare**

Këshilli argumenton në mënyrë të detajuar në projekt buxhetin e tij kriteret dhe kushtet për shtesat dhe uljet e pagës.

**Neni 19**
**Bursa e shkollimit për kandidatët magjistratë**

1. Kandidati për magjistrat, i cili pranohet të ndjek kursin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës përfiton bursë shkollimi sipas këtyre treguesve:
a) në vitin e parë: 30% të pagës bruto fillestare të tij;
b) në vitin e dytë: 40% të pagës bruto fillestare të tij;
c) në vitin e tretë: 50% të pagën bruto fillestare të tij.
2. Kandidati magjistrat që merr më shumë se 90% të pikëve gjatë një viti akademik, sipas përcaktimeve të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, përfiton në vitin pasues akademik një shtesë në masën 10% të bursës së shkollimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni .
3. Rregullat e nenit 27, pika 3, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.
4. Kandidati për magjistrat është i detyruar të kthejë shumën e përfituar të bursës së shkollimit brenda një viti, në rastet kur:
a) kandidati është përjashtuar ose ka lënë Shkollën;
b) në rastet kur kandidati për magjistrat nuk kandidon për t'u emëruar në një pozicion brenda një viti nga përfundimi i formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës.
5. Kandidati magjistrat duhet të kthejë 50% të shumës së përfituar të bursës së shkollimit që është marrë gjatë tre viteve të kursit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në rastet kur:
a) kandidati për magjistrat nuk plotëson kushtet e emërimit si magjistrat sipas nenit 40 të këtij ligji;
b) mandati i magjistratit ka përfunduar përpara plotësimit të paktën të pesë viteve të ushtrimit të funksionit.
6. Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, për shkaqe shëndetësore ose për shkaqe të tjera të justifikuara, miraton me vendim përjashtimin e kandidatit magjistrat nga detyrimi për kthimin e shumës së përfituar të bursës së shkollimit sipas parashikimeve e pikës 4 të këtij neni si dhe rastet e parashikuara në pikën 5, shkronja "b" e këtij neni.

**Neni 20**
**Mbrojtja e veçantë e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij**

1. Gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij, magjistrati dhe familja e tij gëzojnë të drejtën të kenë mbrojtje të veçantë nga shteti për jetën, shëndetin dhe pasurinë e tyre. Magjistrati që nuk e ushtron funksionin ose që ka dalë në pension gëzon këtë mbrojtje, në rast se e kërkon si dhe në rast cënimi për shkak të ushtrimit të mëparshëm të funksionit të magjistratit.
2. Në rast se jeta, shëndeti dhe pasuria e magjistratit ose familja e tij janë në rrezik, shteti ofron mbrojtje të veçantë, si dhe mbrojtje fizike, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, pas konsultimit me Këshillat.
3. Dëmet e shkaktuara për jetën, shëndetin ose pasurinë e magjistratit ose familjes së tij/saj, shpërblehen nga shteti, në rast se këto dëme shkaktohen gjatë ushtrimit të funksionit të magjistratit ose për shkak të tij.

**Neni 21**
**Pensioni suplementar dhe përfitimet e tjera**

1. Magjistratët, përveç rasteve të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, përfitojnë pension shtetëror suplementar dhe përfitime të tjera të parashikuara nga ligji "Për pensionet suplementare" të njëjtë me funksionarët e parashikuar në grupin e dytë, sipas përcaktimit të shkronjës "a" të pikës 9, të nenit 1 të ligjit "Për pensionet shtetërore suplementare".
2. Magjistratët që ushtrojnë funksionin në Gjykatën e Lartë përfitojnë pension shtetëror suplementar dhe përfitime të tjera të parashikuara nga ligji "Për pensionet suplementare" të njëjtë me funksionarët e parashikuar në grupin e parë, sipas përcaktimit të shkronjës "b" të pikës 8, të nenit 1 të ligjit "Për pensionet shtetërore suplementare". Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe Prokurori i Përgjithshëm përfitojnë pension shtetëror suplementar dhe përfitime të tjera të parashikuar nga ligji për pensionet suplementare të njëjtë me funksionarët e parashikuar në grupin e parë, sipas përcaktimit të shkronjës "a" të pikës 8, të nenit 1 të ligjit "Për pensionet shtetërore suplementare".
3.Magjistratët përfitojnë këtë pension suplementar dhe përfitime të tjera suplementare sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për pensionet shtetërore suplementare të funksioneve kushtetuese dhe punonjësve të shtetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

**Neni 22**
**Paprekshmëria e pagës dhe përfitimeve të tjera financiare të magjistratit**

1. Paga dhe përfitimet e tjera të magjistratit nuk mund të ulen, me përjashtim të rasteve kur:
a) ka situata të vështira financiare në vend ose emergjenca të tjera kombëtare, duke marrë parasysh faktorët si vijon: një mospërputhje e qartë midis dinamikës së pagave të magjistratëve dhe dinamikës së pagave standarde në shërbimin civil; indeksi i pagesave ashtu si dhe indeksi i çmimeve të konsumatorit. Këto faktorë është e nevojshme që të vlerësohen, për të gjetur balancën mes paprekshmërisë së pagës dhe nevojës për të shmangur marrjen e borxheve të reja;
b) magjistrati ushtron të drejtën për t'u kthyer nga një pozicion të mëparshëm më të lartë ose më të specializuar ose me mandat të kufizuar dhe me pagesë më të lartë;
c) magjistrati ka masë disiplinore;
d) vjen si pasojë e një vlerësimi të ulët etik dhe profesional sipas parashikimeve të këtij ligji.
2. Magjistrati duhet të kthejë shumat e përfituara të pagës ose përfitimeve financiare nëse ka përfituar më shumë se sa është parashikuar në ligj.

## KREU IV
## LEJA DHE ULJA E KOHËS SË PUNËS

**Neni 23**
**Pushimet vjetore**

1. Magjistrati gëzon të drejtën për pushime vjetore të paguara me kohëzgjatje 25 ditë pune.

2. Magjistrati që ushtron funksionin në Gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme, ka të drejtë të përfitojë pesë ditë pune shtesë leje vjetore.
3. Pushimet vjetore për magjistratin që autorizohet të punojë me kohë të pjesshme, zbriten në përpjesëtim me kohën e punës që kryen.
4. Në vitin kur magjistrati caktohet në pozicion ose largohet prej tij ose kur është me leje prindërore, gëzon të drejtën për pushime të pjesshme vjetore të paguara, të cilat përcaktohen në raport me kohëzgjatjen në funksion, si vijon:
a) 2 ditë pune leje për çdo muaj të plotë në funksion;
b) 2 ditë pune leje për një muaj jo të plotë, prej më shumë se 15 ditë pune;
c) 1 ditë pune leje për një muaj jo të plotë deri në 15 ditë pune.
5. Pushimet vjetore mund të merren njëherësh ose në periudha të ndryshme, sipas kërkesës së magjistratit dhe në përputhje me kërkesat e funksionit. Në çdo rast, pushimet duhet të përfshijnë një periudhë tre javore pa ndërprerje, gjatë muajit gusht, përveç kur kërkesat e ushtrimit të funksionit kërkojnë vazhdimin e aktiviteteve të gjykatës ose prokurorisë.
6. Magjistrati i sapo caktuar në pozicion, përfiton pushime vjetore vetëm pasi ka ushtruar funksionin për një periudhë tre mujore. Përjashtimisht, pushimet mund të miratohen para këtij afati, në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara.
7. Magjistrati që kalon sëmundje gjatë pushimeve vjetore, të cilat mund ta pengonin atë në ushtrimin e funksionit nëse nuk do të ishte me pushime, përfiton shtyrje të kohëzgjatjes së pushimeve vjetore, të njëjtë me kohëzgjatjen e sëmundjes, me kushtin që kjo e fundit të vërtetohet me raport mjekësor.
8. Magjistrati që nuk merr pushimet e plota vjetore deri në fund të vitit përkatës kalendarik, për arsye që nuk lidhen me kërkesa të funksionit, mund të shtyjë kohëzgjatjen e mbetur të pushimeve në vitin pasardhës, me kushtin që kohëzgjatja e mbetur të jetë deri në pesë ditë. Leja e prapambetur mund të merret deri në fund të muajit Mars të vitit pasardhës. Magjistrati që nuk ka marrë pushimet e plota vjetore në kohën e largimit nga funksioni, përfiton kompensim në pagesë, të barabartë me një të tridhjetën e pagës që merrte para largimit, për çdo ditë pushimi të mbetur. Shuma e përllogaritur, sipas kësaj pike, zbritet nga pagesa që magjistrati duhet të përfitojë, në rast se në kohën e largimit nga funksioni, ka marrë më shumë pushime vjetore sesa ka patur të drejtë deri në atë moment.
9. Magjistrati që ndërpret pushimet vjetore për shkak të kërkesave të funksionit ose që i anulohen këto pushime, gëzon të drejtën për t'u kompensuar për të gjitha shpenzimet e kryera, veçanërisht shpenzimet e transportit, nëse ato vërtetohen me dokumentacionin e nevojshëm.
10. Me përjashtim të rasteve të sëmundjes ose aksidentit, magjistrati nuk mund të kryejë mungesa në detyrë. Nëse magjistrati ka kryer mungesa në detyrë të cilat nuk janë miratuar, ato zbriten nga periudha e pushimeve vjetore. Pavërësisht nëse jepet masë disiplinore ose jo, magjistrati, nuk paguhet për ditët e munguara.
11. Pushimet vjetore jepen nga Kryetari i gjykatës ose prokurorisë. Kërkesa për leje vjetore për një periudhë më shumë se tre ditë, i drejtohet kryetarit të paktën një muaj para marrjes së tyre.

**Neni 24**
**Pushimet e tjera**

1. Përveç pushimeve vjetore, magjistrati gëzon të drejtën të marrë në përputhje me Kodin e Punës:

a) pushime të tjera;
b) leje prindërore.
2. Leja e veçantë miratohet nga Kryetari i gjykatës ose prokurorisë. Këshillat miratojnë lejen prindërore, pasi kanë marrë mendimin e Kryetarit të Gjykatës ose Prokurorisë.
3. Magjistrati mund të kërkojë leje të papaguar deri në 2 vjet për qëllime kualifikimi profesional dhe specializime në një institucion trajnimi, ose për arsye familjare ose shëndetësore. Leja e papaguar mund të merret e gjitha njëherësh ose në periudha të ndryshme sipas kërkesës së magjistratit.
4. Këshillat mund të japin lejen e papaguar pasi kanë marrë mendimin e Kryetarit të Gjykatës ose Prokurorisë, nëse leja nuk bie ndesh me interesat kryesore të funksionit dhe nuk vë në rrezik në tërësi përmbushjen e funksionit me efiçencë dhe në kohë, në gjykatë ose në prokurori.
5. Periudha e lejes së papaguar nuk merret në konsideratë për vjetërsinë në punë ose për efekt të përfitimeve të tjera.
6. Këshilli përcakton rregulla më të detajuara për kriteret dhe procedurat për dhënien e lejes së papaguar.

**Neni 25**
**Siguria dhe shëndeti në punë**

Me përjashtim të rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe, Këshillat, gjykatat dhe prokuroritë zbatojnë dispozitat e ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë.

## KREU V
## TË DREJTAT E TJERA

**Neni 26**
**Ulja e ngarkesës**

1. Magjistrati ka të drejtë për ulje të ngarkesës së çështjeve, në rast nevoje, për një nga këto shkaqe:
a) sëmundje e përkohshme, për një kohëzgjatje të kufizuar deri në dy vjet;
b) studime jashtë kursit të formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës, për një kohëzgjatje të kufizuar deri në tre vjet.
2. Ngarkesa e çështjeve mund të ulet deri në 75 përqind të ngarkesës në varësi të rrethanave.
3. Këshillat mund të vendosin ulje të ngarkesës së çështjeve të magjistratit, pas marrjes së mendimit të Kryetarit, nëse plotësohen këto kushte:
a) në rastin e parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 1 të këtij neni, sëmundja e magjistratit kërkon ulje të ngarkesës në punë, bazuar në raportin e Komisionit mjekësor të caktimit të aftësisë në punë;
b) në rastin e parashikuar në shkronjën “b”, të pikës 1 të këtij neni:
i) studimet kanë si qëllim të rrisin aftësitë profesionale të magjistratit;
ii) kur ulja e ngarkesës nuk cënon interesat thelbësorë të funksionit, afatet dhe ushtrimin në mënyrë efiçiente të funksioneve në gjykatën ose prokurorinë përkatëse.
4. Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara të cilat përcaktojnë:

a) procedurën që ndiqet për kërkesat për uljen e ngarkesës, veçanërisht detajimi për provat e duhura që duhet të paraqiten në mbështetje të një kërkese;
b) në rastet kur kërkesa pranohet, rregullat për uljen e pagës dhe përfitimeve të tjera, të bazuara në arsyet e shkronjës “a”, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, në përputhje me parimin e mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit duke patur në konsideratë nevojën për uljen e ngarkesës të shkaktuar nga një rrethanë jashtë vullnetit të magjistratit;
c) rregullat për uljen e pagës dhe përfitimeve të tjera në rastet kur kërkesa pranohet, për arsyet e parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 1 të këtij neni në përputhje me parimin e mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit;
ç) rregullat për përcaktimin e kohëzgjatjes gjatë të cilës ulet ngarkesa;
ç) rregulla të ndërmjetme për transferimin e një pjese të ngarkesës së magjistratit, në rastet kur kërkesa pranohet.
5. Ulja e pagës dhe përfitimeve të tjera nuk duhet të jetë më shumë se 75 përqind.

### Neni 27
### Pensioni i parakohshëm

1. Magjistrati gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm nëse:
a) ka mbushur të paktën moshën 60 vjeç;
b) ka ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 30 vjet, duke përfshirë edhe periudhën e komandimit;
c) nuk është në gjendje të ushtroj funksionin e tij, për shkak të sëmundjes të vërtetuar nga komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë në punë.
2. Magjistrati që ushtron funksionin në Gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe Prokurorinë e Posaçme, gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm tre muaj më parë, për çdo vit të ushtrimit të funksionit në këto struktura.
3. Këshillat miratojnë pensionin e parakohshëm të magjistratit, pasi kanë marrë më parë mendimin e kryetarit të gjykatës/prokurorisë.
4. Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara në të cilat përcaktohet:
a) procedura që ndiqet për kërkesat për pension të parakohshëm dhe dokumentacionin mbështetës;
b) rregullat për mënyrën e llogaritjes së pensionit të parakohshëm dhe përfitimeve të tjera, në rastet kur kërkesa pranohet.

## PJESA III
## ZHVILLIMI I KARRIERËS SË MAGJISTRATËVE

## KREU I
## REKRUTIMI I KANDIDATËVE MAGJISTRATË

### Neni 28
### Kriteret e pranimit në formimin fillestar

Çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t’u pranuar në formimin fillestar për magjistrat, nëse përmbush njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

a) ka zotësi të plotë për të vepruar;
b) është shtetas shqiptar;
c) ka përfunduar me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës, ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “master i shkencave”, si dhe ka dhënë provimin e shtetit për jurist në Shqipëri, ose ka kryer me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës, studimet universitare për drejtësi në një vend anëtar të Bashkimit Europian dhe ka marrë një diplomë të barazvlefshme, e njëhësuar sipas rregullave për njëhësimin e diplomave të parashikuar me ligj;
ç) ka të paktën tre vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë, në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlefshëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare;
d) nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë;
dh) nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi;
e) nuk është anëtar i partive politike në kohën e kandidimit;
ë) nuk ka qënë anëtarë, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga sigurimi i shtetit përpara vitit 1990;
f) nuk ka qënë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

**Neni 29**
**Thirrja për kandidatura**

1. Në Janar të çdo viti, Këshillat, pasi kanë kryer një analizë të nevojave, përcaktojnë dhe publikojnë numrin maksimal të kandidatëve magjistratë që pranohen në formimin fillestar për vitin e ri akademik.
2. Shkolla e Magjistraturës publikon thirrjen për kandidime për formimin fillestar, brenda një jave kalendarike nga data e publikimit të numrit maksimal të magjistratëve sipas pikës 1, të këtij neni nëpërmjet shpalljes së njoftimit:
a) në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Shkollës së Magjistraturës;
b) në të paktën një prej gazetave me tirazh më të lartë në vend.

**Neni 30**
**Kandidimi dhe vlerësimi paraprak i kandidatëve**

1. Shkolla e Magjistraturës pranon aplikimet për pranimin në formimin fillestar, deri në fund të muajit Shkurt të çdo viti.
2. Kandidatët paraqesin dokumentacionin e nevojshëm që vërteton përmbushjen e kritereve të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kritereve, nuk është i plotë, i saktë, ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, Shkolla e Magjistraturës mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga organet publike ose punëdhënësit e kandidatit.
3. Deri në datën 15 Mars të çdo viti, Shkolla e Magjistraturës kryen një vlerësim paraprak, nëse kandidati përmbush kriteret e kandidimit të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji.
4. Shkolla e Magjistraturës i paraqet Këshillave raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentat e kandidimit për secilin kandidat. Këshillat mund të japin komente ose kundërshtime jo më vonë se në fund të muajit Mars të çdo viti. Shkolla e

Magjistraturës miraton raportin e vlerësimit përfundimtar duke marrë në konsideratë komentet dhe kundërshtimet e bëra, dhe publikon raportin e vlerësimit përfundimtar në faqen e saj zyrtare, duke përfshirë listën e kandidatëve të cilët plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 28 të këtij.
5. Çdo kandidat, i cili nuk është përfshirë në listën e kandidatëve të cilët plotësojnë kriteret, ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore të ankimit të parashikuara në ligjin "Për Shkollën e Magjistraturës" dhe aktet nënligjore përkatëse.

**Neni 31**
**Provimi**

1. Shkolla e Magjistraturës organizon provimin për pranimin në formimin fillestar në përputhje me rregullat që parashikon Ligji "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë në Republikën e Shqipërisë". Provimi i pranimit zhvillohet në fund të muajit Prill të çdo viti dhe është i hapur për të gjithë kandidatët e përfshirë në listën e kandidatëve, siç përcaktohet në procedurat e vlerësimit të parashikuara në nenin 30 të këtij ligji.
2. Shkolla e Magjistraturës harton listën e renditjes e kandidatëve sipas rezultateve të provimit dhe publikon listën e miratuar, deri në datën 15 Maj të çdo viti, duke treguar në listë, numrin maksimal të kandidatëve të pranuar në formimin fillestar, në përputhje me vendimin e Këshillave, të marra sipas përcaktimeve të nenit 29 të këtij ligji.
3. Çdo kandidat ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore të ankimit të parashikuara në Ligjin "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë në Republikën e Shqipërisë".

**Neni 32**
**Verifikimi i pasurisë dhe figurës**

1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar sipas përcaktimeve të nenit 31 të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të pasurisë dhe figurës.
2. Brenda një jave nga publikimi i listës përfundimtare, sipas nenit 31 të këtij ligji, për secilin kandidat të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë.
3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre.
4. Në çdo rast, kandidati nuk pranohet në Shkollën e Magjistraturës kur:
a) raporti i Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve;

b) raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Shërbimit Informativ Shtetëror tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar sipas përcaktimeve të bëra në ligjin “Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për Luftën ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar”;
c) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur të parashikuar sipas ligjit.
5. Deri në datën 5 Shtator të çdo viti, Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre.
6. Kandidatët kanë të drejtë të njihen me dosjen dhe të ankohen në gjykatën kompetente ndaj vendimit të Këshillave, brenda 5 ditëve. Gjykata kompetente vendos për ankimin, brenda dy javëve nga paraqitja e tij.
7. Pas përfundimit të verifikimit të pasurisë dhe figurës, Këshillat miratojnë dhe publikojnë në fund të muajit Shtator të çdo viti, listën përfundimtare të kandidatëve magjistratë, që pranohen në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar tre vjeçar, në përputhje me numrin e kandidatëve të përcaktuar sipas nenit 29 dhe duke respektuar me përpikmëri renditjen e kandidatëve në listën e parashikuar në pikën 2, të nenit 31 të këtij ligji.

### Neni 33
### Praktika profesionale e kandidatëve magjistratë

1. Kandidatët gjyqtarë dhe kandidatët prokurorë kryejnë praktikën profesionale përkatësisht, në gjykata dhe në prokurori, në vitin e tretë të formimit fillestar. Praktika profesionale zgjat 12 muaj, duke filluar në muajin korrik dhe përfundon në muajin qershor të vitit pasardhës.
2. Këshillat përcaktojnë gjykatat dhe prokuroritë e shkallës së parë, për kryerjen e praktikës profesionale për kandidatët magjistratë, bazuar në këto tregues:
a) disponueshmërinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve udhëheqës;
b) infrastrukturën e gjykatës dhe të prokurorisë;
c) disponueshmërinë e hapësirës dhe mjediseve të punës për kandidatët magjistratë;
ç) mundësinë për t’u njohur me një numër të madh ligjesh dhe shumëllojshmëri çështjesh gjatë praktikës profesionale.
3. Këshillat caktojnë një trupë magjistratësh udhëheqës, me një kohëzgjatje prej tre vjetësh, me të drejtë riemërimi. Çdo magjistrat udhëheqës duhet të përmbushë njëkohësisht këto kritere:
a) të ketë të paktën pesë vjet përvojë si gjyqtar ose prokuror;
b) të jetë vlerësuar në përputhje me këtë ligj, të paktën “shumë mirë” në vlerësimin e fundit etik dhe profesional;
c) të ketë përfunduar me sukses trajnimin për udhëheqës në tre vitet e fundit, në Shkollën e Magjistraturës;
ç) të mos ketë qenë subjekt i masa disiplinore;
d) të ketë respektuar afatet ligjore për hetimin apo gjykimin e çështjeve, të paktën në vitin paraardhës përpara se të caktohet si udhëheqës.
4. Këshilli cakton udhëheqës për secilin prej kandidatëve magjistratë, me qëllim që secili prej tyre:
a) të ketë udhëheqës të ndryshëm për secilën nga tre periudhat katër mujore të njëpasnjëshme;
b) të fitojë përvojë profesionale në fushat e së drejtës civile, penale, dhe administrative;
c) të përfshihet sa më shumë që është e mundur në aspekte të punës së përditshme të magjistratit udhëheqës, pavarësisht nga fakti që nuk ushtron ende funksionin e magjistratit, duke përfshirë:
i) shpjegimet dhe diskutimet për çështjet e papërfunduara;
ii) pjesëmarrjen në seancat dëgjimore ose në marrjet në pyetje;

iii) aspektet në menaxhimin e çështjeve;
iv) përvojën në menaxhimin e dosjeve;
v) përgatitjen dhe diskutimin e projekt vendimeve;
vi) përvojën në administratën e gjykatës ose prokurorisë;
vii) aspekte për standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së magjistratëve.

5. Magjistrati udhëheqës të cilit i është caktuar një kandidat magjistrat përjashtohet nga hedhja e 10të e shortit për ndarjen e çështjeve në gjykatën ose prokurorinë pranë të cilës ushtron funksionin.

6. Magjistrati udhëheqës bën vlerësimin etik dhe profesional të secilit kandidat magjistrat, duke u bazuar në kriteret dhe nivelet e vlerësimit të përcaktuara në këtë ligj.

7. Gjatë praktikës profesionale, kandidati magjistrat gëzon të drejtën e pushimeve vjetore të paguara në kohëzgjatjen 25 ditë pune, nga të cilat, 15 ditë pune merren gjatë muajit gusht, në të njëjtën kohë me magjistratin udhëheqës. Kryetari i gjykatës ose i prokurorisë jep pushimet vjetore, pasi konsultohet me magjistratin udhëheqës të tij.

8. Me propozim të Shkollës së Magjistraturës, Këshillat nxjerrin udhëzime për vlerësimin e cilësisë së veprimtarisë së udhëheqjes.

9. Këshillat hartojnë rregulla të përbashkëta për caktimin e gjykatave, prokurorive dhe magjistratëve udhëheqës për programin e praktikës profesionale, vlerësimin etik, profesional, si dhe cilësisë së kandidatëve magjistratë, me qëllim që të garantohet një formim sa më i mirë i tyre.

**Neni 34**
**Lista e renditjes së kandidatëve magjistrat të diplomuar**

1. Çdo vit, deri në fund muajit qershor, Shkolla e Magjistraturës publikon listën e kandidatëve magjistrat të diplomuar në formimin fillestar, gjatë atij viti.

2. Të diplomuarit renditen në listë bazuar në rezultatet e provimeve gjatë vitit të parë dhe të dytë, provimit përfundimtar, si dhe vlerësimet gjatë praktikës profesionale.

3. Shkolla e Magjistraturës harton dhe publikon kriteret për koefiçientët e vlerësimit të praktikës profesionale dhe rezultatet e çdo provimi.

4. Të diplomuarit përfshihen përkatësisht në listën e të diplomuarve për kandidatët gjyqtarë dhe në listën e të diplomuarve për kandidatët prokurorë. Kandidatët magjistrat renditen në listën e të diplomuarve në përputhje me pikën 2 të këtij neni.

## KREU II
## EMËRIMI I MAGJISTRATËVE

**Neni 35**
**Emërimi i kandidatit magjistrat të diplomuar**

1. I diplomuari emërohet magjistrat nëse plotëson njëkohësisht këto kritere:
a) është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me të paktën 70% të pikëve maksimale të mundshme;
b) është vlerësuar minimalisht “mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar;

c) ka kaluar sërish verifikimin e pasurisë dhe figurës, të kryer nga Këshillat në përputhje me parashikimet në pikat 2 deri në 6 të nenit 32 të këtij ligji.
2. I diplomuari kandidon për t'u emëruar magjistrat pas marrjes së ftesës sipas pikës 1, të nenit 39 të këtij ligji dhe brenda një afati dy javor nga data e publikimit të listës së të diplomuarve. Për arsye të justifikuara, një i diplomuar mund të kandidojë për t'u emëruar në vitin pasues.
3.Kandidati për gjyqtar kërkon të emërohet si gjyqtar nëpërmjet një kërkese me shkrim drejtuar Këshillit. Në kërkesë përcaktohen sipas renditjes preferenciale tre gjykata në të cilat i diplomuari kërkon të emërohet. Kandidati për prokuror kërkon të emërohet si prokuror nëpërmjet një kërkese me shkrim drejtuar Këshillit. Në kërkesë përcaktohen sipas renditjes preferenciale tre prokurori në të cilat i diplomuari kërkon të emërohet.
4. Brenda afatit një mujor nga data e publikimit të listës së të diplomuarve, Këshillat:
a) emërojnë magjistrat, çdo person që është në listën e të diplomuarve, i cili përmbush kriteret e emërimit, si dhe ka paraqitur kërkesë, në përputhje me parashikimet e pikës 2 dhe 3 të këtij neni;
b) refuzojnë të emërojnë magjistrat, çdo person që është në listën e të diplomuarve që ka paraqitur kërkesë sipas pikës 2 dhe 3 të këtij neni, por nuk përmbush kriteret e emërimit.
5. Këshilli miraton rregulla të mëtejshme për arsyet e justifikuara për kandidimin në vitin pasardhës të mëvonshëm sipas parashikimeve të pikës 2 të këtij neni.

## Neni 36
## Emërimi magjistrat i ish gjyqtarëve dhe ish prokurorëve

1. Brenda afatit dy javor, nga data e publikimit të listës së të diplomuarve, ish gjyqtarët dhe ish prokurorët mund të kandidojnë për t'u riemëruar, pas marrjes së ftesës në përputhje me përcaktimet në pikën 1 të nenit 39 të këtij ligji. Kërkesa për t'u riemëruar si magjistrat duhet të përcaktojë renditjen preferenciale të tre gjykatave ose prokurorive.
2. Brenda afatit një mujor që nga data e publikimit të listës së të diplomuarve, Këshillat shqyrtojnë kërkesat e paraqitura për emërim dhe emërojnë magjistrat, kandidatët që:
a) përmbushin kriteret e shkronjave "a", "b", "d", "dh", "f" dhe "g" të nenit 28 të këtij ligji;
b) janë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës dhe kanë ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 5 vjet në 15 vitet e fundit;
c) nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 viteve të fundit përpara kërkesës për riemërim si magjistrat.
3. Brenda afatit një mujor nga data e publikimit të listës së të diplomuarve, Këshillat refuzojnë të riemërojnë çdo person që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 2, shkronja "a" të këtij neni.

## Neni 37
## Betimi

1. Magjistrati para fillimit të ushtrimit të funksionit bën betimin si më poshtë:
"Betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t'i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do të respektoj rregullat e etikës profesionale".
2. Betimi i magjistratit bëhet me një ceremoni publike.

## Neni 38
## Dosjet personale dhe regjistri i magjistratëve

1. Këshillat krijojnë dhe administrojnë dosjet personale dhe regjistrin e magjistratëve. Regjistri i magjistratëve është një bazë unike e të dhënave profesionale dhe personale të magjistratit.
2. Dosja personale e magjistratit duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:
a) emrin dhe adresën;
b) gjendjen civile, emrin dhe profesionin e bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve;
c) historinë e arsimimit;
ç) datën e emërimit;
d) pjesëmarrjen në kurset e trajnimit;
dh) çdo të dhënë me natyre disiplinore, penale dhe të dhënat e marra nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;
e) rezultatet e vlerësimit të veprimtarisë;
ë) ecurinë e detajuar të zhvillimit të karrierës;
f) datën dhe shkaqet e ndërprerjes së mandatit, sipas rastit.
3. Këshillat miratojnë rregulla të hollësishme për:
a) formatin e regjistrit dhe të dhënat që administrohen në të;
b) informacion shtesë që duhet të përfshihet në dosjet personale;
c) mënyrën e mbajtjes së dosjes personale dhe regjistrit;
d) pjesët e dosjes personale dhe regjistrit që aksesohen nga publiku.
4. Këshillat mbledhin dhe përpunojnë të dhënat në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

# KREU III
# CAKTIMI NË POZICION

## Neni 39
## Caktimi në pozicion i magjistratit të emëruar

1. Brenda muajit Qershor të çdo viti, pas përfundimit të procedurave të transferimit paralel dhe ngritjes në detyrë, secili Këshill shpall vendet e lira për të emëruarit.
2. Brenda muajit Korrik të çdo viti, secili Këshill publikon vendimet e tij për caktimin e të emëruarve në pozicionet e lira për magjistrat.
3. Caktimi në pozicion i të emëruarit të sapodiplomuar në Shkollën e Magjistraturës, është parësor dhe bazohet në:
a) renditjen e tyre në listën e të diplomuarve sipas nenit 34 të këtij ligji;
b) përmbushjen e preferencave të deklaruara nga të diplomuarit në formimin fillestar, duke e zbatuar për aq sa është e mundur, në përputhje me shkronjën “a”, pika 3 e këtij neni.
4. Pas caktimit të të emëruarve sipas përcaktimeve të pikës 3 të këtij neni, caktimi i magjistratëve të riemëruar sipas nenit 36 të këtij ligji, bazohet:
a) së pari në rezultatet e vlerësimit të aftësive profesionale sipas parashikimeve të nenit 49, të këtij ligji;

b) së dyti, në rastin kur ka barazi në aftësitë profesionale, mbizotëron kriteri i përvojës profesionale duke iu referuar viteve të përvojës në sistemin gjyqësor ose prokurorisë;
c) së treti, duke përmbushur preferencat e deklaruara nga magjistratët, në respektim të përcaktimeve të bëra në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, për aq sa gjejnë zbatim.
5. I emëruari që caktohet në pozicion në gjykatat administrative, duhet të ketë përvojë pune në të paktën një vit e gjysëm në administratën publike ose të ketë rezultate ”shumë të mira” në lëndët e së drejtës administrative, në Shkollën e Magjistraturës.

## Neni 40
## Caktimi i përkohshëm në pozicione të komanduara të të emëruarve

1. Brenda afatit kohor të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të nenit 39, të këtij ligji, në rastin kur numri i kërkesave për t’u caktuar në pozicion është më i madh se numri i vendeve të lira për magjistrat, Këshillat e caktojnë të emëruarin në një pozicion të komanduar në një institucion

2. Në rastet kur i emëruari caktohet në një pozicion të komanduar në një insitucion:
a) Këshillat i ofrojnë të emëruarit mundësinë e zgjedhjes për të paktën dy pozicione, sipas radhës së renditjes së tyre në listën e të diplomuarve;
b) i emëruari i caktuar në një pozicion të komanduar në një institucion, duhet të marrë pjesë në procedurën e radhës të lëvizjes paralele në shkallën e parë, me qëllim që të caktohet sa më shpejt në një pozicion të lirë si magjistrat;
c) i emëruari i caktuar në një pozicion të komanduar në një institucion përfiton pagë dhe përfitime të tjera financiare të barabarta me ato që përfitojnë magjistratët e shkallës së parë.
3. Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara për përcaktimin e kritereve, kushteve dhe procedurën e caktimit të të emëruarve në pozicione të komanduara, me qëllim që të sigurojë që pozicioni për çdo të emëruar të jetë i përshtatshëm me profilin e magjistratit.

## Neni 41
## Të drejtat dhe detyrimet e të emëruarit

1. I emëruari duhet të pranojë pozicionin e ofruar në përputhje me nenet 39 dhe 40 të këtij ligji, duke përfshirë:
a) pozicionin që nuk është deklaruar në preferencat e tij;
b) pozicionin e komanduar.
2. I emëruari ka të drejtë të ankimojë vendimin për caktimin në pozicion. Ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimit. Gjykata kompetente merr vendimin brenda dy javëve nga dita e ankimit. Vendimi i gjykatës kompetente është i formës së prerë.
3. Vendimi i Këshillit për caktimin e të emëruarit në pozicion në përputhje me këtë nen, merr formë të prerë kur:
a) nuk është depozituar ankim brenda afateve të ankimit;
b) është depozituar ankim sipas afateve dhe gjykata ka vendosur pushimin e çështjes ose rrëzimin e ankimit;
c) është depozituar ankim sipas afateve dhe mbi bazën e tij është me vendim gjyqësor të formës së prerë.
4. Në rastet kur gjykata pranon ankimin dhe shfuqizon vendimin e Këshillit, ky i fundit brenda dy javësh nga njoftimi i vendimit gjyqësor rishikon vendimin e caktimit në pozicion të të emëruatit, në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës.

## KREU IV
## TRANSFERIMI

### Neni 42
### Parimet e Transferimit

1. “Transferimi” është:
a) lëvizja në mënyrë të përkohshme ose të përhershme nga një pozicion në një gjykatë ose prokurori në një pozicion në një gjykate ose prokurorie tjetër të të njëjtit nivel;
b) caktimi nga një pozicion i komanduar në një pozicion në gjykatë ose në prokurori, i cili është në të njëjtin nivel me pozicionin e mëparshëm;
c) caktimi nga një pozicion i komanduar në një pozicion në gjykatë ose në prokurori të shkallës së parë nëse magjistrati nuk ka patur pozicione të mëparshme.
2. Transferimi bëhet në një pozicion të lirë të përhershëm ose të përkohshëm. Pozicioni është i lirë në mënyrë të përhershme vetëm nëse nuk ka magjistratë me të drejtën për t’u kthyer në atë pozicion. Pozicioni është përkohësisht i lirë kur magjistrati që ka atë pozicion në mënyrë të përhershme, për të paktën 3 muaj, është përkohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në atë pozicion.
3. Një pozicion i lirë i përhershëm plotësohet me radhë si më poshtë:
a) nga magjistrati që ka të drejtën për t’u caktuar në një pozicion në nivel apeli;
b) nga magjistrati që transferohet për shkak të papajtueshmërisë ambientale ose për shkak të ndryshimeve në strukturën administrative ose në kompetencën tokësore të gjykatave ose prokurorive;
c) nga magjistrati që transferohet për shkak të lëvizjes paralele;
ç) nga magjistratit që ka të drejtën e ngritjes në detyrë.
4. Një pozicion i lirë në mënyrë të përkohshme plotësohet nga magjistrati që ka të drejtën për t’u kthyer. Gjatë periudhës, sipas parashikimeve të pikës 2, të këtij neni, pozicioni përkohësisht i lirë, plotësohet përkohësisht me radhë si më poshtë:
a) nga magjistrati që ka të drejtën për t’u caktuar në një pozicion në nivel apeli;
b) nga magjistrati që transferohet për shkak të papajtueshmërisë ambientale ose për shkak të ndryshimeve në strukturën administrative ose në kompetencën tokësore të gjykatave ose prokurorive;
c) nga magjistrati që transferohet për shkak të lëvizjes paralele;
ç) nga magjistratit që ka të drejtën e ngritjes në detyrë.
5.Magjistrati nuk transferohet pa pëlqimin e tij-përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.
6.Magjistrati nuk ulet në detyrë pa pëlqimin e tij në një pozicion më të ulët, përveç rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe.
7.Në rastin e transferimit të përkohshëm, magjistrati kthehet në pozicionin e mëparshëm me përfundimin e periudhës së transferimit.
8.Një gjyqtar nuk lejohet të transferohet në mënyrë të përkohshme ose të përhershme në Gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

9. Në rast të hapjes së pozicioneve të lira në gjykatën e apelit administrativ, procedura e lëvizjeve paralele do të jetë e hapur vetëm për gjyqtarë që kanë punuar për të paktën për pesë vjet në 9 vitet e fundit si gjyqtar në çështjet administrative.

**Neni 43**
**Procedura e Lëvizjes Paralele**

1. Në zbatim të të nenit 42 pikave 3 dhe 4 të këtij ligji, Këshillat organizojnë të paktën çdo 3 muaj, procedurën e lëvizjes paralele për çdo pozicion, që:
a) është i lirë;
b) pritet të bëhet i lirë brenda 3 muajve.
2. Këshillat shpallin procedurën e lëvizjes paralele dhe i bëjnë thirrje për të kandiduar, magjistratëve të cilët plotësojnë këto kritere ligjore:
a) magjistrati që ushtron funksionin në gjykatë ose në prokurori të të njëjtit nivel me pozicionin e lirë;
b) magjistrati që ushtron funksionin në gjykatë ose prokurori të një niveli më të ulët dhe është vlerësuar të paktën dy herë, me vlerësim jo më të ulët se “shumë mirë”, në dy vlerësimet e fundit;
c) magjistrati i komanduar që ka punuar më parë në gjykatë ose prokurori të të njëjtit nivel me pozicionin e lirë;
ç) në lidhje me pozicionet e lira në nivel apeli, magjistrati në skemën e delegimit, që ka përvojë profesionale sipas parashikimit të nenit 47 të këtij ligji, i cili ka shërbyer për të paktën katër vjet në skemën e delegimit dhe gjatë kësaj periudhe është caktuar të paktën për një vit në një pozicion në nivel apeli.
3. Kandidati që ka ushtruar funksionin si anëtar i Këshillit, përjashtohet nga procedura e lëvizjes paralele gjatë kohës së ushtrimit të funksionit si anëtar, si dhe tre vjet pas mbarimit të mandatit.
4. Në zbatim të pikës 2 të këtij neni shpallja publikohet të paktën në faqen zyrtare të Këshillit dhe duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm për pozicionin e lirë, si dhe të përcaktojë:
a) afatin e kandidimit, i cili është të paktën dy javë nga data e shpalljes së procedurës;
b) informacionin dhe dokumentacionin që i bashkëlidhet kandidimit;
c) procedurën e kandidimit dhe vendin e dorëzimit të dokumentacionit.
5. Pas shpalljes së pozicionit të lirë, magjistrati mund të kandidojë për jo më shumë se tre pozicione të lira ose pozicione që priten të bëhen të lira. Nëse magjistrati kandidon për më shumë se një pozicion, ai bën renditjen e tyre sipas preferencës.
6. Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të të drejtës për pozicionin e lirë ose nëse ka në fuqi një masë disiplinore.
7. Këshillat shqyrtojnë kandidimet dhe rendisin magjistratët që përmbushin kërkesat, sipas rezultateve të mëposhtme:
a) së pari, dy vlerësimet e mëparshme, duke përfshirë edhe ato si magjistrat i komanduar, duke pasur parasysh:
i) që përvoja në pozicionet e komanduara dhe si magjistrat në skemën e delegimit do të konsiderohet një vlerë e shtuar;
ii) në rastet e më shumë magjistratëve me të njëjtën nivel vlerësimi, magjistratët brenda grupit të magjistratëve me rezultatet më të larta të vlerësimit do të renditen sipas skemës së pikëve, të përcaktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

iii) së dyti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës “a” pika 7 e këtij neni, ka më shumë se një magjistrat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta magjistratë sipas përvojës profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë;
iv) së treti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës “b” pika 7 e këtij neni, ka më shumë se një magjistrat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta magjistratë sipas vjetërsisë si magjistrat.
8. Në rastet e lëvizjës paralele në gjykatë ose prokurori të shkallës së parë, kur nuk ka kandidime sipas pikës 7 të këtij neni, procedura e lëvizjes paralele hapet për magjistratët, të cilët nuk janë vlerësuar dy herë. Ata renditen duke u bazuar njëkohësisht:
a) në rezultatin e vlerësimit etik dhe profesional përkatës, sipas pikës 6 të këtij neni;
b) në renditjen në listën e të diplimuarve në Shkollën e Magjistraturës ose në vlerësimin profesional në rastin e magjistratit të riemëruar sipas nenin 36 të këtij ligjit.
9. Në rastet e lëvizjes paralele në gjykatë ose prokurori të shkallës së parë, kur nuk ka kandidime sipas pikës 8 të këtij neni, procedura e lëvizjes paralele hapet për magjistratët, të cilët nuk janë vlerësuar ndonjëherë. Ata renditen sipas pikës 8 shkronja “b” të këtij neni.
10. Këshillat shpallin pozicione të lira për magjistratët, sipas renditjes së parashikuar në pikën 7, 8 dhe 9 të këtij neni dhe në përputhje me rregullat e miratuara sipas pikës 12 të këtij neni.
11. Rregullat e nenit 41, pikat 2 deri në 4 aplikohen për aq sa gjejnë zbatim edhe në këtë nen.
12. Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara, të cilat përcaktojnë:
a) kriteret për vlerësimin etik dhe profesional ndërmjet magjistratëve me pikë të barabarta vlerësimi;
b) kriteret për vlerësimin e përvojës profesionale që kërkohet për pozicionin e lirë;
c) procedurën që ndiqet në rastin e pikëve të barabarta;
ç) zbatimin dhe përshtatjen e këtij neni për pozicionet e lira të përkohshme.

## Neni 44
## Transferimi pa pëlqim

1. Magjistratët transferohen pa pëlqim vetëm në këto raste:
a) në zbatim të masës disiplinore;
b) kur pozicioni i magjistratit suprimohet për shkak të ndryshimeve në strukturën administrative ose në kompetencën tokësore të gjykatave ose prokurorive, pas kryerjes së një vlerësimi bazuar në kritere objektive dhe transparente;
c) për shkak të krijimit të marrëdhënieve familjare që çojnë në papajtueshmëri ambientale sipas nenit 8 të këtij ligji;
ç) për shkak të mungesave të përkohshme të magjistratëve në gjykata dhe prokurori, të cilat nuk mund të plotësohen nga magjistratët që janë në skemën e delegimit, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 46 të këtij ligji.
2. Magjistrati, të cilit i suprimohet pozicioni, sipas shkronjës “b”, pikës 1 i këtij neni:
a) transferohet në pozicion në strukturën e re të të njëjtës shkallë, që ka në kompetencë tokësore gjykatën ose prokurorinë pranë të cilës magjistrati ka ushtruar më parë funksionin, ose kur kjo nuk është e mundur;
b) gëzon të drejtën të zgjedhë për t’u transferuar në çdo pozicion, që është i lirë apo pritet të bëhet i lirë brenda gjashtë muajve nga momenti i shkurtimit të pozicionit, në gjykatë ose prokurori të së njëjtit nivel, të të njëjtës kompetencë lëndore.

3. Për shkak të mungesave të përkohshme të magjistratëve sipas shkronjës “ç”, pikës 1 të këtij neni, Këshilli cakton një magjistrat nga skema e delegimit ose transferon një magjistrat përkohësisht sipas nenit 46 të këtij ligji.
4. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë në gjykatë, vendimin për transferim pa pëlqim. Shqyrtimi i i ankimit në gjykatë, nuk pezullon vendimin për transferim.

**Neni 45**
**Magjistratët në Skemën e Delegimit**

1. Magjistratët në të gjitha shkallët, me të paktën një vit përvojë në funksion, mund të kandidojnë për t’u komanduar në një pozicion, në skemën e delegimit, e cila krijohet në Këshill.
2. Magjistrati shërben në skemën e delegimit jo më shumë se 5 vjet.
3. Magjistrati që kandidon për pozicione në skemën e delegimit, nënshkruan një deklaratë për dhënien e pëlqimit për t’u caktuar në çdo gjykatë ose prokurori.
4. Këshilli cakton magjistratin në skemën e delegimit në bazë të nevojave të një gjykate ose prokurorie:
a) në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin magjistrati përmbush kërkesat;
b) në një pozicion në Gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose Prokurori të Posaçme, nëse magjistrati përmbush kriteret sipas nenit 47 të këtij ligji, si dhe jep pëlqimin sipas kërkesës së pikës 3, të nenit 47 të këtij ligji.
5. Në pritje për t’u caktuar pranë një gjykate ose prokurorie, sipas parashikimeve të këtij neni, magjistrati në skemën e delegimit shërben në strukturat administrative të Këshillave.
6. Kryetari i gjykatës ose i prokurorisë ka të drejtë t’i kërkojë Këshillit, caktimin për një periudhë të caktuar të magjistratit nga skema e delegimit në gjykatën ose prokurorin përkatëse, duke paraqitur arsyet e nevojës për caktimin e magjistratit dhe të periudhës kohore të kërkuar.
7. Këshilli vlerëson kërkesën brenda 3 ditësh nga marrja e saj. Nëse Këshilli vlerëson se ka nëvojë në gjykatën ose prokurorinë respektive, cakton magjistratin nga skema e delegimit duke vlerësuar njëkohësisht:
a) plotësimin e kërkesave për pozicionin respektiv;
b) disponueshmërinë;
c) përvojën e veçantë profesionale të magjistratëve;
ç) caktimin në mënyrë të barabartë të magjistratëve në skemën e delegimit, në gjykatat apo prokuroritë e largëta.
8. Çdo Këshill miraton rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e magjistratëve si dhe kohën e shërbimit për skemën e delegimit.

**Neni 46**
**Transferimi i përkohshëm**

1. Në rastin kur në skemën e delegimit nuk ka magjistrat të disponueshëm, Këshilli mund t’i kërkojë magjistratit në një nga gjykatat ose prokuroritë me ngarkesën më të ulët, i cili përmbush kriteret për t’u transferuar ose për t’u ngritur në detyrë në pozicionin përkatës, të jap pëlqimin që për një periudhë të caktuar të transferohet përkohësisht në atë pozicion. Në këtë rast, Këshilli merr paraprakisht mendimin e kryetarit të gjykatës ose prokurorisë ku ushtron funksionin magjistrati.

2. Në rastin kur asnjë magjistrat nuk jep pëlqimin për t'u transferuar përkohësisht, Këshilli i kërkon një magjistrati nga një gjykatë ose prokurori me ngarkesë më të ulët për t'u transferuar përkohësisht. Ky magjistrat duhet të jetë me përvojën më të pakët si magjistrat në atë gjykatë ose prokurori si dhe duhet të përmbush kriteret për pozicionin që kërkohet për t'u transferuar përkohësisht, Në këtë rast, Këshilli merr paraprakisht mendimin e kryetarit të gjykatës ose prokurorisë ku ushtron funksionin magjistrati.
3. Për çështje voluminoze dhe komplekse, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme mund t'i kërkojë Kryetarit të prokurorisë së shkallës së parë, të japë pëlqimin për transferimin e prokurorëve me kualifikim të veçantë në zyrën e Prokurorisë së Posaçme, për të punuar me çështje të veçanta, për një periudhë të caktuar.
4. Para se të merret vendimi për transferimin sipas pikës 3 të këtij neni, kryetari i Prokurorisë së Posaçme kërkon mendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për transferimin dhe kualifikimin e prokurorit përkatës. Këshilli i Lartë i Prokurorisë mund të japë mendim jo të detyrueshëm të paktën tre ditë pas marrjes së kërkesës.
5. Prokurori përkatës që kërkohet të transferohet duhet të ketë jo më pak se pesë vite përvojë si prokuror, të japë pëlqimin për transferimin dhe respektimin e kushtet e sigurisë për besimin dhe konfidencialitetin në Prokurorinë e Posaçme sipas pikës 3 të nenit 47 të këtij ligji. Pas dhënies së pëlqimit nga kryetari i prokurorisë përkatëse, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme transferon prokurorin për periudhën për të cilën është rënë dakord. Prokurori gëzon të drejtën të marr pagën më të lartë, vetëm gjatë periudhës së trasferimit.
6. Magjistrati transferohet në mënyrë të përkohshme për një periudhë të caktuar, por në çdo rast nuk duhet të zgjasë më shumë se një vit.

## KREU V
## NGRITJA NË DETYRË

### Neni 47
### Kriteret minimale të përvojës profesionale për ngritjen në detyrë

1. "Ngritja në detyrë" është kalimi nga:
a) një pozicion në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në një pozicion tjetër të një niveli më të lartë;
b) një pozicion i juridiksionit të përgjithshëm civil, penal ose administrativ në një pozicion në një prej Gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme;
c) një pozicion si magjistrat, në pozicionin e kryetarit të një gjykate ose prokurorie;
ç) një pozicion i komanduar ose pozicion në skemën e delegimit, në një pozicion të një niveli më të lartë se sa pozicioni i mbajtur para komandimit.
2. Magjistrati ngrihet në detyrë nëse plotëson këto kritere minimale për përvojën profesionale:
a) për pozicionin gjyqtar në Gjykatën e posaçme të shkallës së parë për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar.
b) për pozicionin gjyqtar apeli në Gjykatën e posaçme të apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se

dhjetë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
c) për pozicionin prokuror në Prokurorinë e Posaçme, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin për jo më pak se dhjetë vjet si prokuror, duke përfshirë edhe përvojën si prokuror i komanduar.
3. Për të gjitha pozicionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, magjistrati duhet të përmbushë edhe kriteret e tjera dhe kushtet e sigurisë të parashikuara në ligjin "Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për Luftën ndaj Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar".
4. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e të drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar.
5. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë, në pozicione pranë Gjykatës së Lartë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e të drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar.
6. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë, në pozicionin e kryetarit të gjykatës ose prokurorisë së shkallës së parë ose të dytë, nëse:
a) ka ushtruar funksionin e magjistratit jo më pak se shtatë vjet, gjatë të cilës, të paktën katër vjet në të njëjtën shkallë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar;
b) përmbush treguesit e kërkuar për aftësi organizative dhe drejtuese, të tilla si:
i) përvoja si zëvendëskryetar, kryetar i një seksioni ose magjistrat për çështjet e shtypit;
ii) përvoja në pozicione drejtuese në administratën publike ose të drejtësisë, ose përvoja si anëtar i Këshillit, që ka përfunduar të paktën në tre vjet më parë;
iii) njohuri për strukturat organizative dhe modele të ndryshme të drejtimit, si magjistrat në skemën e delegimit ose inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
c) nuk ka qenë anëtar i Këshillit në tre vitet e fundit.

### Neni 48
### Ngritja në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuara

1. Pozicionet në Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme dhe Gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, plotësohen nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Pozicionet në gjykatat e tjera të apelit plotësohen nëpërmjet procedurave të levizjes paralele, në përputhje me nenet 42 dhe 43 të këtij ligji.
2. Në rastin kur ka shumë pozicione të lira, të cilat nuk plotësohen me lëvizje paralele, secili Këshilli organizon një procedurë ngritje në detyrë për çdo pozicion të lirë, të paktën një herë në çdo tre muaj. Pozicionet plotësohen jo më vonë se tre muaj nga dita e shpalljes së procedurës.
3. Këshillat shpallin procedurën e ngritjes në detyrë dhe bëjnë thirrje që të kandidojë:
a) magjistrati që plotëson kriteret për ngritjen në detyrë në përputhje me kërkesat e pozicionit të lirë të shpallur;
b) magjistrati i komanduar ose magjistrati në skemën e delegimit që plotëson kriteret për ngritjen në detyrë në përputhje me kërkesat e pozicionit të lirë të shpallur;
c) juristi i spikatur sipas përcaktimeve të nenit 49 të këtij ligji.
4. Kandidati që ka ushtruar funksionin si anëtar i Këshillit, përjashtohet nga procedura e ngritjes në detyrë gjatë kohës së ushtrimit të funksionit si anëtar, si dhe tre vjet pas mbarimit të mandatit.

5. Në zbatim të pikës 3 të këtij neni shpallja publikohet të paktën në faqen zyrtare të Këshillit dhe duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm për pozicionin e lirë, si dhe të përcaktojë:
a) afatin e kandidimit, i cili është të paktën dy javë nga data e shpalljes së procedurës;
b) informacionin dhe dokumentacionin që i bashkëlidhet kandidimit;
c) procedurën e kandidimit dhe vendin e dorëzimit të dokumentacionit.
6. Pas shpalljes së procedurës së ngritjes në detyrë, kandidati mund të kandidojë për jo më shumë se tre pozicione të lira ose pozicione që priten të bëhen të lira. Nëse magjistrati kandidon për më shumë se një pozicion, ai bën renditjen e tyre sipas preferencës.
7. Këshilli verifikon kandidatët sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32 të këtij ligji.
8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës dhe që nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë.
9. Këshillat shqyrtojnë kandidimet dhe rendisin kandidatët që përmbushin kriteret, sipas rezultateve të mëposhtme:
a) së pari, dy vlerësimet e mëparshme, duke pasur parasysh:
i) që përvoja në pozicionet e komanduara, si magjistrat në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vite përpara kandidimit do të ketë përparësi;
ii) në rastet e më shumë kandidatëve me rezultate të njëjta, magjistratët brenda grupit të kandidatëve me rezultatet më të larta të vlerësimit do të renditen sipas skemës së pikëve, të përcaktuar nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor.
b) së dyti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës “a” pika 9 e këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë sipas përvojës profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë;
c) së treti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës “b” pika 9 e këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të lartë, Këshilli rendit këta kandidatë sipas vjetërsisë si magjistrat ose jurist.
10. Këshillat vendosin të ngrenë në detyrë kandidatët e vlerësuar me pikët më të larta të arritura sipas procedurës dhe rregullave të parashikuara në pikën 9 dhe 14 të këtij neni. Rregullat e parashikuara në nenin 41, pikat 2 deri në 4 aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.
11. Për procedurën e ngritjes në detyrë, për plotësimin e një pozicioni të lirë në Gjykatën e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor propozon me shkrim, emërimin e kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore, duke arsyetuar përmbushjen e kritereve dhe duke bërë renditjen e kandidatëve, sipas procedurës dhe rregullave të parashikuara në pikat 9 dhe 14 të këtij neni.
12. Propozimi për emërimin është i ankimueshëm. Rregullat e parashikuara në nenin 41, pikat 2 deri në 4 aplikohen për aq sa gjejnë zbatim. Këshilli bën publik vendimin përfundimtar të propozimit për emërim në faqen e tij zyrtare. Vendimi i këshillave për mos caktimin në detyrë në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe prokurorinë e posaçme është i formës së prerë.
13. Ngritja në detyrë e gjyqtarit me renditjen më të lartë, dekretohet nga Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 136, pika 2 e Kushtetutës.
14. Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara të cilat përcaktojnë:
a) kriteret për etikën dhe veprimtarinë profesionale ndërmjet kandidatëve me pikë të barabarta vlerësimi;
b) kriteret për vlerësimin e përvojës profesionale që kërkohet për pozicionin e lirë;
c) procedurën që ndiqet në rastin e pikëve të barabarta;
ç) zbatimin dhe përshtatjen e parashikimeve të këtij neni për pozicionet e lira të përkohshme.

**Neni 49**
**Emërimi i kandidatëve jo gjyqtarë në Gjykatën e Lartë**

1. Një e pesta e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, mund të përzgjidhen mes juristëve të spikatur, që kanë gradë shkencore në drejtësi, me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, jurist të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës.
2. Kandidatët jo gjyqtarë për pozicione në Gjykatën e Lartë, duhet:
a) të plotësojnë kriteret e përcaktuara në shkronjat nga “a”, “b”, “d”, “dh” dhe “f” , “g”, të nenit 28 të këtij ligji;
b) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose në pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit;
3. Kandidati që ka njohuri të një gjuhe të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian ka përparësi në vlerësim.
4. Këshilli i Lartë Gjyqësor publikon thirrjen për paraqitjen e kandidaturave në përputhje me përcaktimet e bëra në pikat 4 dhe 5, të nenit 48 të këtij ligji.
5. Këshilli vlerëson përmbushjen e kritereve sipas parashikimeve të pikës 2 të këtij neni dhe verifikon kandidatët sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32 të këtij ligji. Kandidatët të cilët nuk përmbushin kriteret ose nuk kalojnë procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, përjashtohen nga kandidimi.
6. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson aftësitë profesionale të kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore, duke u bazuar në këto tregues:
a) ekspertizën e veçantë të kandidatit në fusha të veçanta të ligjit, sipas kërkesave të shpallura për pozicionin e lirë;
b) vlerësimin e punës së kandidatit, përmes të paktën pesë dokumenteve ligjore të hartuara nga kandidati gjatë përvojës së tij në profesion gjatë pesë viteve të fundit, si dhe çdo publikim shkencor dhe artikull akademik në fushën e ligjit;
c) rezultatet e studimeve të larta për drejtësi, të programit të formimit fillestar, përvojës në profesion ose çdo trajnimi tjetër;
ç) aftësitë gjuhësore të treguara nëpërmjet çertifikatave dhe gjatë intervistimit.
7. Bazuar në vlerësimin e aftësive profesionale, Këshilli përgatit një listë vetëm me kandidatët e renditur me vlerësimin më mirë mes të të gjithë kandidatëve, të cilët merren në pyetje në një seancë dëgjimore, për të marrë informacion lidhur me kriteret e parashikuara në pikën 8 të këtij neni.
8. Këshillat i rendisin kandidatët sipas vlerësimit të aftësive profesionale dhe intervistës duke ju referuar:
a) së pari rezultateve të vlerësimit të aftësive profesionale sipas parashikimeve të pikës 6 të këtij neni;
b) së dyti, në rastet e rezultateve të njëjta të vlerësimit të aftësive profesionale, viteve të eksperiencës profesionale të përshtashme për pozicionin e lirë.

9. Këshilli i Lartë Gjyqësor propozon me shkrim emërimin e kandidatëve. Propozimi duhet të jetë i arsyetuar në lidhje me përmbushjen e kritereve ligjore prej tyre, si dhe duhet të pasqyrojë renditjen e kandidatëve sipas kritereve të parashikuar në pikën 8 të këtij neni.
10. Vendimi i propozimit për emërim është i ankimueshëm. Rregullat e parashikuara në nenin 41, pikat 2 deri në 4 aplikohen për aq sa gjejnë zbatim. Këshilli bën publik vendimin përfundimtar të propozimit për emërim në faqen e tij zyrtare.
11. Gjyqtari me renditjen më të lartë, emërohet nga Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 136, pika 2 e Kushtetutës.
12. Këshilli miraton rregulla më të detajuara të cilat përcaktojnë:
a) kriteret për vlerësimin e përvojës në fusha të veçanta;
b) kriteret dhe procedurën për vlerësimin e aftësive profesionale;
c) procedurën që ndiqet në rastin e pikëve të barabarta.

**Neni 50**
**Emërimi i Prokurorit të Përgjithshëm**

Rregullat për procedurën dhe kriteret e emërimit të Prokurorit të Përgjithshëm parashikohen në ligjin “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

**Neni 51**
**Zgjedhja e Kryetarit të Gjykatës së Lartë**

1. Kryetari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga mbledhja e përgjithshme e gjykatës për një periudhë 3 vjeçare pa të drejtë rizgjedhjeje.
2. Kandidati që të zgjidhet kryetar i Gjykatës duhet:
a) Të ketë të paktën tre vjet përvojë profesionale në atë gjykatë;
b) të mos ketë masa disiplinore në fuqi;
c) të jetë vlerësuar të paktën “shumë mirë”, në dy vlerësimet e fundit etike dhe profesionale;
ç) gjyqtarët që caktohen sipas nenit 49 të këtij ligjit duhet të jenë vlerësuar të paktën “shumë mirë” në vlerësimin e mëparshëm etik dhe profesional.
3. Mbledhja e përgjithshme e të gjithë magjistratëve të gjykatës do të drejtohet nga kryetari i gjykatës në rastin e parashikuar në shkronjën “a” të pikës 4 të këtij neni dhe nga zëvendës kryetari në rast e parashikuar në shkronjën “b” të pikës 4 të këtij neni.
4. Kryetari i mbledhjes së përgjithshme fton të gjithë kandidatët e që përmbushin kriteret ligjore brenda një afati 10 ditor, për të kandiduar për t’u zgjedhur si kryetar:
a) të paktën dy muaj përpara datës së mbarimit të mandatit të kryetarit në detyrë;
b) të paktën brenda 10 ditëve pas mbarimit të parakohshëm të mandatit të kryetarit.
5. Kryetari i gjykatës njofton mbledhjen e përgjithshme, si dhe shpërndan listën e kandidatëve që kanë shprehur interesin për kryetar, anëtarëve të mbledhjes së përgjithshme të Gjykatës së Lartë të paktën një muaj para mbarimit të mandatit. Mbledhja e përgjithshme zhvillohet të paktën dy jave para mbarimit të mandatit të kryetarit.
6. Zëvendës kryetari i gjykatës njofton mbledhjen e përgjithshme, si dhe shpërndan listën e kandidatëve që kanë shprehur interesin për kryetar, anëtarëve të mbledhjes së përgjithshme të Gjykatës së Lartë të paktën dy javë pas kalimit të afatit të mbarimit të parakohshëm të mandatit të kryetarit. Mbledhja e përgjithshme zhvillohet të paktën një muaj pas mbarimit të parakohshëm të mandatit të kryetarit.

7. Vendimi për zgjedhjen e kryetarit duhet të merret me shumicën absolute të votave të të gjithë anëtarëve të mbledhjes së përgjithshme.
8. Nëse në votimin e parë asnjë nga kandidatët nuk ka marrë numrin e nevojshëm të votave, një votim i dytë mbahet menjëherë ndërmjet dy kandidaturave që kanë patur numrin më të madh të votave. Nëse edhe në votimin e dytë asnjë nga kandidatët nuk merr numrin e nevojshëm të votave, magjistrati me numrin më të madh të votave konsiderohet i zgjedhur. Në rastet e një barazimi votash, ka përparësi magjistrati me përvojë profesionale më të gjatë si magjistrat.
9. Këshilli miraton rregulla të detajuara për procedurat e mbledhjes së përgjithshme, votimin, mënyrën e numërimit të rezultatit të votimit.

### Neni 52
### Emërimi i kryetarëve të tjerë

1. Mandati i Kryetarit të gjykatave dhe prokurorive të tjera, me përjashtim të Prokurorit të Përgjithshëm, është tre vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Mandati i Kryetarit të Prokurorisë së Posaçme është tre vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje.
2. Jo më vonë se 6 muaj përpara mbarimit të mandatit të parë, kryetari i gjykatës ose prokurorisë me të drejtën e rizgjedhjes, mund të kandidojë për një mandat të dytë. Kur kryetari nuk kandidon për një mandat të dytë brenda afatit të përcaktuar, konsiderohet që ka dhënë dorëheqjen si kryetar në fund të mandatit.
3. Kur kryetari në detyrë kandidon për riemërim, i nënshtrohet verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Këshilli përkatës, jo më vonë se tre muaj para mbarimit të mandatit të parë, sipas rregullave të parashikuara në pikat nga 2 deri në 7, të nenit 32 të këtij ligji.
4. Kryetari riemërohet për një mandat tjetër vetëm nëse kalon me sukses verifikimin sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32 të këtij ligji, dhe nëse vlerësimi për veprimtarinë si kryetar dhe magjistrat, është të paktën "shumë mirë".
5. Këshilli merr vendim jo më vonë se tre muaj nga mbarimi i mandatit të kryetarit.
6. Në rastin kur kryetari jep dorëheqjen ose kur nuk pranohet i kërkesa për një mandat tjetër, Këshilli publikon shpalljen për vendin e lirë për pozicionin e kryetarit për kandidatët që i plotësojnë kriteret e ngritjes në detyrë, jo më vonë se tre muaj nga mbarimi i mandatit të kryetarit në detyrë.
7. Thirrja për aplikim i drejtohet magjistratëve në gjykatën ose prokurorinë përkatëse. Në rast se në gjykatën ose prokurorinë përkatëse, një pozicion bëhet në mënyrë të përhershme i lirë nga dy muaj përpara mbarimit të mandatit të kryetarit deri në tre muaj pas mbarimit të tij, thirrja për kandidim i drejtohet çdo magjistrati që plotëson kriteret për kryetar. Në rastin e Prokurorisë së Posaçme thirrja për kandidim për kryetar i drejtohet vetëm prokurorëve të kësaj prokurorie.
8. Në zbatim të pikës 7 të këtij neni shpallja publikohet të paktën në faqen zyrtare të Këshillit dhe duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm për pozicionin e lirë, si dhe të përcaktojë:
a) afatin e aplikimit, i cili është të paktën dy javë nga data e shpalljes;
b) informacionin dhe dokumentacionin që i bashkëlidhet aplikimit;
c) procedurën e aplikimit dhe vendin e dorëzimit të dokumentacionit.
9. Këshilli përkatës vlerëson në rast se kandidati i plotëson kriteret të parashikuara në pikën 6 të nenit 47. Ai kryen verifikim sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32 të këtij ligji. Kandidatët të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga ligji ose nuk kalojnë me sukses verifikimin e pasurisë dhe të figurës përjashtohen nga kandidimi.

10. Këshilli shqyrton aplikimet dhe rendit kandidatët që përmbushin kriteret, sipas rezultateve të mëposhtme:
a) së pari dy vlerësimet e mëparshme. Në rastet e më shumë kandidatëve me të njëjtën nivel vlerësimi, magjistratët brenda grupit të kadidatëve me rezultatet më të larta të vlerësimit renditen sipas skemës së pikëve, të përcaktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;
b) së dyti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës "a" pika 10 e këtij ligji, ka më shumë se një kandidat me pikë më të lartë, Këshilli rendit këta kandidatë sipas përvojës profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë;
c) së treti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës "b" pika 10 e këtij ligji, ka më shumë se një kandidat me pikë më të lartë, Këshilli rendit këta kandidatë sipas vjetërsisë si magjistrat.
11. Këshilli cakton në funksionin e kryetarit kandidatin më të mirë të listuar. Rregullat e parashikuara në nenin 41, pikat 2 deri në 4 për caktimin e të emëruarve të rinj në pozicion aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.
12. Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara të cilat përcaktojnë:
a) kriteret për vlerësimin etik dhe profesional ndërmjet magjistratëve me pikë të barabarta vlerësimi;
b) kriteret për matjen e aftësive organizative dhe drejtuese;
c) procedurën që ndiqet në rastin e rezultateve të barabarta.

## KREU VI
## KOMANDIMI

### Neni 53
### Parimet e komandimit të magjistratëve

1."Komandim" është lëvizja e magjistratit, në një pozicion jo-magjistrati në një Institucion brenda sistemit të drejtësisë, pozicion i cili është i pajtueshëm me pavarësinë dhe mbajtjen e statusit të tij.
2. "Institucioni në të cilin magjistrati komandohet", për pozicionin e ndihmës magjistratit është Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, ose Prokuroria e Përgjithshme; për pozicionet si inspektorë është Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; dhe për pozicione të tjera janë Këshillat, Ministria e Drejtësisë, Avokatura e Shtetit, Shkolla e Magjistraturës, ose çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë dhe përafrimit të legjislacionit.
3. Me përjashtim të rasteve të caktimit në pozicion të sapo emëruarve, magjistratët mund të komandohen vetëm me pëlqimin e tyre.
4. Magjistrati i komanduar ka të njëjtat të drejta dhe detyrime si çdo magjistrat tjetër, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.
5. Magjistrati nuk lejohet të komandohet në ato raste kur:
a) është në një pozicion me mandat të kufizuar;
b) është i komanduar.
6. Periudha e komandimit të magjistratit nuk mund të jetë më shumë se pesë vjet, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në ligj.
7. Magjistrati duhet të shërbejë jo më pak se pesë vjet si magjistrat pas përfundimit të periudhës së komandimit.

8. Magjistrati nuk mund të komandohet për më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës së tij.
9. Përvoja e magjistratit të komanduar nga gjykata ose prokuroria e shkallës së parë në institucionin në të cilin magjistrati komandohet, llogaritet përvojë në profesion në shkallë të parë, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe. Përvoja e magjistratit të komanduar nga gjykata ose prokuroria në shkallë të dytë institucioni në të cilin magjistrati komandohet llogaritet si përvojë në profesion në shkallë të dytë, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe. Ushtrimi i funksioneve drejtuese në institucionin në të cilin magjistrati komandohet vlerësohet si përvojë drejtuese.
10. Magjistratit të komanduar i bëhet vlerësimi etik dhe profesional nga institucioni në të cilin magjistrati është komanduar, në përputhje me kriteret dhe procedurën që zbatohet për anëtarët e tjerë të këtij institucion, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe. Nivelet e këtij vlerësimit njihen si nivele vlerësimi në kuptim të këtij ligji.
11. Magjistratit të cilit nuk i është bërë vlerësimi etik dhe profesional nga institucioni në të cilin magjistrati është komanduar ka të drejtën të vlerësohet për aftësitë profesionale si kandidat jo gjyqtar në Gjykatën e Lartë, me qëllim që të konkurrojë në kushte të njëjta me magjistratët e tjerë për pozicionet e lira, sipas parashikimeve të nenit 49 të këtij ligjit për aq sa gjejnë zbatim.
12. Magjistrati gjatë komandimit ka përgjegjësi disiplinore sipas parashikimeve që zbatohen për anëtarët e institucioni në të cilin magjistrati është komanduar. Në rastet kur institucioni në të cilin magjistrati është komanduar propozon shkarkimin e magjistratit si masë disiplinore, magjistrati i komanduar mund të kërkojë referimin e çështjes tek Këshilli. Në këtë rast Këshilli shqyrton çështjen dhe zbaton procedurën disiplinore sipas parashikimeve të këtij ligji. Institucioni në të cilin është komanduar magjistrati, merr pjesë në procedurën disiplinore me të drejtat dhe detyrimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
13. Nëse çështja nuk është referuar në Këshill, Institucioni në të cilin është komanduar magjistrati informon Këshillin për çdo vendim të ndërmarrë prej tij ndaj magjistratit të komanduar. Ankimi në gjykatë, i vendimit për masë disiplinore të Institucionit në të cilin është komanduar magjistrati, pezullon zbatimin e vendimit.

**Neni 54**
**Procedurat e Komandimit**

1. Çdo institucion i parashikuar në nenin 53, pika 2 e këtij ligji, ku komandohet magjistrati mund të kërkojnë nga çdo Këshill komandimin e magjistratëve, për një periudhë të përcaktuar, në çdo rast jo më shumë se pesë vjet.
2. Këshilli pasi ka bërë vlerësimin e nevojave të tij, brenda dy javëve nga paraqitja e kërkesës për kandidatura nga Institucionet sipas përcaktimeve të nenit 53 pika 2, për plotësimin e pozicioneve të komanduara shpall kërkesën për kandidatura për plotësimin e këtyre pozicioneve.
3. Këshillat pranojnë kandidaturat e magjistratëve, të cilët përmbushin kriteret specifike të pozicioneve që do të komandohen, nëpërmjet shpalljes, e cila publikohet të paktën në faqen zyrtare të Këshillit dhe duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm për pozicionin e lirë, si dhe të përcaktojë:
a) afatin e kandidimit, i cili është të paktën dy javë nga data e shpalljes;
b) informacionin dhe dokumentacionin që i bashkëlidhet kandidimit;
c) procedurën e kandidimit dhe vendin e dorëzimit të dokumentacionit.

4.Këshilli brenda dy javëve pas afatit të aplikimit, përgatit një opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e larta të gjykatës ose prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin. Opinioni për çdo kandidat publikohet në faqen zyrtare të Këshillit. Kandidati, komandimi i të cilit nuk është në përputhje me interesat e larta të gjykatës ose prokurorisë përjashtohet nga komandimi. Këshilli brenda dy javëve pas afatit të kandidimit, i dërgon Institucionit në të cilin do të bëhet komandimi emrat e kandidatëve që plotësojnë kriteret e pozicionit përkatës.
5. Institucioni ku kryhet komandimi i magjistratëve, vlerëson aplikimet dhe kërkon komandimin e magjistratit të përzgjedhur për një periudhë të caktuar kohe.
6. Këshilli merr vendim për komandimin e magjistratit brenda dy javëve nga marrja e kërkesës sipas përcaktimeve të pikës 5 të këtij neni. Vendimi përcakton kushtet e komandimit.
7. Në rastin kur kërkesa paraqitet nga institucione të tjera nga ato të parashikuar në nenin 53, pika 2 të këtij ligji, Këshilli mund të komandojë magjistratin në këto institucione sipas rastit, nëse komandimi është në interes publik dhe nuk cënon afatet dhe ushtrimin në mënyrë efiçente të funksioneve.

## Neni 55
## Komandimi i magjistratëve në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

1. Magjistratët që plotësojnë kriteret për t'u emëruar si magjistratë në Gjykatën e Lartë ose në Prokurorinë e Përgjithshme mund të komandohen në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Për procedurat e komandimit në plotësimin e pozicionit të Inspektorit, Këshilli përpara përgatitjes së opinionit, sipas parashikime të pikës 4 të nenit 54, verifikon kandidatët sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32 të këtij ligji.
3. Magjistrati, i cili komandohet si inspektor, konsiderohet magjistrat i ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë.
4. Magjistrati mund të komandohet si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për një periudhë pesë vjeçare. Pas mbarimit të periudhës pesë vjeçare, Inspektori ka të drejtën e ri-komandimit në rast se është vlerësuar të paktën “shumë mirë” në vlerësimin etik dhe profesional si inspektor.
5. Inspektori i Lartë i Drejtësisë tre muaj përpara mbarimit të afatit të mandatit të parë të komandimit të një inspektori, mund t’i paraqesë Këshillit kërkesë me shkrim, përfshirë dokumentet e nevojshme, për konfirmimin e inspektorit si i komanduar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Këshilli konfirmon inspektorin nëse ai është vlerësuar të paktën “shumë mire” në vlerësimin etik dhe profesional, si dhe nëse ka dhënë pëlqimin për konfirmimin. Kur kërkesa nuk është paraqitur në kohë, afati i pozicionit të komanduar si inspektor konsiderohet i mbaruar.
6. Inspektori ka të drejtën të caktohet në një pozicion në nivel apeli në fund të përfundimit të mandatit të komandimit në rast se është vlerësuar me vlerësimin “shumë mirë”, në të gjitha vlerësimet etike dhe profesionale si inspektor.

## Neni 56
## Komandimi në pozicionet e Ndihmës Magjistratit

1. Magjistrati mund të komandohet në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese dhe Zyrën e Prokurorisë së Përgjithshme me mandat pesë vjeçar, me të drejtë ripërsëritje, me kërkesë të Institucionit ku komandohet magjistrati.
2. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese ose i Gjykatës së Lartë tre muaj përpara mbarimit të afatit të mandatit të parë të komandimit të një ndihmës magjistrati, mund t'i paraqesë Këshillit kërkesë me shkrim për konfirmimin e ndihmës magjistratit si i komanduar në Gjykatën Kushtetuese ose Gjykatën e Lartë. Këshilli konfirmon ndihmës magjistratin nëse është vlerësuar të paktën "shumë mirë" në vlerësimin e etik dhe profesional, si dhe nëse ndihmës magjistrati ka dhënë pëlqimin për konfirmim.
3. Përcaktimet e pikës 2 të këtij neni aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.
për kërkesën respektive të Prokurorisë së Përgjithshme drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
4. Kur kërkesa nuk është paraqitur në kohë sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të këtij neni, afati i pozicionit të komanduar si ndihmës magjistrat konsiderohet i mbaruar.
5. Ndihmës magjistrati i caktuar në Gjykatën e Lartë dhe Zyrën e Prokurorisë së Përgjithshme ka përgjegjësi disiplinore dhe vlerësohet sipas dispozitave të këtij ligji, të cilat aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.

**Neni 57**
**Përfundimi i kohëzgjatjes së komandimit**

1. Afati i kohëzgjatjes së komandimit përfundon në fund të mandatit ose të mandatit të ripërsëritur sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit për pozicionin e komanduar.
2. Me kërkesë të magjistratit të komanduar, Këshilli pasi merr mendimin e Institucionit ku është komanduar magjistrati mund të përfundojë kohëzgjatjen e komandimit para afatit, për arsye të justifikuara.
3. Vetëm në ato raste kur magjistrati ka kryer të gjithë periudhën e komandimit, Këshilli e konsideron me përparësi në lëvizjen paralele ose në procedurat e ngritjes në detyrë.
4. Magjistrati ka të drejtë që pas periudhës të komandimit të kthehet në pozicionin e mëparshëm, përveç në rastet kur parashikohet ndryshe në ligj.

**Neni 58**
**Rregulla të detajuara për komandimin**

Këshillat miratojnë rregulla të detajuara për komandimin, pasi kanë marrë mendimin e Institucioneve ku komandohen magjistratët, për të siguruar që përvoja profesionale e magjistratit të shërbejë në Institucionet ku komandohet. Këto rregulla parashikojnë:
a) kohëzgjatjen maksimale të çdo komandimi jo më shumë se pesë vjet dhe parashikime të ndryshme mund të përcaktohen për raste të ndryshme;
b) numrin maksimal të periudhave gjatë të cilave magjistrati mund të komandohet dhe parashikime të ndryshme mund të bëhen për raste të ndryshme;
c) njohjen e rezultateve të vlerësimit në përputhje me parashikimet në këtë kre dhe rregullat për përshtatjen e parashikimeve për vlerësimin etik dhe profesional për pozicionet si ndihmës magjistrat.

**KREU VII**
**Mandati i kufizuar**

**Neni 59**
**Caktimi i përkohshëm**

1. Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhe jo më shumë se tre muaj, për shkak të:
a) caktimit në pozicione të tjera;
b) arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji.
2. Pozicionet e përkohshme krijohen në rastet e mëposhtme:
a)të komandimit të magjistratit;
b)të transferimit ose ngritjes në detyrë me mandat të kufizuar të magjistratit ose kur një pozicion është përkohësisht i lirë;
c)të lejes prindërore ose lejes së papaguar;
ç) arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji.
3. Transferimet e përkohshme në kuptim të nenit 46 të këtij ligji, nuk janë pozicione të përkohshme në kuptim të këtij neni.
4. Këshilli merr vendim për rastet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, si dhe përcakton datën e fillimit dhe datën e mbarimit të periudhës kohore në të cilën pozicioni mund të plotësohet përkohësisht.
5. Në rastet kur magjistrati që ka pozicion të përhershëm, vendi i të cilit është përkohësisht i lirë, i ka mbaruar statusi, ose është caktuar, transferuar ose ngritur në detyrë në një pozicion tjetër të përhershëm, pozicioni i plotësuar përkohësisht konsiderohet i përhershëm. Magjistrati që është caktuar përkohësisht në këtë pozicion njoftohet për ndryshimin e pozicionit nga një pozicion i përkohshëm në të përhershëm.
6. Në rastet kur në një gjykatë ose prokurori krijohet një pozicion i lirë i përhershëm, çdo magjistrat që mban një pozicion të përkohshëm në atë gjykatë ose prokurori mund të kërkojë që pozicioni i tij të bëhet i përheshëm.
7. Këshilli vendos për ndryshimin e një pozicioni të përkohshëm përpara se të shpallë thirrjen për lëvizje paralele ose ngritje në detyrë. Nëse ka disa magjistratë të cilët kanë pozicion të përkohshëm, që kandidojnë për ndryshimin e pozicionit, kriteret e transferimit zbatohen për aq sa është e mundur. Pozicioni i përkohshëm që mbetet i lirë plotësohet me lëvizje paralele ashtu si dhe me procedurën e ngritjes në detyrë.
8. Kur një pozicion është përkohësisht i lirë, ai mund të plotësohet vetëm përmes caktimit të përkohshëm të magjistratit. Kur magjistrati caktohet në një pozicion që është përkohësisht i lirë, ka të drejtë të kthehet në pozicionin e tij të mëparshëm nëse ishte caktuar në atë pozicion në mënyrë të përhershme. Nëse magjistrati në pozicionin e mëparshëm ishte caktuar përkohësisht, ka të drejtë të kthehet në atë pozicion deri në përfundimim të afatit të caktimit.

9. Këshillat miratojnë rregulla të detajuara për njoftimet dhe plotësimet e vëndeve të lira të përkohshme.

**Neni 60**
**E drejta e kthimit**

1. Magjistrati me një pozicion të përhershëm, kur përkohësisht nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin, sipas parashikimit të nenit 59 të këtij ligji, pas mbarimit të periudhës së përkohshme ka të drejtë që të kthehet në pozicionin e mëparshëm të përhershëm.
2. Kur magjistrati ka të drejtën e kthimit, ai kthehet në pozicionin e mëparshëm të tij, përveç rasteve kur është transferuar sipas lëvizjes paralele ose është ngritur në detyrë në një pozicion të përhershëm.
3. Nëse nuk është i mundur kthimi në pozicionin e mëparshëm për arsye të përfundimit para kohe të shkaqeve për të cilat magjistrati është caktuar në pozicionin e përkohshëm, atëherë ai~~/ajo~~ caktohet përkohësisht në pozicionin më të parë që i korrespondon nivelit të pozicionit të mëparshëm, nëse ka vende të lira dhe nëse magjistrati plotëson kërkesat përkatëse të këtij pozicioni. Në rastet kur magjistrati nuk është caktuar ende në një pozicion të përhershëm, magjistrati caktohet në një pozicion në shkallë të parë.
4. Nëse magjistrati nuk pranon të kthehet në pozicionin që i ofrohet, gëzon të drejtën për t’u caktuar në vendin tjetër të lirë, në të njëjtën shkallë me pozicionin e mëparshëm, nëse plotëson kërkesat përkatëse të këtij pozicioni.
5. Nëse magjistrati nuk pranon të kthehet për herë të dytë në pozicionin që i ofrohet, ai caktohet në një pozicion pa pëlqimin e tij.
6. Këshilli merr masat që kthimi i magjistratit sipas këtij neni të realizohet në kohë, menjëherë me mbarimin e afatit të periudhës së përkohshme.
7. Pavarësisht nga përcaktimet e bëra në pikat e të këtij neni, magjistrati që është anëtar i Këshillit, përjashtohet nga konkurrimi në procedurën e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit si anëtar i Këshillit si dhe tre vjet nga mbarimi i këtij mandati.

**Neni 61**
**Kufizimi i mandatit me ligj**

1. Mandati i gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë është nëntë vjet pa të drejtë rizgjedhjeje. Mandati i Prokurorit të Përgjithshëm është shtatë vjet pa të drejtë rizgjedhjeje. Mandati i prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme është nëntë vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje.
2. Mandati fillon ditën kur bëhet ceremonia e betimit, përpara Presidentit të Republikës. Data e betimit i njoftohet dhe Këshillit dhe përfshihet në dosjen personale.
3. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë, mandati të cili i ka mbaruar, vazhdon të mbajë funksionin deri në caktimin e gjyqtarit pasardhës, përveç rasteve të parashikuara në nenin 136 pika 5 të Kushtetutës.
4. Personat e listuar në pikën 1 të këtij neni, kanë të drejtë që pas mbarimit të mandatit të caktohen në një pozicion në nivel apeli.

5. Kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë të Posaçme, jo më vonë se tre muaj përpara mbarimit të mandatit respektiv sipas parashikimeve të pikës 1, të këtij neni dhe menjëherë në rastet e ndërprerjes së mandatit përpara afatit ligjor, njoftojnë Këshillin respektiv për pozicionin e lirë. Procedura që ndjek Këshilli për ngritjen në detyrë të pasardhësit përfundon jo më vonë se data e mbarimit të mandatit, dhe në rast të ndërprerjes përpara afatit ligjor jo më vonë se dy muaj nga marrja e njoftimit.

**Neni 62**
**E drejta për caktim në nivel apeli**

1. Në fund të mandatit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, si Prokuror i Përgjithshëm ose në raste të tjera ku ligji parashikon të drejtën për t'u caktuar në një pozicion në nivel apeli, magjistrati ka të drejtë për t'u caktuar në pozicionin e parë që publikohet i lirë, në nivel apeli, përkatësisht në gjykata ose prokurori, me kusht që të plotësojë kriteret për atë pozicion. Parashikimet e pikëve 3 deri në 7 të nenit 60 të këtij ligji, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.
2. Në rastin kur disa magjistratë kanë të drejtën e pozicionit në nivel apeli, sipas pikës 1 të këtij neni, magjistrati me rezultatet më të mira në vlerësimin etik dhe profesional gëzon i pari të drejtën për pozicionin, si dhe e ka këtë të drejtë deri në tre zgjedhje.
3. Me mbarimin e periudhës të ushtrimit të funksionit në pozicionin e mëparshëm, magjistrati ka të drejtën të marrë pagën e pozicionit ku është caktuar.

**Neni 63**
**Mbarimi i mandatit të Kryetarit**

1. Mandati i kryetarit është tre vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe.
2. Mandati i kryetarit mbaron menjëhere me mbarimin e periudhës për të cilën është caktuar.
3. Raste të tjera të mbarimit të mandatit të kryetarit janë:
a) kur mbaron statusi si magjistrat për arsyet e listuara në nenin 64 të këtij ligji;
b) kur kandidon për pozicionin e anëtarit të Këshillit.
4. Mbarimi i mandatit deklarohet me vendim të Këshillit përkatës.
5. Në fund të mandatit si kryetar, ai ka të drejtë të vazhdojë të ushtrojnë pozicionin si magjistrat në gjykatën ose prokurorinë përkatëse.

## KREU VIII
## MBARIMI I STATUSIT TE MAGJISTRATIT

**Neni 64**
**Kohëzgjatja në detyrë e magjistratit**

1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur:
a) jep dorëheqjen;
b) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;
c) mbush moshën e pensionit;
ç) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore sipas parashikimeve të këtij ligji;

d) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.
2. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë del në pension në moshën 70 vjeç. Gjyqtarit të Gjykatës së Lartë i mbaron mandati kur mbush moshën 70 vjeç, pavarësisht nga vitet e ushtrimit të funksionit në këtë pozicion.
3. Prokurori i Përgjithshëm del në pension në moshën 70 vjeç. Prokurorit të Përgjithshëm i mbaron mandati kur mbush 70 vjeç, pavarësisht nga vitet e ushtrimit të funksionit në këtë pozicion.
4. Prokurorit të Prokurorisë së Posaçme i mbaron mandati kur mbush moshën e pensionit, pavarësisht nga vitet e ushtrimit të funksionit në këtë pozicion.
5. Magjistrati i cili plotëson kushtet e parashikuara në ligj për të dalë në pension, i mbaron statusi i magjistratit në fund të muajit në të cilin ka mbushur moshën për pension. Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit jo më vonë se dy javë nga fundi i muajit përkatës.
6. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë deklarohet me vendim të Gjykatës së Lartë jo më vonë se dy javë nga fundi i muajit përkatës. Mbarimi i mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe prokurorit të Prokurorisë së Posacme deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë i Prokurorisë jo më vonë se dy javë nga fundi i muajit përkatës.

## Neni 65
## Dorëheqja

1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës.
2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.
3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të jap efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

## Neni 66
## Pazgjedhshmëria dhe Papajtueshmëria

1. Statusi i magjistratit mbaron në ditën kur autoriteti kompetent përcakton me vendim, shkaqet e pazgjedhshmërisë, si vijon:
a) kur magjistrati nuk plotëson kriteret e përcaktuara sipas nenit 28 të këtij ligji;
b) kur vendimi i emërimit është i pavlefshëm dhe nuk sjell asnjë pasoja juridike si dhe konsiderohet se nuk ekziston.
2. Statusi i magjistratit mbaron kur Këshilli vendos që ai nuk përmbush kushtet e papajtueshmërisë në përputhje me parashikimet e nenit 6 të këtij ligji.
3. Organi përgjegjës, kryetari dhe magjistrati njoftojnë menjëherë në mënyrë të pavarur Këshillin, për shkaqet e pazgjedhshmërisë ose papajtueshmërisë që sjellin mbarimin e statusit të magjistratit. Në këto raste, magjistrati ndalon së ushtruari funksionin si magjistrat.
4. Këshill deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se 2 javë nga marrja e njoftimit për shkakun e pazgjedhshmërisë ose papajtueshmërisë.
5. Vendimi përcakton datën e mbarimit të statusit të magjistratit sipas parashikimit të pikës1 ose 2 të këtij neni.

6. Çdo veprim i kryer nga magjistrati pas kësaj date është i pavlefshëm dhe konsiderohet që nuk sjell asnjë pasojë juridike si dhe konsiderohet se nuk ekziston.

**Neni 67**
**Pamundësia fizike dhe mendore e një magjistrati**

1. Me marrjen dijeni, Këshilli heton rastet për pamundësi fizike dhe mendore të magjistratit, të cilat çojnë në largimin nga funksioni ose pezullimin e përkohshëm të magjistratit.
2. Këshilli autorizon një komision me ekspertë për të dhënë mendim të specializuar rreth pamundësisë së magjistratit.
3. Magjistrati ka të drejtë të ketë akses në dosje, të përfaqësohet nga përfaqësuesi i tij dhe të dëgjohet.
4. Këshilli vendos pezullimin përkohësisht ose mbarimin e statusit të magjistratit nëse konkludon se kushtet fizike dhe mendore të magjistratit e bëjnë atë përkohësisht ose përgjithmonë të papërshtatshëm për funksionin.
5. Këshilli vendos kthimin e magjistratit të larguar nga funksioni, nëse provohet se pamundësia e tij nuk vazhdon më.
6. Magjistrati gëzon të drejtat e pensionit dhe përfitimet e tjera, për largimin nga funksioni sipas këtij neni.
7. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin e Këshillit të dhënë sipas parashikimeve të këtij neni.

## PJESA IV
## VLERËSIMI I MAGJISTRATIT

### KREU I
### Parimet e përgjithshme

**Neni 68**
**Qëllimi i vlerësimit të magjistratit**

Qëllimi i vlerësimit etik dhe profesional të magjistratit është:
a) të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme etikën dhe aftësitë profesionale të magjistratëve;
b) të vendosë standarde të qëndrueshme për cilësinë dhe sasinë e veprimtarisë së magjistratëve;
c) të informojë vendimet e Këshillave në lidhje me vendimet e statusit të magjistratit, në funksion të zhvillimit të karrierës bazuar mbi meritë;
ç) të informojë Këshillat dhe Shkollën e Magjistraturës në lidhje me nevojat për trajnim të magjistratëve dhe për të lehtësuar planifikimin e trajnimit të tyre;
d) të identifikojë magjistratët që mund të kenë aftësi të veçanta profesionale për sistemin e drejtësisë;
dh) të kontribuojë në përmirësimin e strukturës organizative të gjykatave dhe prokurorive, si dhe të kushteve të punës të magjistratëve.

**Neni 69**

**Parimet e vlerësimit**

Sistemi i vlerësimit bazohet dhe zbatohet nëpërmjet këtyre parimeve:
a) parimi i pavarësisë, sipas të cilit procesi i vlerësimit nuk duhet të ndërhyjë në pavarësinë e magjistratit;
b) parimi i meritokracisë dhe i zhvillimit të karrierës, sipas të cilit vlerësimi i veprimtarisë së magjistratit kryhet duke i dhënë rëndësinë më të madhe vlerave profesionale dhe cilësisë në punë, në funksion të zhvillimit të karrierës profesionale;
c) parimi i efikasitetit, sipas të cilit vlerësimi i veprimtarisë kryhet nëpërmjet një procesi të shpejtë, me anë të procedurave të thjeshta dhe në afate kohore të arsyeshme për të siguruar të dhëna në kohën e duhur për karrierën e magjistratit;
ç) parimi i procesit të rregullt ligjor, sipas të cilit në procedurën e vlerësimit respektohen standardet e procesit të rregullt ligjor për magjistratin, duke përfshirë të drejtën për t'u njohur me aktet, të drejtën e aksesit në dosjen e vlerësimit, të drejtën për të marrë pjesë në proces, të drejtën e kontradiktoritetit, të drejtën për t'u dëgjuar, të drejtën për t'u mbrojtur, të drejtën për të pasur një akt vlerësimi të arsyetuar dhe të drejtën për t'u ankuar mbi aktin e vlerësimit;
d) parimi i konfidencialitetit, sipas të cilit subjektet e ngarkuara me detyrën e vlerësimit janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave të magjistratit që vlerësohet, si dhe të dhënat e tij personale sipas legjislacionit në fuqi. Këto subjekte përjashtohen nga ky detyrim vetëm në rastet kur informacioni i jepet magjistratit që vlerësohet ose organeve që me ligj kanë të drejtë ta kërkojnë këtë informacion për shkak të detyrës zyrtare.

**Neni 70**
**Subjektet e vlerësimit**

1. Të gjithë magjistratët, përfshirë kryetarët e gjykatave dhe prokurorive, janë subjekt i vlerësimit të tyre etik dhe profesional në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë ligj.
2. Kryetarët vlerësohen gjithashtu edhe për veprimtarinë e tyre si kryetar gjykate apo prokurorie.
3. Magjistratët, të cilët janë në skemën e delegimit, ose janë komanduar në Këshilla, Gjykatën e Lartë ose Prokurorinë e Përgjithshme vlerësohen sipas parashikimeve të këtij ligji. Këshillat miratojnë parashikimet e nevojshme ligjore për detajimet për pozicionet e komanduara.
4. Magjistratët, të cilët janë komanduar në struktura të tjera dhe ruajnë statusin e magjistratit, vlerësohen sipas sistemit të vlerësimit në strukturën ku janë komanduar.

**KREU II**
**KRITERET, BURIMET DHE NIVELET E VLERËSIMIT**

**SEKSIONI I**
**VLERËSIMI I MAGJISTRATIT**

**Neni 71**
**Kriteret e vlerësimit**

Vlerësimi kryhet sipas kritereve të mëposhtme:
a) aftësive profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit;
b) aftësive organizative;

c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit;
ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

### Neni 72
### Aftësitë profesionale të gjyqtarit

1. Me anë të kriterit të aftësisë profesionale të gjyqtarit vlerësohet aftësia profesionale e gjyqtarit në drejtim të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor.
2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e gjyqtarit për të marrë vendime gjyqësore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë të së drejtës dhe aftësinë për të analizuar jurisprudencën.
3. Aspekti i arsyetimit ligjor të gjyqtarëve në marrjen e vendimeve vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si, qartësia dhe kuptueshmëria e vendimit, struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit, si dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik.
4. Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.

### Neni 73
### Aftësitë profesionale të prokurorit

1. Vlerësimi i aftësive profesionale të prokurorit përfshin njohuritë ligjore dhe të arsyetimit ligjor.
2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si, aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën.
3. Aspekti i arsyetimit ligjor të prokurorëve në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si, qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar akteve të prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit.
4. Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet.

### Neni 74
### Aftësitë organizative

1. Me anë të kriterit të aftësisë organizative vlerësohet aftësia e magjistratit për të përballuar ngarkesën e punës dhe për të kryer procedurat hetimore ose gjyqësore, si dhe aftësia për të administruar dosjet gjyqësore, duke shmangur rrethanat, të cilat nuk varen nga magjistrati dhe që kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit.
2. Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës matet duke u bazuar në treguesit për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje, në rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore dhe kohën mesatare për marrjen e vendimit përfundimtar gjyqësor ose të prokurorisë për një çështje.

3. Në rastin e gjyqtarit, aftësia e gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore matet duke u bazuar në treguesit për numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje, kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit.
4. Në rastin e prokurorit, aftësia e prokurorit për të kryer në mënyrë të efektshme procedura hetimore dhe procedura të tjera të sistemit prokurorial matet duke u bazuar në treguesit e kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale brenda afatit kohor të përcaktuar, të mbledhjes së provave të nevojshme, duke përfshirë mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit.
5. Aftësia për të administruar dosjet gjyqësore ose të prokurorisë matet duke u bazuar në treguesit e rregullshmërisë, plotësisë dhe saktësisë së dokumentacionit të dosjes.

**Neni 75**
**Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

1. Me anë të kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale vlerësohet aftësia e magjistratit për etikën në punë, integritetin dhe paanësinë.
2. Etika në punë e magjistratit në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion matet duke u bazuar në treguesit e dalë nga burimet e vlerësimit, të tilla si rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, mendimi i kryetarëve dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës përkatëse të vlerësimit.
3. Integriteti i magjistratit në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm matet duke u bazuar në tregues të tillë si rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, mendimi i kryetarëve dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës përkatëse të vlerësimit dhe/ose raportet e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit.
4. Paanësia e magjistratit në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit dhe respektimin e çështjeve të grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe çështjet e barazisë gjinore dhe të pakicave matet duke u bazuar në tregues të tillë si përdorimi i gjuhës diskriminuese, numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e magjistratit, si dhe tregues të tjerë që dalin nga burime të tjera vlerësimi.

**Neni 76**
**Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

1. Me anë të kriterit të aftësisë personale dhe angazhimit profesional vlerësohen aftësitë e komunikimit, aftësia për të bashkëpunuar me kolegët dhe gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.
2. Aftësia e komunikimit të magjistratit matet duke u bazuar në treguesit e komunikimit të qartë dhe transparent me palët gjyqësore, publikun, subjeketet e tjera, të tretët, në respektim të konfidencialitetit dhe parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale. Vlerësimi i aftësive drejtuese si kryetar me të paktën “shumë mirë”, ka përparësi në vlerësimin si magjistrat i cili kryhet pas vlerësimit si kryetar.

3. Aftësia për të bashkëpunuar me kolegët matet duke u bazuar në treguesit e komunikimit dhe bashkëveprimit me kolegët apo administratën gjyqësore, si dhe shkëmbimit të njohurive apo të përvojës profesionale me ta.
4. Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera matet duke u bazuar në tregues të tillë si, pjesëmarrja e magjistratit në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në trajnime të tjera profesionale, disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr magjistratët e ardhshëm gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e magjistratëve të rinj, pjesëmarrja e magjistratit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun të gjykatave dhe publikimet ligjore akademike.
5. Pjesëmarrja e magjistratit në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës matet duke u bazuar në informacionin e dërguar nga Shkolla e Magjistraturës, në vlerësimin "shumë mirë" në rastet e përmbushjes së detyrimit ligjor për të marrë pjesë në formim vazhdues jo më shumë se 40 ditë në vit dhe jo më shumë se 200 ditë gjatë pesë vjetëve. Shkallët e tjera të vlerësimit përcaktohen me rend zbritës nga ky standard.

**Neni 77**
**Burimet e vlerësimit**

Vlerësimi i magjistratëve bazohet në këto burime:
a) dosja personale e magjistratit;
b) të dhënat statistikore, sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 90 të këtij ligji;
c) dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim, sipas nenit 91 të këtij ligji, duke përfshirë edhe regjistrimet e seancave me mjete audio ose video në lidhje me dosjet gjyqësore, të cilat duhet të mbulojnë plotësisht të gjitha llojet e çështjeve të gjykuara dhe të hetuara;
ç) vlerësimi i kryer nga magjistrati dhe vendimet gjyqësore ose aktet të hartuara prej prokurorit dhe të përzgjedhura prej tij. Në çdo rast, numri i vendimeve/ akteve të hartuara dhe të përzgjedhura prej prokurorit nuk duhet të jetë më shumë se 2 në vit.
d) mendimi i kryetarit;
dh) të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj magjistratit gjatë periudhës së vlerësimit;
e) infomacioni me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në veprimtaritë trajnuese;
ë) vendimet përfundimtare për masat disiplinore ndaj magjistratit që janë dhënë gjatë periudhës së vlerësimit, në mënyrë të pavarur nëse masa disiplinore është shuar ose jo;
f) raportet e kërkuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit ose institucione të tjera ose audituese ose kontrolluese;
g) kundërshtimet e magjistratit dhe çdo procesverbal ose dokument i seancës dëgjimore gjatë procesit të vlerësimit;
gj) çdo e dhënë tjetër, që tregon ngritjen profesionale të magjistratit.

**Neni 78**
**Nivelet e vlerësimit**

1. Vlerësimi i magjistratit kryhet sipas këtyre niveleve:
a) "Shkëlqyeshëm": në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi shumë të larta;
b) "Shumë mirë": në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mbi mesataren;

c) “Mirë”: në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mesatare;
ç) “Mjaftueshëm”: në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi nën mesataren.
d) “I pamjaftueshëm”: në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi të dobët.

2**.** Vlerësimi i përgjithshëm “Shkëlqyeshëm” jepet në ato raste kur magjistrati është vlerësuar “shkëlqyeshëm” për të katërta kriteret.

3**.** Vlerësimi i përgjithshëm “Shumë mirë” jepet vetëm në ato raste kur magjistrati vlerësohet “Shumë mirë” për tri kritere dhe “Mirë” për njërin prej tyre dhe, në çdo rast, nëse kryetari i gjykatës nuk ka dhënë për gjyqtarin vlerësimin përfundimtar “I pamjaftueshëm”. Në çdo rast, kriteret “aftësitë profesionale të gyqtarit dhe prokurorit” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit dhe prokuroriale” duhet të jenë vlerësuar “Shumë mirë”.

4. Vlerësimi i përgjithshëm “Mirë” jepet në rastin kur aftësitë e magjistratit vlerësohen “Mirë” për dy kritere dhe “Mjaftueshëm” për dy kriteret e tjera. I njëjti rregull zbatohet edhe në rastin kur ka barazi në vlerësimin e kritereve në nivelet “Mjaftueshëm” dhe “I pamjaftueshëm”, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në pikën 3, të këtij neni. Në çdo rast, kriteret “aftësitë gjyqësore ose prokuroriale” dhe “etika dhe përkushtimi ndaj vlerave të gjyqësorit ose të prokurorisë” duhet të vlerësohen të paktën “Shumë mirë”.

5.Vlerësimi i përgjithshëm “I pamjaftueshëm” jepet në këto raste:
a) kur magjistrati vlerësohet “I pamjaftueshëm” për të paktën në 3 kritere;
b) kur magjistrati vlerësohet “I pamjaftueshëm” për kriteret “aftësitë profesionale të gyqtarit dhe prokurorit” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit ose të prokurorisë” dhe jo më shumë se “Mirë” për dy kriteret e tjera.

Në çdo rast, vlerësimi “I pamjaftueshëm” nuk i jepet magjistratit nëse kryetari i gjykatës e ka vlerësuar magjistratin “Shumë mirë”.

## SEKSIONI II
## VLERËSIMI I VEPRIMTARISË SË KRYETARIT

### Neni 79
### Kriteret për vlerësimin e veprimtarisë së Kryetarit

Vlerësimi i veprimtarisë së kryetarit të një gjykate ose prokurorie kryhet bazuar në këto kritere:
a) aftësitë drejtuese dhe organizative;
b) aftësitë e komunikimit.

### Neni 80
### Aftësitë drejtuese dhe organizative

1. Me anë të kriterit të aftësive drejtuese dhe organizative vlerësohen aftësitë e kryetarit për organizimin e qartë të veprimtarive administrative, si gjyqtar dhe prokuror nëpërmjet dhënies së vendimeve dhe urdhrave për të siguruar respektimin e afateve dhe përdorimin sa më të mirë të burimeve të disponueshme, si dhe aksesin dhe transparencën në gjykatë.

2. Në rastin e Kryetarit të Gjykatës, kriteri i aftësive drejtuese dhe organizative, matet duke u bazuar në treguesit që kanë lidhje me :
a) mirëorganizimin e gjykatës në dhoma ose seksione;
b) ndarjen e trupave gjykues;

c) planifikimin e gjyqtarëve për çështje të natyrës urgjente;
ç) ndarjen e çështjeve me short;
d) zëvendësimin në kohë të gjyqtarëve që kanë pengesa në gjykim;
dh) zhvillimin e mbledhjeve tematike;
e) planifikimin dhe përdorimin efikas të fondeve publike sipas nevojave të gjykatës;
ë) mbikëqyrjen me qëllim përmirësimin e informacionit në faqen zyrtare të gjykatës;
f) mbikëqyrjen për krijimin e ambienteve të përshtatshme në gjykatë, në përputhje me nevojat e palëve e të publikut, përfshirë edhe shenjat orientuese në gjykatë;
g) organizimin e trajnimeve për gjyqtarët ose punonjësit e gjykatës.
3. Në rastin e Kryetarit të Prokurorisë, kriteri i aftësive drejtuese dhe organizative matet duke u bazuar në treguesit që kanë lidhje me:
a) mirëorganizimin e prokurorisë në seksione;
b) planifikimin e prokurorëve për çështje të natyrës urgjente;
c) zëvendësimin në kohë të prokurorëve që kanë pengesa në proces;
ç) zhvillimin e mbledhjeve tematike për prokurorët;
d) planifikimin dhe përdorimin efikas të fondeve publike sipas nevojave të prokurorisë;
dh) mbikëqyrjen për efekt të përmirësimit të informacionit në faqen zyrtare të prokurorisë;
e) mbikëqyrjen për krijimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori, në përputhje me nevojat e palëve e të publikut;
ë) organizimin e trajnimeve për prokurorët dhe punonjësit e prokurorisë.
4. Përfshirja e kryetarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë ose në trajnime profesionale për drejtimin dhe organizimin e gjykatës ose të prokurorisë vlerësohet me përparësi në matjen e këtij kriteri.

**Neni 81**
**Aftësitë komunikuese**

1. Me anë të kriterit të aftësisë komunikuese vlerësohet aftësia e kryetarit për komunikim të qartë, në kohë dhe transparent. Ky kriter matet duke u bazuar në treguesit që kanë lidhje me:
a) bashkëpunimin efektiv dhe në kohë me Këshillin, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Ministrinë e Drejtësisë, Kontrollin e Lartë të Shtetit ose me çdo institucion tjetër mbikëqyrje ose auditi;
b) komunikimin me publikun dhe të tretët, duke caktuar saktësisht oraret për pritjen e publikut, dokumentacionin e takimeve ose të shkresave për t’iu përgjigjur institucioneve të ndryshme.

**Neni 82**
**Burimet e vlerësimit për veprimtarinë e kryetarëve**

Vlerësimi i veprimtarisë së kryetarit bazohet në këto burime:
a) dosja personale e kryetarit;
b) vlerësimi i kryer nga kryetari, i cili përmbush, në mënyrë të njëjtë kriteret e vlerësimit të kryer nga magjistrati;
c) raportet vjetore të kryetarit, ku pasqyrohen të dhënat e veprimtarisë financiare dhe procesverbalet e mbledhjeve vjetore të analizës së gjykatës ose prokurorisë, si dhe raporti përkatës i përfaqësuesit të Këshillit në këto mbledhje, duke përfshirë edhe regjistrimin audio;
ç) çdo urdhër ose vendim i kryetarit i nxjerrë në ushtrim të kompetencave për organizimin e gjyqtarëve ose prokurorëve ose të administratës gjyqësore ose të prokurorisë;

d) të dhëna statistikore për funksionimin e gjykatës ose prokurorisë në pesë vitet e fundit;
dh) raportet e inspektimit të gjykatës ose prokurorisë nga institucionet shtetërore;
e) çdo dokument i cili tregon aftësitë e komunikimit të kryetarit me publikun dhe të tretët ;
ë) mendimi i dhomës vendore të avokatisë dhe të Kryetarit të prokurorisë ku ushtron funksionin kryetari i gjykatës ose mendimi i dhomës vendore së avokatisë dhe të Kryetarit të gjykatës ku ushtron funksionin kryetari i prokurorisë;
f) informacioni me shkrim nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera që vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e kryetarit në veprimtari trajnuese për drejtimin dhe organizimin e gjykatës apo prokurorisë;
g) të dhëna për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj kryetarit në këtë cilësi, gjatë periudhës së vlerësimit;
gj) vendime përfundimtare për masa disiplinore për shkak të pozicionit të kryetarit të dhëna gjatë periudhës së vlerësimit, pavarësisht nëse masa disiplinore është shuar ose jo;
h) kundërshtimet e kryetarit dhe çdo procesverbal ose dokument i seancës dëgjimore gjatë procesit të vlerësimit;
i) çdo burim tjetër që evidenton veprimtarinë profesionale të kryetarit.

**Neni 83**
**Nivelet e vlerësimit**

1. Vlerësimi i veprimtarisë të kryetarit kryhet sipas këtyre niveleve:
a) “Shumë mirë”, në rastin e veprimtarisë drejtuese me cilësi mbi mesataren;
b) “Mirë”, në rastin e veprimtarisë drejtuese me cilësi mesatare;
c) “Mjaftueshëm”, në rastin e veprimtarisë drejtuese nën mesatare.
2. Vlerësimi i përgjithshëm “Shumë mirë” jepet nëse veprimtaria drejtuese e kryetarit vlerësohet “Shumë mirë” në të dyja kriteret. Vlerësimi i përgjithshëm “mjaftueshëm” jepet nëse veprimtaria drejtuese e kryetarit vlerësohet “mjaftueshëm”, të paktën në një prej kritereve. Në rastet e tjera, veprimtaria drejtuese e kryetarit vlerësohet “Mirë”.

## KREU III
## PROCEDURA E VLERËSIMIT

### SEKSIONI I
### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

**Neni 84**
**Periudha e vlerësimit**

1. Magjistrati vlerësohet një herë në tre vjet, gjatë pesëmbëdhjetë viteve të para të përvojës profesionale, përfshirë edhe përvojën profesionale si ndihmës magjistrat ose magjistrat i komanduar.
2. Magjistrati vlerësohet një herë në pesë vjet, pas 15 viteve të para të përvojës profesionale si magjistrat.
3. Kryetari vlerësohet të paktën një herë gjatë kohëzgjatjes së mandatit si kryetar. Në çdo rast, veprimtaria e kryetarit vlerësohet nga Këshilli të paktën gjashtë muaj para përfundimit të këtij mandati.

4. Magjistrati i cili ushtron funksionin si anëtar i një Këshilli, nuk vlerësohet sipas parashikimeve të këtij ligji. Këshilli miraton rregulla të detajuara për vlerësimin e veprimtarisë gjatë funksionit në Këshill. Në rast të paraqitjes së kërkesës për transferim dhe ngritje në detyrë tre vjet pas këtij funksioni, Këshilli merr në konsideratë veprimtarinë e magjistratit gjatë funksionit si anëtar i Këshillit.

## SEKSIONI II
## FILLIMI I PROCEDURËS SË VLERËSIMIT

### Neni 85
### Programi dhe njoftimi i vlerësimit

1. Këshilli, jo më vonë se muaji nëntor i çdo viti, miraton programin që përcakton listën e magjistratëve dhe kryetarëve për të cilët do të kryhet vlerësimi përgjatë vitit pasardhës dhe periudhën e vlerësimit. Në program përfshihen të paktën ata magjistratë, për të cilët përfundon ose ka përfunduar periudha e vlerësimit në vitin pasardhës me qëllim që të sigurohet në kohë vlerësimi etik dhe profesional i magjistratit. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
2. Kryetarët dhe magjistratët të cilët do të vlerësohen sipas programit të miratuar sipas pikës 1 të këtij neni, njoftohen në kohën e duhur nga Këshilli.
3. Magjistrati kryen vlerësim etik dhe profesional të punës së tij në kuptim të nenit 77 gërma ç) të këtij ligji, brenda tre javëve nga data e marrjes së njoftimit sipas pikës 2 të këtij neni.
4. Magjistrati duhet të dorëzojë vlerësimin etik dhe profesional të kryer prej tij sipas pikës 3 të këtij neni, pranë Kryetarit të gjykatës ose prokurorisë ku ushtron funksionin, brenda tre javëve nga data e marrjes së njoftimit sipas këtij neni.

### Neni 86
### Vlerësimi i kryer nga magjistrati

1. Magjistrati, kryen vlerësimin etik dhe profesional të punës së tij, sipas nenit 85 të këtij ligji, sipas formularit standard të vendosur nga Këshilli, nëpërmjet të cilit magjistrati:
a) vlerëson aktivitetin përkundrejt kritereve vlerësuese;
b) paraqet një analizë të të dhënave statistikore që lidhen me veprimtarinë e tij si magjistrat;
c) përshkruan masat që ka ndërmarrë për përmbushjen e objektivave të përcaktuara në vlerësimin e mëparshëm;
c) përshkruan shkallën në të cilën janë përmbushur këto objektiva duke dhënë edhe shpjegimin përkatës;
d) përshkruan objektivat për zhvillimin e tij profesional për vlerësimin e ardhshëm të tij;
dh) përshkruan nevojat për trajnim dhe rrethanat të cilat përbëjnë pengesë për zhvillimin e tij profesional dhe propozon zgjidhje konkrete për periudhën e ardhshme të vlerësimit.
2. Në çdo rast, vlerësimi i kryer nga magjistrati duhet të shoqërohet me dy vendime gjyqësore ose dy akte të hartuara prej prokurorit, të përzgjedhura prej tij, dokumentat që tregojnë angazhimin në veprimtaritë profesionale ndërinstitucionale gjatë periudhës së vlerësimit, trajnimet jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës dhe çdo dokument tjetër që evidenton veprimtarinë profesionale. Dokumentat për trajnimet jashtë Shkollës së Magjistraturës duhet të

evidentojnë përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e trajnimit, si dhe të dhëna për institucionin që ka organizuar aktivitetin.

**Neni 87**
**Mendimi i Kryetarit**

1. Kryetari i gjykatës ose i prokurorisë ku ushtron funksionin magjistrati që vlerësohet, paraqet mendim për veprimtarinë e magjistratit në përputhje me standardet e vendosura nga Këshilli.
2. Në mendimin e kryetarit përshkruhet veprimtaria e magjistratit dhe vlerësimi i tij për këtë veprimtari sipas kritereve të vlerësimit, duke u bazuar në nivelet e vlerësimit të parashikuara në këtë ligj, duke u ndalur veçanërisht në ato kritere për të cilat mendimi i kryetarit ndryshon nga vlerësimi i kryer nga magjistrati. Gjithashtu, në mendimin e kryetarit pasqyrohet një analizë e të dhënave statistikore të veprimtarisë së magjistratit.
3. Mendimi i Kryetarit i njoftohet magjistratit brenda katër javëve nga data e marrjes së njoftimit sipas nenit 85, të këtij ligji.
4. Brenda tre ditëve nga njoftimi i mendimit, magjistrati gëzon të drejtën për t'u dëgjuar dhe paraqet kërkesë për zhvillimin e një takimi me Kryetarin.
5. Kryetari zhvillon takimin me magjistratin brenda dy javëve nga data e depozitimit të kërkesës, Kryetari merr masat për pasqyrimin e takimit në procesverbal, i cili i bashkëlidhet mendimit të kryetarit.
6. Jo më vonë se dy muaj nga data e njoftimit sipas nenit 85, të këtij ligji, Kryetari paraqet mendimin përfundimtar për veprimtarinë e magjistratit, i cili pasqyron edhe kundërshtimet e mundshme të magjistratit.

**Neni 88**
**Dërgimi i akteve të vlerësimit nga Kryetari**

1. Kryetari i dërgon Këshillit, aktet e vlerësimit të magjistratit, brenda dy muajve nga data e njoftimit sipas nenit 85, të këtij ligji.
2. Aktet e vlerësimit përfshijnë:
a) vlerësimin e kryer nga magjistrati, dy vendime gjyqësore ose dy akte të hartuara prej prokurorit, të përzgjedhura prej tij~~/saj~~ për çdo vit, si dhe çdo e dhënë tjetër e paraqitur nga magjistrati;
b) mendimin e Kryetarit;
c) kundërshtimet e mundshme të magjistratit ndaj mendimit të Kryetarit dhe procesverbalin e dëgjesës.

## SEKSIONI III
## ECURIA E PROCESIT TË VLERËSIMIT

**Neni 89**
**Përgatitja e dokumentacionit**

1. Këshilli miraton kriteret për caktimin e relatorit për çdo vlerësim, të zgjedhur në radhët e anëtarëve të Këshillit.
2. Këshilli mbështetet nga administrata e tij në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm lidhur me periudhën e vlerësimit. Administrata e Këshillit përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve tek relatori dhe kryen vetëm ato detyra që kërkohen për vlerësimin që kryhet nën drejtimin relatorit.
3. Magjistrati njoftohet me shkrim për relatorin dhe nëpunësin përgjegjës, të caktuar për vlerësimin e tij.

## Neni 90
## Krijimi i dosjes së vlerësimit

1. Brenda dy javëve nga marrja e akteve të vlerësimit, hapet dosja e vlerësimit, e cila përmban:
a) aktet e vlerësimit të dërguara nga Kryetari;
b) përmbledhje të të dhënave statistikore, në rastin e vlerësimit të gjyqtarëve, lidhur me:
i) numrin e çështjeve të gjykuara nga gjyqtari në cilësinë e relatorit, numrin e çështjeve të gjykuara në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, numrin e çështjeve për të cilat gjyqtari ka qënë përkohësisht i transferuar ose që është ka ushtruar pozicionin në një gjykatë tjetër. Këto të dhëna kategorizohen sipas natyrës së çështjeve;
ii) kohën e gjykimit të çështjeve duke e krahasuar me standardet minimale kohore dhe numrin e çështjeve të gjykuara përtej afatit standart minimale, numrin e seancave gjyqësore për çdo çështje, rendimentin e gjyqtarit në përfundimin e çështjeve të gjyqtarit si dhe kohën e arsyetimit të çdo vendimi;
iii) të dhënat e tjera statistikore të caktuara nga Këshilli.
c) përmbledhje të të dhënave statistikore në rastin e vlerësimit të prokurorëve, lidhur me:
i) numrin e çështjeve të mbyllura, të pezulluara ose të dërguara për gjykim, numrin e masave të sigurisë dhe urdhërat e ekzekutimit. Të dhëna të tilla duhet të kategorizohen sipas natyrës së çështjes;
ii) të dhëna lidhur me kohën për kryerjen e hetimeve paraprake dhe hetimin përfundimtar duke e krahasuar me standardet minimale kohore dhe numrin e çështjeve të përfunduara përtej afatit standard minimal, numrin e rasteve të zgjatjes së afateve të hetimit, periudha e zbatimit të vendimeve gjyqësore dhe respektimi i afateve të vendosura në vendimet gjyqësore;
iii) të dhëna të tjera statistikore të caktuara nga Këshilli.
ç) të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj magjistratit gjatë periudhës së vlerësimit, për inspektimin e veprimtarisë së magjistratit ose të gjykatës apo të prokurorisë, si dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore të dhëna ndaj magjistratit, të cilat zbatohen periudhës së vlerësimit ose raporte të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive;
d) numrin e çështjeve, në të cilat magjistrati është përjashtuar për shkak të konfliktit të interesit, me kërkesë të palëve;
dh) çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim;
e) dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Shkolla e Magjistraturës.
2. Çdo akt i marrë gjatë procedurës së vlerësimit sipas këtij ligji, përfshihet në dosje dhe listohet në një raport, i cili analizon në mënyrë të detajuar dhe të strukturuar të dhënat.
3. Në çdo kohë, magjistrati ka të drejtën të ketë akses në dosjen e tij të vlerësimit dhe të marrë kopje të akteve apo ekstrakte të tyre.

**Neni 91**
**Përzgjedhja e çështjeve për vlerësim**

1. Për vlerësimin etik dhe profesional të veprimtarisë së magjistratit përzgjidhen me short jo më shumë se 21 çështje të përfunduara nga magjistrati në periudhën për të cilën bëhet vlerësimi. Për vlerësimin e përgjithshëm përzgjidhen 15 dosje, nga të cilat pesë dosje për çdo vit kalendarik të periudhës për të cilën bëhet vlerësimi në rast të vlerësimit për një periudhë tre vjeçare dhe tre dosje për çdo vit kalendarik në rast të vlerësimit për një periudhë pesë vjeçare. Pjesa tjetër e dosjeve përzgjidhet sipas kriterit të vonesës në afate, nga të cilat 5%, por jo më shumë se gjashtë çështje nga numri i përgjithshëm, është vendosur përtej afateve standarde. Në rast se magjistrati mungon në detyrë për një periudhë më shumë se gjashtë muaj, numri i dosjeve të përzgjedhura do të ulet në mënyrë proporcionale me kohën.
2. Relatori përcakton dhomën dhe seksionin ku magjistrati ka ushtruar funksionin në periudhën për të cilën bëhet vlerësimi dhe në varësi të numrit të çështjeve për çdo kategori, përcakton numrin e çështjeve që do të përzgjidhen në mënyrë të barabartë për secilën kategori.
3. Në short përfshihen të gjitha çështjet, për të cilat magjistrati ka qenë relator i trupit gjykues ose prokuror, duke përfshirë edhe çështjet për të cilat magjistrati është transferuar përkohësisht në një gjykatë ose prokurori tjetër ose ka ushtruar detyrën në një pozicion tjetër. Në rastin e një prokurori, të paktën gjysma e çështjeve t'i referohet çështjeve që përfshijnë paraburgimin dhe një apelim.
4. Numri i çështjeve të përzgjedhura me short, të cilat janë përfunduar nga magjistrati me vendim, nuk duhet të kalojë 10% të numrit të përgjithshëm të çështjeve të përzgjedhura. Në rastin e prokurorit, çështjet e selektuara duhet të përfaqësojnë në mënyrë të barabarta vendimet në pushimin e çështjes dhe vendimet e lirimit pas arrestit me burg. Çështjet e përzgjidhen përtej këtij kufiri nuk vlerësohen, ndërkohë që shorti vazhdon për përzgjedhjen e çështjeve të kategorive të tjera.
5. Numri i çështjeve gjyqësore pa palë kundërshtare të gjykuara nga gjyqtari, të përzgjedhura me short, nuk duhet të kalojë 20% të numrit të përgjithshëm të çështjeve të përzgjedhura. Çështjet që përzgjidhen përtej këtij kufiri nuk vlerësohen, ndërkohë që shorti vazhdon për përzgjedhjen e çështjeve të kategorive të tjera.
6. Përzgjedhja e çështjeve me short realizohet pas fillimit të procedurës së vlerësimit të magjistratit dhe konsiderohet pjesë e kësaj procedure, pavarësisht nga veprime të tjera.
7. Shorti zhvillohet me urdhër dhe nën mbikëqyrjen e një përfaqësuesi nga Këshilli, në përputhje me parashikimet e bëra në këtë nen. Shorti, i cili zhvillohet në gjykatën ose prokurorinë ku ushtron funksionet magjistrati duhet të realizohet në mënyrë elektronike nga administrata gjyqësore.
8. Kryetari dhe kancelari marrin masat për t'i krijuar nëpunësit përgjegjës të gjitha kushtet e nevojshme për ushtrimin e detyrave.

**Neni 92**
**Informacioni nga institucione të tjera**

1. Relatori mbledh dhe përfshin në dosjen e vlerësimit informacionin lidhur me:
a) pjesëmarrjen në formimin vazhdues të magjistratit të kërkuara Shkollës së Magjistraturës;
b) përfundimet e ankesave të kërkuara Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

c) saktësinë dhe korrektësinë e deklarimit të pasurisë të kërkuara Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit.
2. Shkolla e Magjistraturës, në cilësinë e institucionit përgjegjës për formimin vazhdues të magjistratit, dokumenton pjesëmarrjen e magjistratit në formimin vazhdues. Shkolla e Magjistraturës merr masat për të dërguar informacionin për pjesëmarrjen e magjistratit në formimin vazhdues, brenda dy javëve nga dita e depozitimit të kërkesës. Informacioni pasqyron numrin e trajnimeve në të cilat magjistrati është ftuar, temën dhe kohëzgjatjen e trajnimeve, nivelin e pjesëmarrjes së magjistratit dhe, nëse është e mundur, edhe nivelin e aktivizimit.
3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë përcjell dokumentacionin për ankesat që janë regjistruar pranë këtij institucioni kundër magjistratit, gjatë periudhës në të cilën bëhet vlerësimi, duke evidentuar minimalisht informacionin lidhur me ankuesin, datën e ankesës, përmbledhje të shkurtër të veprimeve hetimore të ndërmarra dhe mënyrën e përfundimit të ankesës.
4. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave përcjell një raport.

**Neni 93**
**Projekt raporti i vlerësimit**

1. Relatori harton projekt raportin e vlerësimit, brenda një muaji nga marrja e akteve të vlerësimit nga Kryetari.
2. Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësitë e magjistratit. Analiza e të dhënave statistikore për rendimentin e përfundimit të çështjeve, kohëzgjatjen e gjykimeve dhe kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve ose në përfundimin e një çështjeje bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës.
3. Vlerësimi i kryer nga magjistrati dhe mendimi i Kryetarit verifikohen në raport me informacionin e marrë nga burime të tjera të vlerësimit.
4. Në çdo rast dhe në mënyrë të veçantë për vlerësimin e aftësive profesionale të gyqtarit dhe prokurorit" sipas neneve 72 dhe 73, të këtij ligji, duhet të shmanget gjithmonë ndërhyrja në pavarësinë e magjistratit.
5. Projekt raporti i vlerësimit përmban:
a) të dhënat personale të magjistratit: arsimimi, vjetërsia, nivelet e mëparshme të vlerësimit si dhe informacion të përgjithshëm për periudhën në të cilën bëhet vlerësimi, dhomën ose seksionin pranë të cilës ka ushtruar funksionin dhe për masat disiplinore që janë dhënë ndaj magjistratit në periudhën në të cilën bëhet vlerësimi;
b) të dhënat e marra nga burimet e vlerësimit dhe analiza e tyre për vlerësimin e veprimtarisë së magjistratit sipas kritereve të vlerësimit;
c) propozimin për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi dhe nivelin e përgjithshëm të vlerësimit;
ç) propozimin për trajnime ose rekomandime për hapat që duhen ndërmarrë për të përmirësuar veprimtarinë e magjistratit.
6. Projekt raporti i vlerësimit shoqërohet me raportin që përshkruan dhe analizon në mënyrë të detajuar të dhënat e mbledhura.
7. Projekt raporti i vlerësimit është pjesë përbërëse e dosjes së vlerësimit.

## Neni 94
## E drejta e magjistratit për të kundërshtuar projektin e raportit të vlerësimit

1. Magjistrati njoftohet për projekt raportin e vlerësimit, si dhe informohet për të drejtën për të aksesuar dosjen e vlerësimit.
2. Magjistrati ka të drejtë të kundërshtojë me shkrim projekt raportin e vlerësimit brenda dy javëve nga data e marrjes së njoftimit. Magjistrati mund të paraqesë prova të reja, me përjashtim të vendimeve gjyqësore dhe akteve të hartuara prej prokurorit.
3. Magjistrati mund të kërkojë të dëgjohet gjatë seancës dëgjimore në Këshill. Përmbajtja e deklaratës me shkrim nuk përsëritet gjatë seancës dëgjimore.

## Neni 95
## Vendimi për vlerësimin

1. Këshilli fton magjistratin që vlerësohet, si dhe persona të tjerë në seancë dëgjimore, nëse kjo kërkohet nga magjistrati ose nëse kjo është e nevojshme për të sqaruar faktet.
2. Këshilli urdhëron shtyrjen e seancës për jo më shumë se 30 ditë, nëse gjatë shqyrtimit të vlerësimit konstatohen gabime procedurale ose materiale ose nëse nevojiten prova të tjera që mund të ndikojnë në nivelin e vlerësimit dhe korrigjimi i këtyre gabimeve nuk mund të bëhet menjëherë për shkak të nevojës për të marrë dokumente të tjera.
3. Këshilli, pasi shqyrton projekt raportin e vlerësimit dhe duke u bazuar në përfundimet e seancës dëgjimore, vendos të miratojë ose të miratojë me ndryshime ose të kërkojë hartimin e një projekti të ri të raportit të vlerësimit nga anëtari relator.
4. Në rastet kur Këshilli vlerëson magjistratin me një nivel të ndryshëm ose bën një arsyetim të ndryshëm nga ai i propozuar në projekt raportin e vlerësimit, atëherë pasqyron në vendim arsyet përkatëse. Raporti i vlerësimit që miratohet nga Këshilli është pjesë përbërëse e vendimit.
5. Në rast kur magjistrati vlerësohet “I pamjaftueshëm” ose me vlerësim në nivel më të ulët, magjistratit i ulet paga me dy përqind gjatë dy viteve kalendarike pas këtij vlerësimi.
6. Kur magjistrati ose kryetari vlerësohet “I pamjaftueshëm”, Këshilli dërgon raportin e vlerësimit Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
7. Në rastet kur Këshilli vlerëson magjistratin me një nivel më të ulët se sa “mirë”, magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin e vlerësimit të Këshillit në Gjykatën e Lartë, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, vetëm për shkaqe ligjore të lidhura me zbatimin jo të njëjtë të ligjit.
8. Projekt raporti i vlerësimit, çdo vendimi i Këshillit dhe sipas rastit vendimet e mundshme gjyqësore duhet të përfshihen si pjesë e dosjeve individuale të magjistratit.
9. Këshilli publikon ekstrakte të raportit të vlerësimit dhe vendimit, të cilat pasqyrojnë të dhënat statistikore, analizën e të dhënave, nivelin e vlerësimit dhe arsyetimin caktimin e këtij niveli. Ekstrakti publikohet duke respektuar të drejtën e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave. Në çdo rast, nga ekstrakti duhet të hiqet çdo informacion që mund të zbulojë identitetin e magjistratit.

## Neni 96
## Procedura e vlerësimit për Kryetarët

1. Vlerësimi i veprimtarisë së kryetarëve kryhet sipas procedurës së parashikuar në këtë ligj.
2. Kryetari i paraqet Këshillit vlerësimin e kryer prej tij dhe çdo burim të përshtatshëm të vlerësimit të tij në Këshill, brenda tre javëve nga data e marrjes së njoftimit, sipas nenit 85, të këtij ligji.
3. Në procedurën e vlerësimit të veprimtarisë së Kryetarit nuk zbatohen nenet 86 pikat 2 dhe 3, 87, 88 pika 2, 90 pika 1, dhe 91 të këtij ligji.

**Neni 97**
**Vlerësimi me kërkesë**

1. Magjistrati vlerësohet me procedurë të përshpejtuar sipas kërkesës së tij, në rastet kur kërkohet të transferohet ose ngrihet në detyrë dhe kur vlerësimi i fundit është realizuar para më shumë se dy viteve. Vlerësimi me procedurë të përshpejtuar kryhet sipas parashikimeve të këtij ligji për aq sa është e mundur.
2. Vlerësimi me procedurë të përshpejtuar kryhet për periudhën që përfshin vitin e fundit kalendarik. Këshilli miraton programin që përcakton magjistratët që vlerësohen sipas kësaj procedure para se të marrë vendimin për ngritjen në detyrë ose transferimin e magjistratit.
3. Në vlerësimin sipas kësaj procedure, përzgjidhen me short gjashtë çështje të magjistratit për vlerësim të përgjithshëm, paraqiten dy vendime gjyqësore ose akte të hartuara nga prokurori , si dhe vlerësohen jo më shumë se tre çështje për të cilat magjistrati ka vendosur përtej afateve standarde.
4. Afati i përgatitjes së projekt raportit të vlerësimit është dy muaj nga dita e dorëzimit të akteve të vlerësimit nga Kryetari.
5. Këshilli vendos për vlerësimin e magjistratit në mbledhjen e radhës, pas njoftimit të magjistratit për projekt raportin e vlerësimit.
6. Në rastet kur një vendim i Këshillit për vlerësim rezulton me rezultatet me pak se "mirë", magjistrati ka të drejtën e ankimimit kundër vendimit të Këshillit brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit të vendimit në Gjykatën kompetente vetëm për arsye që lidhen me ligjin ose argumenta për moszbatim në mënyrë të unifikuar të ligjit.

**SEKSIONI IV**
**RAPORTIMI DHE TRANSPARENCA**

**Neni 98**
**Raporti Vlerësimit**

1. Çdo vit kalendarik, Këshillat hartojnë raportin e vlerësimit për veprimtarinë e vlerësimit të magjistratëve që kanë kryer në vitin paraardhës.
2. Raporti i vlerësimit publikohet në fund të muajit mars të vitit pasardhës.

**Neni 99**
**Raporti Periodik për Sistemin e Vlerësimit**

1. Çdo 3 vjet, Këshillat publikojnë një raport periodik për sistemin e vlerësimit, në të cilin pasqyrohet të paktën ky informacion:
a) përshkrim i përgjithshëm i vlerësimeve të kryera gjatë periudhës që mbulon ky raport;
b) analiza e përfundimeve të vlerësimit duke identifikuar dobësitë dhe përparësitë e trupës së magjistratëve dhe të sistemit gjyqësor ose prokurorisë;
c) analiza e efikasitetit të rekomandimeve të miratuara në periudhën raportuese pararendëse;
ç) rekomandimet për masat që duhen marrë për të kapërcyer dobësitë e identifikuara.
3. Raporti periodik publikohet deri në fund të muajit Mars të vitit që vjen pas periudhës që mbulohet nga ky raport.

## PJESA V
## PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE, CIVILE DHE PENALE

## KREU I
## DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 100
### Parimet e Procedimit Disiplinor

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshillat, për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në këtë Pjesë, udhëhiqen dhe synojnë zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimeve të mëposhtme:
a) e drejta për një proces të rregullt, duke përfshirë dhe marrjen e një vendimi brenda një afati të arsyeshëm;
b) parimin e ligjshmërisë, në kuptim që organi kompetent ka detyrimin të hetojë nëse ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur një shkelje disiplinore, si dhe parimin e "mos dënimit pa ligj";
c) parimin e akuzës, në kuptimin që çdo institucion shtetëror ose zyrtar duhet të veprojë kryesisht dhe të paraqesë një ankesë nëse ka prova të mjaftueshme për të besuar që ka ndodhur një shkelje disiplinore;
ç ) parimin e barazisë para ligjit;
d) prezumimin e pafajësisë;
dh) parimin e dyshimit në favor të magjistratit subjekt i procedimit disiplinor;
e) parimin e proporcionalitetit;
ë) parimin e pavarësisë dhe paanësisë së institucioneve disiplinore dhe respektimi për pavarësinë e magjistratit;
f) parimin e drejtësisë së hapur;
g) parimin e konfidencialitetit dhe të drejtën e jetës private dhe mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Në balancimin e parimit të drejtësisë së hapur, parimit të konfidencialitetit, të drejtës për jetë private dhe mbrojtjen e të dhënave personale, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshillat duhet të marrin parasysh veçanërisht:
a) faktin që të garantohet mbrojtja e integriteti dhe figura e magjistratit nga akuzat e pabaza;
b) rëndësinë që ka informimi i publikut në lidhje me akuzat e provuara në funksion të administrimit të drejtësisë.

### Neni 101

**Shkeljet disiplinore dhe çështje të veprimtarisë**

1.Magjistrati kryen shkelje disiplinore në këto raste:
a) kur vepron me pakujdesi në ushtrimin e detyrave që rrjedhin nga funksioni, sipas parashikimeve të bëra në pikën 2 të këtij neni;
b) kur haptazi nuk i referohet ligjit ose fakteve për shkak të pakujdesisë së rëndë siç përcaktohet në treguesit e pikës 2 të këtij neni ose dashjes, ose kur ka paaftësi të dukshme profesionale;
c) në çdo rast tjetër që në mënyrë të pajustifikuar, kryen akte dhe sjellje të papërshtatshme gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit ose që dëmtojnë rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë.
2. Pakujdesia në ushtrimin e detyrës nga magjistrati, konsiderohet shkelje disiplinore vetëm në rastet kur vërehen gabime, të cilat tejkalojnë ato që mund të ndodhin në rrethana normale nga një magjistrat mesatar. Kufijtë midis çështjeve që kanë lidhje me ushtrimin e funksionit dhe shkeljeve të disiplinës nga magjistrati, caktohen duke marrë në konsideratë, këto tregues:
a) shkallën e pakujdesisë;
b) shpeshtësinë e kryerjes së gabimit;
c) pozicionin e magjistratit në sistem;
ç) nëse fusha e ligjit në të cilën magjistrati ushtron funksionin vlerësohet si shumë e ndërlikuar, e re ose nuk është zhvilluar sa duhet nga jurisprudenca gjyqësore ose e prokurorisë;
d) mundësinë e ardhjes së dëmit dhe intensiteti i pasojave të mundshme nga shkelja; si dhe
dh) çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të shpjegohet në mënyrë të arsyeshme me keqfunksionimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial si një i tërë.
3. Në zbatim të këtij neni, shkeljet kryhen përmes veprimit dhe mosveprimit të magjistratit. Magjistrati që kryhen shkeljet disiplinore në veçanti në rastet e parashikuara në nenet 102 deri 104 të këtij ligji, ka përgjegjësi disiplinore sipas këtij ligji.

**Neni 102**
**Shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit**

1. Sipas parashikimeve të shkronjës “a” ose “b” të pikës 1, të nenit 101 të këtij ligji, shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit gjyqësor janë në veçanti aktet dhe sjelljet e magjistratit si më poshtë:
a) mosparaqitja e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, kur kjo është e detyrueshme sipas ligjit procedural, nëse magjistrati është ose vihet në dijeni të rrethanave të tilla;
b) kërkesa e magjistratit për heqje dorë dhe miratimi i saj, sipas rastit, nga kryetari, nëse këto veprime:
i) nuk bazohen në shkaqet e parashikuara në ligj;
ii) bëhen në mënyrë të qëllimshme për të krijuar përfitime të padrejta për palët dhe të tretët ose kur synojnë të shmangin magjistratin nga detyrimi ligjor për shqyrtimin e çështjes ose synojnë të krijojnë mundësinë e shqyrtimit të saj nga magjistratë të tjerë;
iii) janë të vonuara në mënyrë të konsiduereshme.
c) sjelljet, aktet dhe veprimet e tjera të magjistratit, të cilat, krijojnë përfitime të padrejta ose dëme për palët pjesëmarrëse në gjykim/hetim ose ndjekja e objektivave të cilat nuk kanë lidhje me detyrimet e magjistratit;

ç)  ndërhyrja ose çdo lloj ndikimi tjetër i papërshtatshëm në ushtrimin e detyrës të një magjistrati tjetër;
d) përdorimi i parregullt i punës së të tjerëve për përmbushjen e detyrimeve ligjore, që i përkasin ushtrimit të funksionit të magjistratit ose delegimi tek të tretët i aktiviteteve të caktuara magjistratit;
dh) mospërmbushja, në mënyrë të qëllimshme ose të përsëritur dhe të pajustifikuar, përkatësisht të funksioneve të gjykimit ose hetimit, si dhe e detyrave të tjera që i caktohen magjistratit për shkak të funksionit të tij;
e) vonesa dhe zvarritja e përsëritur dhe e pajustifikuar e veprimeve procedurale dhe e nxjerrjes së akteve gjatë ushtrimit të funksionit të magjistratit.
ë) shkelja e përsëritur ose e rëndë e rregullave të solementitetit, rregullave të sjelljes në marrëdhëniet me pjesëmarrësit në proces, prokurorët, avokatët, dëshmitarët, ekspertët, subjektet e tjera të përfshira në proces, si edhe me Kryetarin, kolegët dhe personelin e administratës gjyqësore;
f) vonesa e përsëritur dhe e pajustifikuar për fillimin e seancës gjyqësore.
2. Sipas parashikimeve të shkronjave “a” ose “c” të pikës 1 të nenit 101 të këtij ligji, shkeljet disiplinore gjatë ose në lidhje me ushtrimin e funksionit, brenda ose jashtë zyrës, janë në veçanti sjelljet dhe aktet e magjistratit si më poshtë:
a) mospërmbushja e pajustifikuar e detyrimeve për të qenë i gatshëm dhe për tu paraqitur në detyrë për nevojat e ushtrimit të funksionit pranë gjykatave ose prokurorive, nëse ky detyrim përcaktohet nga ligji ose nga vendimet e organeve kompetente.
b) shkelja e rëndë ose e përsëritur e dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjykatave ose prokurorive, në lidhje me funksionet e magjistratit në gjykim ose hetim;
c)  moszbatimi pa shkaqe të justifikuara i vendimeve të dhëna nga Këshilli ose refuzimi i zbatimit të masës disiplinore të dhënë ndaj magjistratit;
ç)  pengimi i Këshillit, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ose çdo organi tjetër publik në kryerjen e funksioneve të tij sipas ligjit;
d) mospërmbushja nga ana e kryetarit e detyrimeve të përcaktuara në ligj, në veçanti detyra për të garantuar përdorimin dhe mënyrën e përdorimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve;
dh) shkelja e detyrimit të konfidencialitetit dhe të mospërhapjes së informacionit, që rezultojnë nga hetimi ose gjykimi, në proces ose i përfunduar, duke përfshirë lehtësimin për shkak të neglizhencës në bërjen publike ose shpërndarjen  të informacioneve konfidenciale.
e) bërja publike e mendimeve që kanë dhënë ose janë dhënë nga magjistratët e tjerë gjatë procesit që akoma nuk ka marrë formën e një akti të bërë publik;
ë) bërja e deklaratave publike në media për çështjet, me përjashtim të komunikimeve të magjistratit të shtypit brenda kufijve të detyrës së tij;
f) mospërmbushja e kushteve shtesë për emërim për magjistratin që ushtron funksionin tek Gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme;
g) mospërmbushja në mënyrë të pajustifikuar e detyrimit për të marrë pjesë të paktën në numrin e përcaktuar të veprimtarive të trajnimit vazhdues, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me ligj.
3. Sipas parashikimeve të shkronjës “a” ose “c” të pikës 1 të nenit 101 të këtij ligji, shkeljet disiplinore janë në veçanti mosnjoftimet nga ana e gjyqtarëve ose kryetarëve, si më poshtë:

a) mosnjoftimi i Këshillit nga magjistrati, lidhur me ekzistencën e rasteve të papajtueshmërisë ambientale të magjistratit për ushtrimin e funksionit të tij, e veçanërisht në rastet e parashikuara në nenin 8 të këtij ligji ose për shkaqe të mbarimit të mandatit;
b) mosnjoftimi nga magjistrati i drejtuesit të gjykatës ose prokurorisë dhe Këshillit për ndërhyrjet ose ushtrimin e formave të tjera të ndikimit të papërshtatshëm nga magjistratët e tjerë;
c) mosnjoftimi nga magjistrati i drejtuesit të gjykatës ose prokurorisë dhe Këshillit, si edhe organeve kompetente sipas ligjit, për ndërhyrjet ose ushtrimin e formave të tjera të ndikimit të papërshtatshëm nga avokatët, funksionarët politikë, funksionarët publikë dhe subjekte të tjerë;
ç) mosnjoftimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nga ana e Kryetarit, lidhur me fakte në dijeni të tyre që mund të përbëjnë shkelje disiplinore të magjistratit;
d) mosnjoftimi i Këshillit, nga ana e kryetarit, lidhur me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, të rasteve të papajtueshmërisë, kufizimet e funksionit, papajtueshmërisë ambientale të magjistratit për ushtrimin e funksionit të tij, dhe në lidhje me çështjet për të cilat ligji parashikon mbarimin e mandatit të magjistratit.
4. Sipas parashikimeve të shkronjës “b” të pikës 1, të nenit 101, të këtij ligji, shkeljet disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës për veprimtaritë kryesore për gjykimin ose në zbatimin e ligjit janë në veçanti sjellje dhe veprimet e magjistratit, si vijon:
a) shkelja e rëndë në mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit procedural dhe material, në kryerjen e veprimeve procedurale;
b) parashtrimi i dukshëm, i shtrembëruar i fakteve në aktet e nxjerra;
c) nxjerrja e akteve të paarsyetuara ose që përmbajnë në arsyetim vetëm përfundime mbi ligjin e zbatueshëm pa parashtruar rrethanat e faktit, të cilat të çojnë në ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes, në të gjitha ato raste kur ligji kërkon nxjerrjen e aktit në formën e arsyetuar;
ç) nxjerrja e akteve ku pjesa përshkruese-arsyetuese parashtron arsyetime që janë haptazi në kundërshtim me pjesën urdhëruese të tij ose që nuk kanë lidhje me të;
d) nxjerrja e akteve të cilat nuk lejohen nga ligji;
dh) nxjerrja e akteve të paparashikuara nga dispozitat procedurale;
c) nxjerrja e akteve për caktimin e masave të sigurimit personal, të ndryshme nga rastet e parashikuara nga ligji.
5. Përveç parashikimeve në pikën 4 të këtij neni, zbatimi dhe interpretimi i këtij ligji nga magjistrati, ashtu si dhe vlerësimi i fakteve dhe provave në çështjet të hetuara nga ai nuk është objekt i procedimit disiplinor.

**Neni 103**
**Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit**

1. Sipas parashikimeve të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 101, të këtij ligji, shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit, janë në veçanti aktet dhe sjelljet e magjistratit si vijon:
a) anëtarësia në subjekte ose ushtrimi i veprimtarive, edhe të ligjshme, por që nuk janë në pajtim me detyrat dhe parimet e ushtrimit të rregullt të funksionit të magjistratit të parashikuara në nenet nga 6 deri në 8 të këtij ligji;
b) përdorimi i mandatit të magjistratit me qëllim për të përfituar arritjen e përftimeve të pajustifikuara ose avantazhe për vete ose për të tjerët;
c) pranimi dhe ushtrimi i detyrave dhe veprimtarive jashtë funksionit në mungesë të lejes së miratuar për këtë qëllim sipas ligjit nga Këshilli;

ç) shoqërimi me persona që janë nën ndjekje penale ose janë subjekte të një procedimi penal, ose me persona të dënuar, përveç rasteve të rehabilitimit të personave të dënuar, ose persona të cilët janë të afërm me magjistratin në lidhje gjaku ose me ligj, dhe pasja e marrëdhënieve biznesi të papërshtatshme me këta persona;
d) përfitimi i padrejtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çfarëdo lloji, të cilat, qoftë edhe me anë të veprimeve të ligjshme, i jepen për shkak të funksionit që ushtron ose si rrjedhojë e përdorimit prej tij të pozicionit të magjistratit;
dh) shkelje të kryera të detyrimeve të ligjit, në veçanti në lidhje me deklarimin e pasurisë dhe konfliktit të interesit sipas ligjit
e) sjellja e papërshtatshme në përmbushjen e detyrimeve, në marrëdhëniet dhe në komunikimin me institucionet shtetërore dhe funksionarët e tyre, dhe raste të tjera me sjellje të papërshtatshme të pajustifikuar.

**Neni 104**
**Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale**

Shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale, janë:
a) faktet e pranuara nga gjykata për të cilat magjistrati është deklaruar fajtor me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, për të cilat ligji parashikon dënim me burgim ose me gjobë;
b) faktet e pranuara nga gjykata për të cilat magjistrati është deklaruar fajtor dhe dënuar me burgim me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale nga pakujdesia;
c) faktet e pranuara nga gjykata për të cilat magjistrati është dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale të ndryshme nga ato të parashikuara në shkronjat “a dhe “b” të këtij neni, nëse për vetë natyrën e faktit penal të konsumuar, është diskredituar rëndë figura, autoriteti, dinjiteti si dhe është dëmtuar rëndë besimi i publikut tek magjistrati dhe organet e drejtësisë;
ç) faktet e pranuara nga organi kompetent me vendim të formës së prerë, që për nga vetë natyra e tyre është diskredituar rëndë figura, autoriteti, dinjiteti si dhe është dëmtuar rëndë besimi i publikut tek magjistrati dhe organet e drejtësisë, të cilat përbëjnë vepër penale pavarësisht se vepra penale është shuar, ndjekja penale nuk mund të fillojë ose nuk mund të vazhdojë, është rehabilituar apo ka përfituar nga falja dhe amnistia.

**Neni 105**
**Masat disiplinore**

1. Këshillat mund të vendosin një ose më shumë nga këto masa disiplinore:
a) vërejtje konfidenciale;
b) vërejtje publike;
c) ulje e përkohshme e pagës:
i) deri në 40% për një periudhë jo më të gjatë se një vit;
ii) në rastin e magjistratëve që kanë dhënë dorëheqjen, gjobë në një masë të barabartë me uljen e përkohshme të pagës.

ç) ulje në detyrë nga një pozicion më i lartë në një më të ulët ose nga një pozicion në Gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm ose në një prokurori tjetër;
d) pezullim nga detyra për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, me të drejtë për përfitimin e pagës minimale sipas vendimit të Këshillit të Ministrave;
dh) shkarkim nga detyra.
2. Në caktimin e masës disiplinore, Këshilli mund të vlerësojë çdo lloj pezullimi të mëparshëm sipas Kreut V të kësaj Pjese, që është vendosur gjatë procedurës përkatëse disiplinore, dhe mund të vendosë në mënyrë të përshtatshme një masë disiplinore më të lehtë ose që pezullimi është masa e përshtatshme dhe e mjaftueshme për shkeljen e kryer.

**Neni 106**
**Vërejtje konfidenciale**

1. Vërejtje konfidenciale është masë disiplinore jo publike, e njohur vetëm për magjistratin ndaj të cilit i jepet, e cila vërteton kryerjen e sjelljes së papërshtatshme të magjistratit.
2. Vërejtje konfidenciale përfshihet në dosjen personale të magjistratit dhe mbahen parasysh në rastin e kryerjes së shkeljeve të ngjashme të disiplinore ose për vlerësimin etik dhe profesional.
3. Vërejtje konfidenciale jepet për shkelje të lehta në të cilat publiku nuk është përfshirë ose nuk është vënë në dijeni të shkeljes.

**Neni 107**
**Vërejtje publike**

1. Vërejtja publike është një formë e masave disiplinore publike që deklaron publikisht kryerjen e sjelljes të papërshtatshme të magjistratit.
2. Vërejtja publike përfshihet në dosjen personale të magjistratit.
3. Vërejtja publike jepet për shkelje të lehta, të cilat janë bërë publike.

**Neni 108**
**Ulja e përkohshme e pagës**

Këshilli, kur vendos të ulë përkohësisht pagën e magjistratit deri në 40% bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 115 të këtij ligji, për një periudhë jo më të gjatë se një vit, ose gjobën që i është caktuar, në masë të barabartë me uljen e përkohshme të pagës, vlerëson rëndësinë e çështjes dhe të gjitha rrethanat e saj. Ulja e përkohshme e pagës jepet në këto raste:
a) kur magjistratit i është dhënë vërejtje konfidenciale ose vërejtje publike për shkelje displinore të mëparshme;
b) kur masat më të lehta disiplinore janë të papërshtatshme për rrethanat e shkeljes disiplinore;
c) kur rrethanat e shkeljes nuk përbëjnë shkelje disiplinore shumë të rëndë, dhe nuk është e përshtatshme një masë disiplinore më e rëndë.

**Neni 109**
**Ulja në detyrë**

1. Ulja në detyrë e magjistratit nga një gjykatë me e lartë në një gjykatë më të ulët ose nga një pozicion në Gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm ose në një prokurori tjetër, jepet në këto raste:
a) kur shkelja është e rëndë;
b) kur magjistrati shfaq sjellje që evidentojnë se aftësitë e tij nuk janë të përshtatshme për gjykatën më të lartë ose gjykatën e specializuar, ndërkohë që shkelja nuk e bën magjistratin të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin e tij si magjistrat.
2. Në rast ulje ne detyrë sipas pikës 1 të këtij neni, magjistrati merr pagën e pozicionit të ulur në detyrë.

**Neni 110**
**Pezullimi si masë disiplinore**

Masa e pezullimit nga detyra e magjistratit, me të drejtën për të marrë pagën minimale[14] për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, jepet vetëm në këto raste:
a) kur shkelja është e shumë e rëndë;
b) kur Këshilli çmon se, pavarësisht se natyra dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes nuk e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm ose të padenjë për të ushtruar funksionin, rëndësia e shkeljes dhe dëmi që i shkaktohet imazhit të magjistratit kërkojnë që magjistrati të pezullohet për një kohë të caktuar.

**Neni 111**
**Shkarkimi**

1. Shkarkimi i magjistratit nga detyra jepet si masë disiplinore vetëm në këto raste:
a) kur shkelja është shumë e rëndë;
b) kur Këshilli çmon se natyra dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm ose të padenjë për të ushtruar funksionin e tij, për shkak të dënimit për kryerjen e një krimi, për shkak të paaftësisë së rëndë dhe të dukshme, ose për shkak të një sjellje që kryhet të paktën me pakujdesi të rëndë sipas nenit 101, shkronja “b” e këtij ligji dhe që shkel haptazi vlerat themelore të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.
2. Në rastin kur magjistrati i Gjykatës së posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose i Prokurorisë së Posaçme përhap informacion sensitiv, si nga pakujdesia e rëndë sipas nenit 101, shkronja “b” e këtij ligji ose me dashje, ose kur kryen shkelje tjetër të rëndë, atij i jepet masa disiplinore e shkarkimit.

**Neni 112**
**Masat disiplinore plotësuese**

1. Nëse magjistrati është dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale në fushën e korrupsionit Këshilli vendos përveç shkarkimit të magjistratit edhe kthimit të shumës së pagës bruto të vitit të fundit në detyrë të përfituar prej tij/saj.
2. Këshilli, së bashku me masat të parashikuara në pikën 1, shkronja “b”, “c (i)”, “ç”, “d”, të nenit 105 të këtij ligji mund të vendos edhe një nga masat disiplinore plotësuese të mëposhtme:

---
[14] Vendosur me vendim të Këshillit të Ministrave.

a) ndjekjen e detyrueshme të trajnimeve profesionale të specifikuara, sipas parashikimit në nenin 113 të këtij ligji;
b) largimi nga detyra e kryetarit.

**Neni 113**
**Masa plotësuese për trajnim**

Në mbështetje të nenit 112, të pikës 2, shkronja "a", të këtij ligji, Këshilli mund të vendos masën disiplinore plotësuese të ndjekjes së detyrueshme të trajnimeve profesionale të specifikuara nëse shkelja e kryer mund të korrigjohet nëpërmjet pjesëmarrjes në programet e detyrueshme të trajnimit. Në këtë rast, në vendim përcaktohet përmbajtja dhe kohëzgjatja e programit të detyrueshëm të trajnimit.

**Neni 114**
**Largimi nga detyra e Kryetarit**

Këshilli mund të vendosë masën disiplinore plotësuese të largimit të magjistratit nga detyra e Kryetarit dhe caktimin e tij si magjistrat, në rastet e shkeljeve të kryetarit, të cilat nuk justifikojnë vazhdimësinë e tij në funksione drejtuese, sipas parashikimeve të nenit 112, të pikës 2, shkronja "a", të këtij ligji.

**Neni 115**
**Kriteret për caktimin e masës disiplinore**

1. Në caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore dhe llojit të masës disiplinore, Këshilli merr parasysh këto kritere:
a) llojin dhe rrethanat e shkeljes;
b) shkallën e fajësisë dhe motivin;
c) pasojat e shkeljes;
ç) të dhënat profesionale, të çështjeve disiplinore dhe të dhëna kriminale të magjistratit;
d) masën e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore;
dh) çdo rrethanë e rëndësishme që ka lidhje me shkeljen;
e) rrethana të lidhura me gjendjen shëndetësore të magjistratit;
ë) sjelljen e magjistratit pas kryerjes së shkeljes dhe pas fillimit të hetimit;
f) sjelljen e magjistratit gjatë procedimit disiplinor dhe qëndrimin që mban ndaj tij;
gj) çdo çështje tjetër që Këshilli e konsideron të rëndësishme.
2. Këshilli, kur vendos masën disiplinore:
a) duhet të arsyetojë parimin e proporcionalitetit;
b) duhet të marrë parasysh çdo rrethanë lehtësuese ose rënduese.
3. Rrethanat lehtësuese, sipas pikës 2 të këtij neni janë:
a) kur magjistrati e kryen shkeljen për herë të parë;
b) kur magjistrati ka vepruar nën ndikimin e një pale të tretë, për shkak të besimit ose frikës;
c) duke marrë parasysh në tërësi rrethanat e çështjes, shkelja e magjistratit ka patur ndikim të vogël;

ç) kur magjistrati bashkëpunon në hetimin dhe procedimin disiplinor, duke përfshirë dhe rastet kur pranon shkeljen e kryer ose jep informacione që ndihmojnë në hetimin dhe procedimin disiplinor;
d) kur magjistrati ka zëvendësuar dëmin e shkaktuar nga shkelja ose ka ndihmuar në mënyrë aktive për të zhdukur ose pakësuar pasojat e saj;
dh) koha që ka kaluar që nga kryerja e shkeljes;
e) kur ekziston çdo rrethanë tjetër për të cilën Këshilli çmon se lehtëson shkeljen e kryer.
4. Rrethanat rënduese, sipas pikës 2 të këtij neni janë:
a) kur shkelja kryhet më shumë se një herë, ose kur shkelja është kryer pas dhënies së një mase disiplinore për një shkelje të mëparshme;
b) kur shkelja është e vazhdueshme;
c) kur shkelja kryhet për shkak të motive diskriminuese;
ç) kur shkelja kryhet për motive të tjera të dobëta;
d) kur nxiten të tjerët për kryer shkelje ose veprime të paligjshme;
dh) kur shkelja kryhet duke shfrytëzuar dobësitë ose pozitën e cenueshme të të tjerëve;
e) kur ekziston çdo rrethanë tjetër për të cilën Këshilli çmon që se rëndon shkeljen e kryer.

**Neni 116**
**Masat për shmangien e vonesave**

1. Për magjistratin ose përfaqësuesin e tij në rastet e deklarimit në mungesë si dhe të procedimit disiplinor në mungesë të magjistratit, do të zbatohen rregullat procedurale të parashikuar nga Kodi i Procedurës Penale për aq sa këto rregulla gjejnë zbatim.
2. Në rastin kur magjistrati ose përfaqësuesi i tij~~,~~ dëshmitari, eksperti ose përkthyesi cënojnë dinjitetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ose të Këshillit, ose kryejnë ndonjë veprim që në mënyrë të dukshme ka për qëllim të vonojë procedurën, autoriteti kompetent paralajmëron magjistratin dhe e udhëzon mbi pasojat e kësaj sjellje. Në rastet se sjellja vazhdon, autoriteti kompetent e dënon me gjobë deri në 100.000 lekë subjektin shkelës. Përsëritja e sjelljes përbën shkak për dhënien sërish të dënimit me gjobë dhe nëse vlerësohet e përshtatshme, për fillimin e hetimit disiplinor ose penal.
3. Vendimi për dënimin me gjobë, përbën titull ekzekutiv. Shërbimi përmbarimor ngarkohet me ekzekutimin e vendimit përkatës.
4. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim brenda 24 orëve nga marrja dijeni e tij. Ankimi shqyrtohet nga Këshilli, në rast se gjoba vendoset nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe nga gjykata kompetente në rast se gjoba vendoset nga Këshilli.
5. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ose Këshilli i njoftojnë vendimin për dënimin me gjobë, Dhomës Kombëtare të Avokatisë ose institucioneve përgjegjëse për ekspertët ose përkthyesit.

**KREU II**
**PROCEDURAT HETIMORE**

**Neni 117**
**Afatet e parashkrimit**

1. Shkeljet disiplinore parashkruhen brenda pesë vjetëve. Nëse një ankesë sipas nenit 119 të këtij ligji paraqitet pas 5 vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar Inspektori i Lartë

i drejtësisë nuk verifikon ankesën për shkak të parashkrimit. Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr të dhëna sipas nenit 124 të këtij ligji pas 5 vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar ai nuk fillon hetimit për shkak të parashkrimit.
2. Afati i parashkrimit fillon nga momenti kur shkelja e pretenduar është kryer.
3. Nëse magjistrati kryen shkelje tjetër të së njëjtës natyrë brenda afatit të parashkrimit, afati zgjatet deri në një vit.
4. Pavarësisht parashikimeve të pikëve 1 dhe 3 të këtij neni, për shkeljet disiplinore që përbëjnë njëkohësisht vepra penale, afatet e parashkrimit përllogariten sipas parashikimeve të Kodit Penal, vetëm nëse në këtë Kod parashikohen afate parashkrimi më të gjata se pesë vjet.

**Neni 118**
**Afatet e procedimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë**

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos të arkivojë ankesën ose të fillojë hetimin për shkeljen e pretenduar, brenda tre muajve nga marrja e ankesës.
2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë brenda gjashtë muajve nga dita e marrjes së vendimit për fillimin e hetimit, fillon procedimin disiplinor duke i paraqitur Këshillit kompetent raportin e hetimit ose merr vendimin për mbylljen e hetimit.
3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të zgjasë afatin e hetimit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni për tre muaj të tjerë në raste komplekse, për arsye të shtimit ose ndryshimit të objektit të hetimit, ose në rast sëmundje apo pamundësisë së magjistratit.
4. Në rastet kur, pas kalimit të afateve të parashikuara në pikat 2 ose 3 të këtij neni, dalin prova të reja, mbi bazën e të cilave ka shkaqe të arsyeshme të besohet se shkelja mund të ketë ndodhur, Inspektori i Lartë i Drejtësisë riçel hetimin, me kushtin që nuk janë parashkruar afatet sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 4 të nenit 117 të këtij ligji.
5. Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk zbaton afatet e parashikuara në pikët 1 deri në 4 të këtij neni, magjistrati ka të drejtën të ankimojë mosveprimin administrativ të tij tek Këshilli përkatës.

**Neni 119**
**Ankesat**

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë shqyrton ankesat e paraqitura nga çdo person fizik ose juridik.
2. Në rastet kur ka të dhëna të besueshme që një magjistrat ka kryer shkelje disiplinore, ankesa paraqitet tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë, nga subjektet e mëposhtme:
a) Ministri i Drejtësisë;
b) një anëtar i vetëm i Këshillit;
c) Kryetari i Gjykatës ose i Prokurorisë.
3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka detyrimin të shqyrtojë ankesat, përveç atyre anonime. Ankuesi ka të drejtë të kërkojë ruajtjen e konfidencialitetit.
4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i konfirmon ankuesit marrjen e ankesësn brenda pesë ditëve nga marrja e saj. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i njofton ankuesin vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij si dhe mbylljen e hetimit, brenda pesë ditëve nga marrja e vendimit përkatës. Ankuesi ka të drejtë të ankimojë vendimet për arkivimin dhe mbylljen e hetimit.
5. Ankesa paraqitet personalisht, me postë të rregullt, postë elektronike ose faks.

6. Tërheqja e ankesës nga ankuesi nuk sjell arkivimin e ankesës, nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson që pretendimi ka shkaqe të mjaftueshme për kryerjen e hetimit me iniciativën e tij, si dhe nuk sjell mbylljen e një hetimi të filluar.
7. Ankesa mund të përmbajë prova dhe burime të dhënash për faktet dhe rrethanat e pretenduara.
8. Inspektori i Lartë i Drejtësisë publikon modelin e formularit të ankesës në faqen e tij zyrtare, me qëllim lehtësimin e paraqitjes së ankesave.

**Neni 120**
**Kriteret për pranueshmërinë e ankesës**

1. Ankesa pranohet nëse përmbush kriteret e mëposhtme:
a) paraqitet në formën e përcaktuar sipas parashikimeve të bëra në pikën 2 të këtij neni;
b) i referohet fakteve që kanë ndodhur brenda afatit të parashkrimit për hetimin disiplinor;
c) nuk përmban elementë abuzivë, nuk është haptazi e pabazuar ose e përsëritur nga i njëjti ankues.
ç) bëhet ndaj sjelljes së magjistratit, i cili ka qënë në detyrë në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur;
d) bëhet ndaj sjelljes së magjistratit të parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji në fuqi në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur;
dh) bëhet ndaj sjelljes së magjistratit që nëse provohet se është kryer përbën shkelje disiplinore parashikuar nga ligji.
2. Ankesa paraqitet në formë të shkruar dhe përmban të dhënat e mëposhtme:
a) gjeneralitet dhe adresën e ankuesit, si dhe nëse ankuesi kërkon konfidencialitetin e identitetit të tij;
b) përshkrim të rrethanava të faktit që pretendohen të ketë ndodhur; ~~dhe~~
c) emrin dhe mbiemrin e magjistratit, gjykatën ose prokurorinë, në të cilin magjistrati ka ushtruar funksionin në kohën kur ka ndodhur shkelja e pretenduar.

**Neni 121**
**Shqyrtimi fillestar dhe Vlerësimi i Ankesës**

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë shqyrton fillimisht nëse ankesa është ose jo e pranueshme.
2. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos:
a) të arkivojë ankesën pasi nuk përmbush një ose më shumë kritere të parashikuara në pikën 1 të nenit 120 të këtij ligji;
b) të verifikojë ankesën;
c) të fillojë hetimin.
3. Në rastin kur vendoset të arkivohet ankesa, vendimi për arkivimin i njoftohet ankuesit dhe magjistratit brenda afatit të parashikuar në pikën 4 të nenit 119 të këtij ligji. Ankuesi ka të drejtë të ankimojnë këtë vendim në Këshill, brenda një jave nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar.

**Neni 122**
**Verifikimi i ankesës**

1. Për ankesën që nuk ka informacion të qartë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë verifikon nëse ka fakte të mjaftueshme që justifikojnë fillimin e hetimit.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund ti kërkojë ankuesit të paraqesë dokumente shtesë ose të japë shpjegime, për mënyrën dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur shkelja e pretenduar.
3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të marrë çdo informacion tjetër nga këshilli, gjykata ose prokuroria përkatëse.
4. Në rast se nuk ka fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit, ankesa arkivohet.
5. Vendimi i arsyetuar për arkivimin e ankesës i njoftohet ankuesit dhe magjistratit ndaj të cilit është paraqitur ankesa. Ankuesi ka të drejtë të ankimojë këtë vendim në Këshill, brenda një jave nga marrja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

**Neni 123**
**Vendimi i fillimit të hetimit me nismë të ankuesit**

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin nëse ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer bazuar në faktet dhe provat e mbledhura, që justifikojnë fillimin e hetimit.
2. Inspektori i Larte i Drejtesisë merr vendim për fillimin e hetimit, pavarësisht zhvillimit të një procesi gjyqësor apo administrativ në lidhje me të njëjtat fakte.
3. Vendimi i arsyetuar për fillimin e hetimit i njoftohet ankuesit, magjistratit dhe Këshillit. Vendimi duhet të përmbajë të paktën:
a) emrin e inspektorëve të ngarkuar me hetimin;
b) objektin e hetimit duke treguar shkeljen e dyshuar;
c) parashtrimin e rrethanave të faktit të pretenduara;
ç) provat e mbledhura;
d) periudhën kohore përkatëse për hetimin;
dh) parashtrimin e të drejtave të magjistratit në lidhje me hetimin disiplinor, si dhe të drejtën e magjistratit dhe të ankuesit për të dorëzuar parashtresë dhe dokumente mbështetëse, brenda tre javëve nga marrja e vendimit.
4. Në rastet kur shkelja ka të bëjë me sjellje ose veprime të përsëritura, objekti i hetimit sipas pikës 3 shkronja “b” të këtij neni përmban sjelljet e magjistratit në rastet e tjera, në lidhje me të njëjtën situatë brenda periudhës kohore të përcaktuar në vendimin për fillimin e hetimit, në mënyrë që të verifikohet nëse janë vërejtur sjellje të tilla apo të përsëritura.

**Neni 124**
**Fillimi i hetimeve me iniciativën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë**

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin me iniciativën e tij, bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer. Informacionet që përftohen nga media ose nga ankues anonim mund të shërbejnë si indicie për të filluar një hetim kryesisht nëse përmbushen kriteret e parashikuara në nenin 120, pika 1, shkronja “b”, “ç”, “d”, dhe “dh”.
2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos me vendim të arsyetuar për fillimin e hetimit me iniciativën e tij duke parashtruar rrethanat faktike të verifikueshme.
3. Rregullat e parashikuara në pikat 2 deri në 4 të nenit 123 të këtij ligji zbatohen edhe në rastin e fillimit të hetimit me iniciativën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

**Neni 125**
**Shtimi ose ndryshimi i objektit të hetimit**

1. Në rast se gjatë hetimit, ngrihen dyshime të arsyeshme se ka ndodhur një shkelje tjetër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, merr vendim për të shtuar ose ndryshuar objektin e hetimit në zbatim të nenit 124 të këtij ligji.
2. Rregullat e parashikuara në pikat 2 deri në 4 të nenit 123 të këtij ligji, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.

**Neni 126**
**Pezullimi i hetimeve**

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos pezullimin e hetimit disiplinor kur është duke u zhvilluar hetim penal ose një proces gjyqësor penal, administrativ ose civil:
a) në të cilat, njëra nga palët është magjistrati;
b) shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte për të cilat do të merret vendimi.
2. Hetimi pezullohet deri në dhënien e vendimit të formës së prerë të institucionit kompetent.
3. Ankuesi, magjistrati, gjykata, prokuroria dhe Këshilli njoftohen me shkrim për vendimin e pezullimit. Gjykata, prokuroria e interesuar ose institucione të tjera, i dërgojnë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë pa vonesë, çdo vendim që merret gjatë hetimit dhe procesit përkatës.
4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i referohet vetëm fakteve mbi të cilat bazohet vendimi i formës së prerë i gjykatës. Vendimi i formës së prerë i gjykatës në favor të magjistratit nuk pengon hetimin nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për të përcaktuar përgjegjësinë disiplinore të magjistratit.
5. Pezullimi i hetimeve ndërpret afatet e procedimit të parashikuara nga neni 117 i këtij ligji për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.
6. Vendimi për pezullimin e hetimit nuk ankimohet.

**Neni 127**
**Kërkesa për pezullimin e magjistratit**

Në çdo fazë të procedurës së hetimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë informon Këshillin lidhur me faktet që sjellin pezullim të detyrueshëm të magjistratit sipas parashikimeve në nenin 151 të këtij ligji ose mund të kërkojë vetë pezullimin e magjistratit për arsyet e parashikuara në nenin 152 të këtij ligji.

**Neni 128**
**Bashkimi i procedimeve hetimore**

Inspektori i Lartë i Drejtësisë bashkon procedimet, në rastet kur konstaton se ankesat ose hetimet e filluara, i referohen të njëjtave fakte ose të njëjtit magjistrat.

**Neni 129**

**Të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve gjatë hetimit**

1. Magjistrati është palë në proces që nga momenti i fillimit të hetimit sipas nenit 123 ose 124 i këtij ligji, dhe i garantohet aksesi në dosjen e hetimit në atë masë që është në përputhje me objektin e hetimit.
2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të kërkojë nga magjistrati informacion, dokumenta ose çdo provë që është e nevojshme për hetimin.
3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë i njofton magjistratin të interesuar ose përfaqësuesit të tij, vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij si dhe mbylljen e hetimit, brenda pesë ditëve nga marrja e vendimit përkatës.

**Neni 130**
**Ecuria e Hetimeve**

1. Objekti i hetimit tregon qartë elementet e shkeljes së pretenduar, sipas përcaktimeve në vendimin për fillimin e hetimit, sipas parashikimeve të nenit 123 të këtij ligji.
2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë thërret dëshmitarë dhe mbledh të dhëna, dokumente dhe prova nga gjykata, prokuroria, institucione të tjera shtetërore, organizata, dëshmitarë dhe/ose magjistrati, dhe ndërmerr veprime të nevojshme për të hetuar dhe përcaktuar nëse shkelja e pretenduar ka ndodhur.
3. Kur shkelja e pretenduar lidhet me çështje në proces në gjykatë ose në prokurori, hetimi duhet të jetë i tillë që të mos cenojë pavarësinë e magjistratit në gjykimin dhe hetimin e tyre dhe të mos konsiderohet si ndërhyrje. Në një rast të tillë Inspektori i Lartë i Drejtësisë:
a) pezullon hetimet sipas rasteve të parashikuara në nenin 126 të këtij ligji;
b) vazhdon me hetimin nëse shkelja e pretenduar ka të bëjë me fakte që nuk lidhen me ato për të cilat do të vendoset nga hetimi penal ose procesi penal, civil ose administrativ.

**Neni 131**
**Kërkesat për marrjen në pyetje**

1. Kur Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson se marrja në pyetje e magjistratit, dëshmitarëve ose personave të tjerë, paraqet rëndësi për hetimin, i njofton ata lidhur me kohën dhe vendin e seancës së marrjes në pyetje.
2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka për detyrë të sigurojë që seanca e marrjes në pyetje të regjistrohet në audio, sipas procedurës së mëposhtme:
a) personi që merret në pyetje duhet të informohet se seanca përkatëse do regjistrohet në audio;
b) regjistrimi duhet të përmbajë gjeneralitetet e personave qe janë thirrur për t'u pyetur;
c) në rast ndërprerje të seancës së marrjes në pyetje, përpara se regjistrimi audio të përfundojë, regjistrohet ora, shkaku i ndërprerjes, si dhe ora e rifillimit të seancës;
ç) në përfundim të seancës, personi i marrë në pyejtje, mund të saktësojë çdo gjë që ka deklaruar, si dhe të shtojë gjithçka që vlerëson. Më kërkesën e personit të marrë në pyetje, regjistrimi dëgjohet, si dhe regjistrohen korrigjimet dhe shpjegimet e tij në lidhje me deklarimet e mëparshme. Në mbarim të seancës së marrjes në pyetje regjistrohet ora e përfundimit të saj.
3. Regjistrimi audio i seancës së marrjes në pyetje duhet të përmblidhet në procesverbal, si dhe mund të transkriptohet. Magjistrati nënshkruan procesverbalin e marrjes në pyetje, si dhe transkriptimin e regjistrimit audio nëse është bërë i mundur.

4. Rregjistrimi audio, transkriptimi i tij nëse është bërë i mundur, si dhe prosecverbali i seancës së marrjes në pyetje bëhen pjesë e dosjes.

**Neni 132**
**Kërkesat në lidhje me mbledhjen e provave nga Institucionet e tjera**

1. Çdo organ publik, person fizik ose juridik duhet të zbatojë kërkesat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për marrje informacioni, dokumente ose prova të tjera që lidhen me hetimin, brenda afatave kohore të arsyeshme të përcaktuara nga Inspektori në kërkesën e tij, me përjashtim të rasteve kur dhënia e tyre është e kufizuar me ligj.
2. Nëse gjatë hetimit disiplinor të magjistratit, ekzistojnë nevoja thelbësore dhe specifike, për të marrë dokumente, informacione, regjistrime telefonike ose prova të tjera, të cilat mbrohen nga garancitë për konfidencialitet ose mbrojtjen e të dhënave personale, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund t’i kërkojë Gjykatës së posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, lëshimin e një urdhëri për dhënien e informacionit të kërkuar për magjistratin.
3. Kërkesa duhet të përmbajë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm se magjistrati ka kryer shkeljen, si dhe se informacioni i kërkuar është thelbësor për të përcaktuar nëse shkelja ka ndodhur.
4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë përsërit kërkesën, në rastin kur personi ose subjekti të cilit i drejtohet kjo kërkesë, nuk e përmbush atë brenda afatit të caktuar, duke informuar në rastin e personit juridik edhe drejtuesin e tij. Në rastin kur personi ose subjekti të cilit i drejtohet kjo kërkesë, nuk përmbush kërkesën e përsëritur brenda afatit të caktuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të vendosë gjobë deri në 100,000 lekë, si dhe njofton organin përgjegjës disiplinor.
5. Urdhëri për vendosjen e gjobës është titull ekzekutiv. Shërbimi përmbarimor ngarkohet me ekzekutimin e vendimit përkatës.
6. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim në Këshillin përkatës brenda 24 orëvë nga marrja dijeni e tij.

**Neni 133**
**Dokumentacioni i Hetimit**

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dokumenton çdo veprim hetimor me procesverbal.
2. Procesverbali duhet të përmbajë:
a) emrin dhe mbiemrin e inspektorit që kryen veprimin;
b) datën e kryerjes së veprimit;
c) subjekti dhe objekti i veprimit;
ç) pjesëmarrësit;
d) përshkrimin e hollësishëm të veprimit të kryer;
dh) nënshkrimin e inspektorit në fund të çdo faqeje, si dhe të personave që marrin pjesë në këto veprime;
3. Me përfundimin e hetimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë harton raportin e hetimit, i cili përmban të paktën:
a) emrin dhe mbiemrin e inspektorit kompetent;
b) shkaqet për të filluar hetimin, subjektin dhe objektin e hetimit, sipas përcaktimeve të bëra në vendimin për fillimin e hetimit, ndryshimin ose shtimin e objektit të hetimit;
c) veprimet e kryera gjatë hetimit;

ç) përmbledhjen e deklaratave të magjistratit përkatës dhe të personave të tjerë ose institucioneve;
d) parashtrimin e fakteve të pranuara dhe të papranuara, ashtu si edhe të provave, si dhe vlerësimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre;
dh) analizën ligjore të fakteve të pranuara që mbështesin përfundimin se shkelja disiplinore e pretenduar është kryer ose se hetimi duhet mbyllur;
e) propozimin për mbylljen e hetimit ose për fillimin e procedimit disiplinor dhe propozimin për caktimin e masës disiplinore.

## Neni 134
## Mbyllja e Hetimit

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbyll hetimin, nëse provohet se pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se:
a) provat janë të pamjaftueshme për të provuar kryerjen e shkeljes disiplinore;
b) çështja ka qenë objekt i një hetimi të mëparshëm që është mbyllur ose për të cilën është dhënë vendim i formës së prerë në kuadër të një procedimi disiplinor;
c) çështja është parashkruar në kohën kur është filluar hetimi, për shkak të kalimit të afateve;
ç) magjistratit i mbaron statusi bazuar në kriteret e parashikuara, në shkronjat “b” deri në “ç”, të paragrafit 1, të nenit 64 të këtij ligji ose nuk ushtron funksionin e tij në mënyrë të përhershme sipas parashikimeve të nenit 67 të këtij ligji;
d) magjistrati ka vdekur.
2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë duhet t’i njoftojë vendimin magjistratit të interesuar ose përfaqësuesit të tij ankuesit dhe Këshillit përkatës. Vendimi duhet të përmbajë arsyet për mbylljen e hetimit sipas pikës 1 të këtij neni. Vendimi tregon të drejtën e ankuesit për të ankimuar këtë vendim në Këshillin përkatës. Ankuesi ka të drejtë të ankimojnë këtë vendim në Këshill, brenda një jave nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar.
3. Në rastet kur magjistrati ka dalë në pension, Inspektori i Lartë i Drejtësisë harton raportin përfundimtar, i cili përmban përmbledhje të pretendimeve për shkeljen disiplinore, provat e mbledhura dhe konkluzionet. Raporti mbyll procesin hetimor, si dhe ju bëhet me dije palëve dhe Këshillit përkatës.
4. Faktet e zbuluara gjatë hetimit, të cilat nuk justifikojnë fillimin e procedimit disiplinor, por që mund të jenë të rëndësishme për vlerësimin etik dhe profesional, duhet t’i paraqiten Këshillit për shqyrtim të mëtejshëm.

## Neni 135
## Marrëveshje e Përbashkët e Pranimit

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe magjistrati, në çdo kohë mund të dakortësojnë marrëveshjen e përbashkët të pranimit lidhur me shkeljen disiplinore që i atribuohet magjistratit.
2. Palët mund të bien dakord për llojin e shkeljes disiplinore që magjistrati pranon, si dhe masën disiplinore të përshtatshme.
3. Palët hartojnë me shkrim dhe nënshkruajnë marrëveshjen, e cila dorëzohet në Këshillin përkatës.
4. Marrëveshja duhet të përmbajë:
a) përmbledhje të fakteve dhe shkeljes që pranon magjistrati;

b) masën disiplinore që palët kanë rënë dakort;
c) një deklaratë se magjistrati është i vetëdijshëm se marrëveshja duhet të miratohet nga Këshilli.
5. Këshilli përkatës pranon marrëveshjen me vendim të arsyetuar, nëse:
a) marrëveshja është nënshkruar nga të gjitha palët dhe përmban elementet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni;
b) nëse rezulton se magjistrati e ka kuptuar marrëveshjen dhe përmbajtjen e saj, si dhe nëse ai ka dhënë pëlqimin me shkrim me vullnetin e tij të lirë.
c) masat disiplinore kryesore dhe plotësuese për të cilat kanë rënë dakort Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe magjistrati, të jenë në përputhje me këtë ligj.
6. Këshilli përkatës refuzon marrëveshjen me vendim të arsyetuar, nëse:
a) marrëveshja nuk nënshkruhet nga të gjitha palët ose nuk përmban elementet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni;
b) magjistrati i thirrur rregullisht nuk merr pjesë në seancë dhe nuk paraqet shkaqe të arsyeshme për mungesën e tij;
c) provat e mbledhura janë në kundërshtim haptazi me deklarimin e magjistratit për pranimin e kryerjes së shkeljes disiplinore;
ç) masat disiplinore kryesore dhe plotësuese për të cilat kanë rënë dakort Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe magjistrati, nuk janë në përputhje me këtë ligj;
d) magjistrati është detyruar të pranoj marrëveshjen;
dh) magjistrati tërheq pëlqimin për marrëveshjen.
7. Nëse Këshilli e pranon marrëveshjen, ajo do të konsiderohet si një vendim i formës së prerë i procedimit disiplinor, e cila nuk ankimohet.
8. Nëse Këshilli refuzon marrëveshjen, atëherë çdo pohim i bërë nga palët që lidhet me shkeljen disiplinore në kuadër të hartimit të marrëveshjes, si dhe para Këshillit gjatë seancës për pranimin ose jo të marrëveshjes, nuk mund të përdoret në favor ose kundër këtyre palëve.
9. Nëse marrëveshja refuzohet, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të filloj ose vazhdojë veprimet hetimore disiplinore ndaj magjistratit, brenda një muaji nga dita e refuzimit të kësaj marrëveshje.
10. Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk zbaton afatet e parashikuara në pikën 9 të këtij neni, magjistrati ka të drejtë të ankimojë mosveprimin administrativ të tij tek Këshilli përkatës.

**Neni 136**
**Dërgimi i çështjes të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë**

1. Nëse gjatë procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson se ka dyshime të arsyeshme që mund të jetë kryer një shkelje tjetër, atëherë:
a) kërkon të ndërpres procedimin disiplinor, vendos për shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit, kryen hetimin e nevojshëm dhe paraqet raportin e hetimit të mëtejshëm brenda një muaji nga ndërprerja e procedimit;
b) i kërkon Këshillit që të shtojë ose ndryshojë objektin e hetimit, nëse nuk është e nevojshme kryerja e hetimeve të mëtejshme, pasi të ketë marrë mendimin e palëve.
2. Këshilli mund të dërgojë çështjen tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në rastet e parashikuara në nenin 144 të këtij ligji.

**Neni 137**
**Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve**

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë krijon dhe administron një sistem të menaxhimit të çështjeve për procedurën hetimore.
2. Sistemi duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:
a) gjeneralitet dhe adresën e magjistratit nën hetim;
b) emrin dhe adresën e ankuesit, nëse është e mundur;
c) objektin e hetimit;
ç) të dhënat përkatëse mbi zhvillimin e hetimit;
d) informacion për arkivimin e ankesës, mbi mbylljen e hetimit ose për fillimin e procedimit disiplinor;
dh) informacion për vendimin e formës së prerë për masën disiplinore;
e) informacione të tjera sipas rastit.
3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë harton dispozita të hollësishme për:
a) formatin dhe të dhënat që administrohen në regjistër;
b) informacionin shtesë që përfshihet në sistem;
c) mënyrën e mbajtjes së sistemit;
ç) informacionin e sistemit që është i hapur për publikun si dhe informacion që është i aksesueshëm vetëm nga magjistrati nën hetim.
4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbledh dhe përpunon të dhënat në përputhje me Ligjin "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

## KREU III
## FILLIMI I PROCEDIMIT DISIPLINOR

### Neni 138
### Fillimi i procedurës disiplinore

1. Nëse ka dyshime të arsyeshme që magjistrati ka kryer shkelje disiplinore, Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon procedimin disiplinor duke paraqitur raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore.
2. Këshilli:
a) përcakton datën për seancën dëgjimore, e cila duhet të jetë brenda një muaj nga dita e marrjes së dosjes nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë;
b) njofton palët për datën e seancës dëgjimore të paktën 15 ditë para saj.
3. Këshilli mund të zgjas afatin e parashikuar në pikën 2 shkronja "a", deri në dy muaj, për shkaqe të rëndësishme, të cilat duhet të bëhen publike.
4. Këshilli:
a) shqyrton të gjithë faktorët që kanë rëndësi për çështjen;
b) merr prova shtesë, duke përfshirë edhe thirrjen e dëshmitarëve;
c) kur e konsideron të përshtatshme, thërret ekspertë ose i kërkon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të thërras ekspertë.
5. Këshilli mund t'i kërkojë Inspektorit të Lartë i Drejtësisë kryerjen e hetimeve të mëtejshme duke specifikuar elementët që mungojnë dhe afatin. Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen veprimet hetimore sipas kërkesës së Këshillit.

**Neni 139**
**Mbyllja e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore**

1. Këshilli vendos mbylljen e procedimin disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore nëse:
a) shkelja disiplinore është parashkruar në kohën kur ka filluar hetimi, sipas parashikimeve të nenit 117 të këtij ligji;
b) çështja ka qenë objekt i procedimit disiplinor që është zgjdhur me vendim të formës së prerë;
c) ka arsye të tjera për të mbyllur procedimin në përputhje me parashikimet e nenit 134, pika 1, gërma ç) dhe d);
ç) raporti i hetimit është depozituar pa u arsyetuar.
2. Dorëheqja e magjistratit nuk ndalon fillimin ose vazhdimin e procedimit disiplinor.
3.Këshilli mbyll procedimin disiplinor sipas parashikimeve të pikes 1 të këtij neni me vendim të arsyetuar me shkrim. Ai njofton palët për shkaqet e mbylljes.

**Neni 140**
**Bashkimi i procedimeve disiplinore**

1. Kur Këshilli konstaton që procedimi disiplinor i referohet të njëjtave fakte dhe të njëjtit magjistrat, mund të vendos bashkimin e procedimeve.
2. Në raste kur një gjyqtar ose një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje, Këshillat vendosin bashkimin e procedimeve. Këshillat miratojnë rregulla të përbashkëta për bashkimin e procedimeve.

**Neni 141**
**Të drejtat dhe detyrimet e palëve gjatë procedimit disiplinor**

1. Gjatë procedimit disiplinor, magjistratit ose përfaqësuesit të tij u sigurohet aksesi në dosje në masën që nuk cënon:
a) interesat ligjore të palëve ose personave të tretë;
b) funksionet e organit vendim-marrës;
c) qëllimin e procedimit.
2. Kur magjistrati njoftohet se ndaj tij ka filluar procedim disiplinor duhet që t'i bëhen të ditura të drejtat për:
a) të paraqitur një parashtresë me shkrim në afatin e caktuar;
b) të marrë pjesë në seancë dëgjimore;
c) të thirrur dëshmitarë që mund të dëshmojë fakte me interes për çështjen;
ç) të paraqitur dokumente;
d) të marrë masa të tjera për paraqitjen e provave në mbështetje të mbrojtjes së tij;
dh) t'u përfaqësuar, sipas parashikimeve në Kodin e Procedurave Administrative;
e) për kompensimin e shpenzimeve të arsyeshme ligjore të tij/saj në raste kur nuk vendoset masë disiplinore.
3. Këshilli mund t'i kërkojë magjistratit të paraqesë të dhëna, dokumente ose çdo lloj prove, si dhe të marrë pjesë në seancë dëgjimore.
4. Palët kanë të drejtë të njoftohen për çdo vendim të Këshillit brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

**Neni 142**
**Seanca disiplinore**

1. Seanca dëgjimore për procedimet disiplinore është publike.
2. Këshilli, kryesisht ose me kërkesë të palëve mund të vendosë zhvillimin e seancës me dyer të mbyllura, në rastet:
a) kur publiciteti i seancës mund të dëmtojë moralin e shoqërisë ose mund të bëj publike të dhëna sekrete në interes të sigurisë kombëtare, nëse kjo kërkohet nga autoritetet kompetente;
b) kur është e nevojshme të mbrohet e drejta e jetës private, të mbrohen të dhënat personale të magjistratit ose një personi tjetër;
c) kur nga publiku ka shfaqje që prishin zhvillimin normal të seancës dëgjimore.
3. Në seancë dëgjimore para Këshillit:
a) Inspektori i Lartë i Drejtësisë paraqet argumentet që shkelja disiplinore është kryer dhe propozon masat disiplinore që duhet të merren;
b) magjistrati ose përfaqësuesi i tij paraqesin argumentet mbrojtëse.
4. Përmbajtja e parashtrimeve me shkrim nuk përsëritet gjatë seancës dëgjimore.

**Neni 143**
**Shtyrja e seancës dëgjimore**

Këshilli mund të shtyjë seancën kur e konsideron të nevojshme marrjen e provave shtesë por, jo më shumë se një muaj.

**Neni 144**
**Ndryshimi ose shtimi i objektit të procedimit disiplinor**

1. Kur Këshilli çmon se çështja nuk mund të zgjidhet në mënyrë të drejtë dhe të rregullt, pa marrë në shqyrtim një ose disa pretendime të tjera për shkeljen disiplinore ndaj të njëjtit magjistrat, ka të drejtë:
a) të urdhërojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë të ndryshojë ose të shtojë objektin e procedimit disiplinor në përputhje me këtë ligj, si dhe të hetojë këto pretendime të tjera të paktën brenda afatit një mujor;
b) të vendosë mbi pretendimet e ndryshuara ose të shtuara, nëse nuk është i nevojshëm hetim i mëtejshëm, pasi të ketë dëgjuar palët në procedim.
2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vepron sipas parashikimeve të pikës 1 të nenit 136 të këtij ligji.

**Neni 145**
**Pezullimi i procedimit disiplinor**

Parashikimet ligjore gjatë procedimit disiplinor të nenit 126 të këtij ligji do të aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.

**Neni 146**
**Vendimet e këshillit për çështjet e disiplinës**

1. Këshilli merr çdo vendim në lidhje me:
a) angazhimin e ekspertëve dhe përcaktimin e detyrave të tyre;
b) shtyrjet e seancave;

c) pranueshmërinë e provave;
ç) zgjidhjen e çështjes;
d) çdo çështje tjetër që Këshilli e vlerëson të nevojshme ose të përshtatshme në trajtimin e çështjes.
2. Pas shqyrtimit të fakteve dhe provave, Këshilli:
a) rrëzon kërkesën për procedim disiplinor, për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore;
b) pranon kërkesën dhe vendos një ose më shumë masa disiplinore.
3. Këshilli nuk është i detyruar t'i qëndrojë masës disiplinore të propozuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe jep vendim të arsyetuar me shkrim të paktën brenda dy javëve nga përfundimi i seancës.

**Neni 147**
**E drejta e ankimit për vendimet disiplinore**

1. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin për masë disiplinore në gjykatën kompetente.
2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka të drejtë të ankimojë çdo vendim të Këshillit për çështjet disiplinore në gjykatën kompetente.

## KREU IV
## EKZEKUTIMI DHE REGJISTRI I MASAVE DISIPLINORE

**Neni 148**
**Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë**

1. Këshillat marrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e masave disiplinore dhe janë përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të të gjitha masave që vendosen në procedimin disiplinor.
2. Këshillat sigurojnë zbatimin e masave disiplinore:
a) brenda një muaji në rastin e vërejtjes konfidenciale, vërejtjes publike ose uljes së përkohshme të pagës;
b) brenda dy javëve në rastin e uljes në detyrë;
c) brenda një jave në rastin e pezullimit ose shkarkimit nga detyra.

**Neni 149**
**Publikimi i vendimeve disiplinore**

1. Këshilli publikon brenda 2 javëve çdo vendim të formës së prerë për shkarkimin e magjistratëve në faqen zyrtare.
2. Këshilli publikon ekstrakte të çdo vendimi përfundimtar për çështje disiplinore duke përcaktuar rrethanat e fakteve, provat e administruara, vlerën provuese të tyre si dhe llojin e shkeljes disiplinore të kryer sipas këtyre fakteve. Botimi i ekstrakteve duhet të mbrojë të dhënat personale dhe të garantojë mbrojtjen e konfidencialitetit. Në çdo rast në ekstrakt nuk botohet asnjë informacion që mund të tregojë identitetin e magjistratit.

**Neni 150**

**Regjistri disiplinor**

1. Këshilli mban një regjistër për çështjet disiplinore të filluara ndaj magjistratëve, si dhe vendimet e formës së prerë të marra në këto procedime.
2. Këshilli mban të dhëna për të gjitha masat disiplinore në fuqi, përveç "vërejtjes konfidenciale". Masat e tjera disiplinore shuhen dhe fshihen nga regjistri pas kalimit të afateve të mëposhtme nga data e hyrjes në fuqi të masës disiplinore:
a) dy vjet për "vërejtjen publike"dhe trajnimin si masë disiplinore plotësuese;
b) tre vjet për uljen e përkohshme të pagës për rastet kur paga ulet deri në shumën e pagës mujore;
c) katër vjet për uljet e përkohshme të pagës më të larta se shuma e pagës mujore dhe uljen në detyrë;
ç) pesë vite për pezullimin si masë disiplinore.
3. Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra nuk shuhet dhe nuk fshihet nga regjistri.

## KREU V
## PEZULLIMI

### Neni 151
### Pezullimi i detyruar

1. Magjistrati pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit përkatës kur:
a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal "arrest në burg" ose "arrest në shtëpi"
për kryerjen e një vepre penale;
b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje.
2. Pezullimi sipas pikës 1 të këtij neni, zgjat:
a) gjatë periudhës së arrestit në burg ose arrestit në shtëpi, në rastin e parashikuar në pikën 1, të gërmës "a" të këtij neni;
b) deri në pushimin e çështjes penale ose në dhënien e një vendimi të formës së prerë, në rastin e parashikuar në pikën 1, shkronjën "b" të këtij neni.
3. Kryetarët e gjykatave dhe të prokurorive të cilët marrin vendimet përkatëse, detyrohen të njoftojnë Këshillin për faktet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni. Këshilli, menjëherë pasi merr informacionet nga prokuroria ose gjykata, vendos pezullimin për shkak të ligjit të magjistratit.

### Neni 152
### Pezullimi mbi bazë diskrecioni

1. Nëse Këshilli krijon bindjen se qëndrimi në detyrë i magjistratit të akuzuar paragjykon hetimin penal ose disiplinor, pengon përfundimin në mënyrë të drejtë ose të rregullt të hetimit penal ose disiplinor apo diskretiton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit, mund të pezullojë magjistratin nga detyra nëse:
a) ndaj magjistratit ka nisur një hetim penal;
b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të kryer nga pakujdesia;
c) kanë filluar hetimet ose procedimet disiplinore për shkelje disiplinore.

2. Nëse Këshilli krijon bindjen bazuar në provat e mjaftueshme, sipas parashikimeve të nenit 67 të këtij ligji, që magjistrati nuk mund të qëndrojë përkohësisht në detyrë për shkaqe që lidhen me shëndetin fizik ose mendor, mund ta pezullojë nga detyra magjistratin.
3. Në rast se përfundon pezullimi i detyruar, Këshilli mund të vendosë pezullimin e magjistratit në përputhje me këtë ligj.

**Neni 153**
**Fillimi i procedimit të pezullimit**

1. Pezullimi nga detyra i magjistratit, në kuptimin e Nenit 152, mund të vendoset nga një Këshill:
a) me nismën e vet;
b) me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
c) me kërkesë të gjyqtarit ose prokurorit që kanë ndëmarrë veprime ose vendime për rastet e parashikuara pika 1 gërma a dhe b, të nenit 152 të këtij ligji;
ç) me kërkesë të kryetarit të gjykatës ose prokurorisë përkatëse lidhur me çështjet e referuara në pikën 2 të nenit 152 të këtij ligji.

**Neni 154**
**Njoftimet për Këshillin**

1. Kryetari përkatës, informon Këshillin menjëherë me marrjen dijeni të fakteve të renditura në nenet 151 dhe 152 të këtij ligji.
2. Autoritetet përgjegjëse njoftojnë menjëherë Këshillin kur:
a) magjistrati është në arrest në burg ose arrest shtëpie;
b) fillohen hetimet penale ndaj magjistratit;
c) magjistrati merr cilësinë e të pandehurit për një vepër penale;
ç) fillohen hetimet disiplinore.

**Neni 155**
**Vendimet e pezullimit dhe ankimet**

1. Vendimi për pezullimin nga detyra sipas parashikimit të neneve 151 dhe 152 të këtij ligji, merret nga Këshilli brenda tre ditëve pas paraqitjes së kërkesës ose informacionit.
2. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin për pezullimin nga detyra në gjykatën kompetente.
3. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vendimin për pezullimin nga detyra të magjistratit.

**Neni 156**
**Kufijtë e kohëzgjatjes së pezullimit**

1. Pezullimi mbi bazë diskrecioni, sipas nenit 152 të këtij ligji, urdhërohet për një periudhë të caktuar kohe dhe nuk mund të vazhdojë pas:
a) përfundimit të procedimit përkatës disiplinor ose penal që kanë qenë shkak për pezullimin;

b) riaftësimit fizik ose mendor të magjistratit.
2. Këshilli mund të rishikojë pezullimin mbi bazë diskrecioni, të parashikuar në nenin 152 të këtij ligji dhe vendos sipas rastit:
a) ta ndryshojë kohëzgjatjen e pezullimit;
b) ta revokojë pezullimin;
c) të lërë në fuqi pezullimin.

**Neni 157**
**Pezullimi i pagës dhe përfitimeve të tjera**

1. Magjistrati përfiton pagë të plotë gjatë pezullimit, përveç kur parashikohet ndryshe nga përcaktimet e pikave të mëposhtme të këtij neni.
2.Nëse magjistrati dënohet për kryerjen e një vepër penale nga gjykata e shkallës së parë ose jepet masë disiplinore për një shkelje disiplinore nga Këshilli kompentent, Këshilli mund të pezullojë përfitimin e pagës deri në 50%, si dhe përfitimet e tjera të magjistratit, derisa të vendoset mbi çdo ankim të paraqitur në gjykatën më e lartë.
3. Nëse vendimi i dhënë nga gjykata më e lartë është në favor të magjistratit çdo shumë e mbajtur sipas pikës 2 të këtij neni i kthehet menjëherë magjistratit.
4. Nëse vendimi i dhënë nga gjykata më e lartë është në disfavor të magjistratit, shumat e mbajtura sipas pikës 2 të këtij neni vazhdojnë të mbahen deri sa çështja penale ose disiplinore për të cilin është vendosur pezullimi i përfitimit të përfundojë me vendim të formës së prerë.

## KREU VI
## DETYRIMET PENALE DHE CIVILE

**Neni 158**
**Përgjegjësia penale e magjistratëve**

1. Magjistrati mund të ndiqet penalisht sipas dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.
2. Prokuroria, në rast se fillon hetimet penale ndaj magjistratit njofton menjëherë Këshillin respektiv.

**Neni 159**
**Kufizimi i përgjegjësisë civile**

Magjistrati nuk ka përgjegjësi civile për shkak të ushtrimit të funksionit, përveç rastit kur ka treguar të paktën pakujdesi të rëndë.

# PJESA VI
# DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

## KREU 1

## DISPOZITA KALIMTARE

### Neni 160
### Organet kompetente në periudhën kalimtare

1. Deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe inspektoriatet ekzistuese do të vazhdojnë të ushtrojnë kompetencat e mëposhtme sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj:

a) emëron magjistratët kandidatë të diplomuar në vitin 2016 në përputhje me Pjesën III Kreun II, të këtij ligji, të paktën dy muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji;
b) merr vendim për caktimin në pozicion të kandidatëve magjistratë të diplomuar në vitin 2016 sipas Pjesa III, Kreut III të këtij ligji brenda tre muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji;
c) vendos masa disiplinore me propozim të Ministrit të Drejtësisë bazuar në procedurën dhe kriteret që parashikohet në Pjesën V, kreu I i këtij ligji;
ç) pezullon gjyqtarët sipas procedurës dhe kritereve të parashikuara në ligj;
d) mbikëqyr trajnimin e gjyqtarëve, sipas këtij ligji dhe ligjit "Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë";
dh) kryen vlerësimin e punës siç parashikohet në dispozitën kalimtare të këtij ligji, duke përfshirë edhe ndihmën në rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve në bazë të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";
e) vendos masa disiplinore për inspektorët bazuar në aktet nënligjore në fuqi;
ë) vërteton ndërprerjen e emërimit në rast dorëheqje dhe arritjes së moshës së pensionit;
f) transferon përkohësisht gjyqtarë për plotësimin e trupave gjyqësore në gjykata.
2. Deri në krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm do të vazhdojë të ushtrojë kompetencat e mëposhtme sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj:
a) emëron magjistratët kandidatë të diplomuar në vitin 2016 në përputhje me Pjesën III Kreun II, të këtij ligji, të paktën dy muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji;
b) merr vendim për caktimin në pozicione të kandidatëve magjistratë të diplomuar në vitin 2016 sipas Pjesa III, Kreut III të këtij ligji brenda tre muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji;
c) pezullon prokurorët sipas procedurës dhe kritereve të parashikuara në ligj;
ç) mbikëqyr trajnimin e prokurororëve, sipas këtij ligji dhe ligjit "Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë;
d) kryen vlerësimin e punës siç parashikohet në dispozitën kalimtare të këtij ligji, duke përfshirë edhe ndihmën në rivlerësimin kalimtar të prokurorëve në bazë të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";
dh) vërteton mbarimin e emërimit në rast dorëheqje dhe arritjes së moshës së pensionit.
3. Caktimi në pozicione të përhershme të magjistratëve sipas parashikimeve të këtij ligjit, do të kryhet me ngritjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
4. Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Prokurori i Përgjithshëm mund të vendosin caktimin në pozicione të përkohshme të magjistratëve për të mundësuar ushtrimin e detyrave dhe funksionimin e institucioneve të drejtësisë.
5. Deri në krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Prokurori i Përgjithshëm heton shkeljet disiplinore nëpërmjet inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm bazuar në procedurën dhe kriteret e Pjesa V dhe dispozitës kalimtare të këtij Ligji.

**Neni 161**
**Dispozita kalimtare për magjistratët në Gjykatën e Lartë**

1. Gjyqtari në detyrë i Gjykatës së Lartë do të konsiderohet magjistrat sipas këtij ligji.
2. Anëtarët e Gjykatës së Lartë vazhdojnë të ushtrojnë detyrën e tyre sipas mandatit të mëparshëm, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit në zbatim të Pjesës III, Kreut VIII të këtij ligji, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".
3. Kryetari në detyrë vazhdon të ushtrojë detyrën si Kryetar për një periudhë shtesë prej dy vjetësh pas hyrjes në fuqi të këtij ligjit, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe të tjera ligjore për mbarimin e mandatit ose si rezultat i procesit të rivlerësimit në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".
4. Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë të zgjedhur nga Kuvendi nga radhët e gjyqtarëve konsiderohen gjyqtarë të ngritur në detyrë sipas këtij ligji. Gjyqtarët e zgjedhur nga Kuvendi nga radhët e juristëve konsiderohen anëtarë jo gjyqtarë sipas këtij ligji. Për plotësimin e vendeve vakante të krijuara zbatohet parashikimi i nenit 136 pika 3 e Kushtetutës së RSH-së lidhur me raportin e anëtarëve gjyqtarë dhe jo gjyqtarë.

**Neni 162**
**Dispozita kalimtare për Gjykatat e Krimeve të Rënda**

1. Gjyqtari në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ose Gjykatën e Apelit për Krimeve të Rënda, qëndron në pozicionin e tij deri në momentin e krijimit të Gjykatave të Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit në zbatim të Pjesës III, Kreut VIII, të këtij ligji ose si rezultat i procesit të rivlerësimit në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".
2. Këshilli i Lartë Gjyqësor cakton në mënyrë të përhershme gjyqtarët në detyrë në Gjykatën e Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, me kërkesë të tyre nëse:
a) gjyqtari kalon me sukses procesin e rivlerësimit sipas përcaktimeve të ligjit "Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";
b) përmbush kriteret për ngritjen në detyrë sipas përcaktimeve të nenit 47 të këtij ligji;
c) gjyqtari si dhe familjarët e afërm të tij japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake sipas ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".
3. Nëse ndaj gjyqtarit në detyrë të Gjykatës së Krimeve të Rënda ka filluar procesi i rivlerësimit në shkallë të parë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendim të formës së prerë dy javë pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë Gjyqësor cakton gjyqtarin përkohësisht në nivelin përkatës në Gjykatën e Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar me kusht që ai, si dhe familjarët e afërm të tij të japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake sipas ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".

4. Në rast se ndaj gjyqtarit të caktuar përkohësisht, me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit vendoset masë disiplinore në bazë të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, caktimi i përkohshëm i tij mbaron pavarësisht nëse është bërë ose jo ankim ndaj këtij vendimi.
5. Gjyqtarët në detyrë pranë gjykatave të krimeve të rënda do të transferohen në gjykata të tjera, në rast se ata ose familjarët e tyre të afërt nuk japin pëlqimin për rishikimin periodik të llogarive të tyre financiare dhe telekomunikimeve vetjake. Gjyqtari ka të drejtë të zgjedhë ndërmjet tre pozicioneve që janë të lira sipas rregullave të parashikuara në nenin 60 të këtij ligji.
6. Kryetari në detyrë i Gjykatës së Krimeve të Rënda të shkallës së parë dhe të Apelit, qëndron në detyrë deri në zgjedhjen e kryetarit të ri të Gjykatës së Posaçme, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit në zbatim të Pjesa III, kreut VIII, të këtij ligji ose si rezultat i procesit të rivlerësimit në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
7. Këshilli i Lartë Gjyqësor ngre në detyrë pa vonesë gjyqtarët që kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit në një pozicion të lirë në Gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar me qëllim për të siguruar numrin minimal të gjyqtarëve të përcaktuar për këto gjykata në ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

**Neni 163**
**Dispozita kalimtare për Prokurorët e Prokurorisë për Krimet e Rënda**

1. Prokurori në detyrë në Prokurorinë e krimeve të rënda të shkallës së parë ose të apelit, qëndron në pozicionin e tij deri në momentin e krijimit të Prokurorisë së Posaçme, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit në zbatim të Pjesa III, Kreut VIII, të këtij ligji ose si rezultat i procesit të rivlerësimit në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Këshilli i Lartë Prokurorisë cakton në mënyrë të përhershme prokurorët në Prokurorinë e Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, në përputhje me parashikimet e ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

**Neni 164**
**Dispozitat kalimtare për Magjistratët e gjykatave dhe prokurorive të tjera**

1. Gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në këtë ligj vetëm nëse:
a) nuk kanë shkaqe të mbarimit të statusit të magjistratit ose mandatit të tyre në zbatim të Pjesës III, Kreut VIII, të këtij ligji;
b) kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Kryetarët e gjykatave dhe prokurorive vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë si kryetar deri 9 muaj pas ngritjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

**Neni 165**

**Dispozita kalimtare për ndihmësit ligjorë, këshilltarët e gjyqtarëve dhe inspektorët, jo-magjistratë**

1. Këshilltari i gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësi ligjor pranë Prokurorisë e Përgjithshme dhe në Gjykatat Administrative si dhe inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqtarit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimit në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".
2. Subjektet e parashikuar në pikën 1 të këtij neni vazhdojnë të qëndrojnë përkohësisht në detyrë në përputhje me parashikimet ligjore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".
3. Ish këshilltari i gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe pranë Gjykatës së Lartë, nëse ka të paktën pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës duke përfshirë të paktën tre vjet si këshilltar i gjyqtarit ose ndihmës ligjor në këto gjykata mund të kërkojë t'i nënshtrohen procesit të rivlerësimit në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".
4. Subjektet e parashikuara në pikën 1 dhe 3 të këtij neni, të cilët kanë arritur të paktën 60% të pikëve të testit të aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës, sipas parashikimeve të ligji "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kanë të drejtë:
a) të ndjekin programin teorik një vjeçar të Shkollës së Magjistraturës;
b) të caktohen brenda afatit 1 mujor pas përfundimit të programit trajnimit për një vit për të kryer praktikë profesionale në gjykata ose prokurori të ndryshme, duke zbatuar parashikimet e nenit 33 të këtij ligji, për aq sa gjejnë zbatim;
c) të përfitojnë gjatë periudhës dy vjeçare të trajnimit të parashikuar në gërmën "a" dhe "b" të kësaj pike, respektivisht pagë të barabartë me pagën e ndihmësit ligjor, inspektorit ose këshilltarit të gjyqtarit.
5. Ndihmësi ligjor, inspektori dhe këshilltar i gjyqtarit, në kuptim të pikës 4 të këtij neni, marrin pjesë në provimin përfundimtar në përmbyllje të vitit të tyre të parë në Shkollën e Magjistraturës. Ata caktohen për praktikë profesionale dhe vlerësohen gjatë saj në përputhje me nenin 33 të këtij ligji.
6. Në përfundim të trajnimit dy vjeçar, ndihmësi ligjor, inspektori dhe këshilltar i gjyqtarit, në zbatim të pikës 4 të këtij neni renditen sipas rezultateve të provimit përfundimtar në fund të vitit të parë dhe të vlerësimit etik dhe profesional gjatë praktikës profesionale. Ata përfshihen në listën e renditjes dhe emërohen si magjistratë sipas parashikimeve të këtij ligji, nëse marrin të paktën 70% të pikëve maksimale të mundshme në provimin përfundimtar në fund të vitit të parë, si dhe janë vlerësuar të paktën "mirë" për të gjitha detyrat e dhëna gjatë praktikës profesionale.
7. Shkolla e Magjistraturës miraton rregullat për procedurën dhe kushtet për pjesëmarrjen në provimin përfundimtar, kurrikulën dhe pjesëmarrjen në kurset e trajnimit.
8. Nëse ndihmësi ligjor, inspektori, dhe këshilltari i gjyqtarit në kuptim të këtij neni kalon me sukses procesin e rivlerësimit, marrëdhënia e punës së tij mbaron në datën e fillimit të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës në zbatim të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH". I njëjti rregull zbatohet edhe për ata të cilët nuk kanë përfunduar ende procesin e rivlerësimit, por kanë kaluar me sukses testimin e aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës në kuptim të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve".

Në rast se institucioni për rivlerësimin merr vendim për masën e shkarkimit, ndërpritet ndjekja e programit të trajnimit dhe subjekti përjashtohet nga programi i trajnimit.
9. Nëse ndihmësi ligjor, inspektori dhe këshilltari i gjyqtarit në detyrë kalon me sukses procesin e rivlerësimit, por nuk ndjek fushën e karrierës së magjistratit, ka të drejtë për t'u caktuar në një pozicion si nëpunës civil në sistemin e prokurorisë ose nëpunës civil gjyqësorë në sistemin gjyqësor që i përshtatet më së miri profilit të tij aktual dhe për të cilin përmbush kriteret. Kërkesa për caktim në pozicion paraqitet respektivisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë brenda një muaj pas publikimit të rezultatit të testimit të Shkollës së Magjistraturës. Në këtë rast marrëdhënia e punës së ndihmësit ligjor, inspektorit dhe këshilltarit të gjyqtarit në detyrë mbaron në ditën e paraqitjes së kërkesës. Ky rregull nuk zbatohet për këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë të cilët vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë, nëse kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit sipas parashikimeve ligjore.

**Neni 166**
**Dispozitat kalimtare ish gjyqtarë dhe ish prokurorë**

1. Kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurën e rivlerësimit, personat të cilët janë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës dhe që kanë ushtruar funksionin si magjistrat të paktën për tre vjet, ose personat që kanë ushtruar funksionin e magjistratët për 9 vjet, në 20 vitet e fundit duke përfshirë gjyqtarët në një Gjykatë Ndërkombëtare, Gjykatë të Lartë, Gjykatë Kushtetuese.
2. Kriteret që duhet të përmbushin subjektet e parashikuar në pikën 1 të këtij neni:
a) të mos jenë shkarkuar për shkelje disiplinore ose kryerjen e veprës penale;
b) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose funksione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji;
c) të mos kenë qënë anëtar, bashkëpunëtor ose të favorizuar nga sigurimi i shtetit para vitit 1990;
ç) të mos kenë qenë bashkëpunëtor, informator ose agjentë të ndonjë shërbimi sekret.
3. Brenda dy viteve pas kalimit me sukses të procesit së rivlerësimit, subjektet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, riemërohen si magjistratë. Ata kanë të drejtën për t'u caktuar në një pozicion për të cilin përmbushin kriteret sipas nenit 47 të këtij ligji, si dhe kandidojnë në procedurat e ngritjes në detyrë për pozicione për magjistratë ose për pozicione të komanduara ose pozicione që mund të ushtrohen vetëm nga magjistratët.
4. Përvoja profesionale në institucionet e drejtësisë, në të cilat mund të komandohen magjistratët sipas procedurave të këtij ligji, konsiderohet përvojë profesionale si magjistrat.
5. Në rast se subjektet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni nuk i janë nënshtruar vlerësimit etik dhe profesional, ata i nënshtrohen vlerësimit profesional në kuptim të nenit 49 të këtij ligji.
6. Anëtari i Kolegjit të Apelit emërohet si gjyqtar në nivel apeli në përfundim të mandatit, përveç rasteve kur ndaj tij është dhënë masë disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës.

**Neni 167**
**Dispozita kalimtare për magjistratët e komanduar në institucione të tjera**

1. Për magjistratin e komanduar në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të zbatohen dispozitat e këtij ligji për aq sa është e mundur.

2. Magjistrati i komanduar me vendim të institucioneve të tjera, sipas parashikimeve të ligjit të mëparshëm, afati i komandimit të të cilit mbaron para krijimit të Këshillave, kthehet në vendin e mëparshëm të punës.
3. Koha e komandimit përfundon sipas afateve të përcaktuara në vendimin e komandimit të institucionit përkatës, përveç rasteve kur:
a) magjistrati kërkon brenda një muaji nga krijimi i Këshillave, që të mbarojë detyrën në pozicionin e komanduar përpara mbarimit të afatit;
b) ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit në zbatim të Pjesës III kreut VIII, të këtij ligji ose si rezultat i procesit të rivlerësimit në përputhje me ligjin për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
4. Nëse magjistrati kërkon përsëritjen e periudhës së komandimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendos sipas parashikimeve të këtij ligji.
5. Magjistrati i komanduar, i nënshtrohet procesit të rivlerësimit në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorive në Republikën e Shqipërisë".

**Neni 168**
**Dispozita kalimtare për inspektorët me statusin e gjyqtarit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë**

1. Inspektori dhe Kryeinspektori në detyrë, të cilët kanë statusin e gjyqtarit dhe ushtrojnë funksionet në Këshillin e Lartë të Drejtësisë me hyrjen në fuqi të këtij ligji, konsiderohen magjistratë dhe ndaj tyre zbatohen dispozitat e këtij ligji. Ata i nënshtrohen procesit të rivlerësimit në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".
2. Inspektori vazhdon të ushtrojë detyrën e tij sipas mandatit të mëparshëm, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit në zbatim të Pjesës III, Kreut VII, të këtij ligji ose si rezultat i procesit të rivlerësimit në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Inspektori në detyrë sipas këtij neni mandati i të cilit mbaron para krijimit të Këshillave ka të drejtë të kthehet në pozicionin e mëparshëm ose të vazhdojë në detyrë edhe 6 muaj pas krijimit të Këshillave. Ai ka të drejtë të kandidojë në procedurën për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë në kuptim të këtij ligji.
3. Inspektorët në detyrë sipas këtij neni, që janë caktuar kryesisht për kryerjen e hetimeve disiplinore vazhdojnë të ushtrojnë detyrën e inspektorit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe konsiderohen si të komanduar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në kohën e krijimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Inspektorët në detyrë, të cilët janë caktuar kryerisht për kryerjen e vlerësimin etik dhe profesional konsiderohen si të komanduar përkatësisht në Këshillin e lartë të Drejtësisë dhe përkatësisht në Këshillin e Lartë Gjyqësor, duke asistuar Këshillin në ushtrimin e funksionit për vlerësimin etik dhe profesional.

**Neni 169**
**Dispozita kalimtare për të drejtat dhe detyrimet e magjistratëve**

1. Pjesa mbi të drejtat dhe detyrimet e magjistratit zbatohet menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij ligji, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë nen.

2. Magjistrati ka detyrim që brenda 3 muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë të marrë masat për të përmbushur kërkesat në lidhje me papajtueshmërinë dhe kufizimet në detyrë sipas neneve 6 dhe 7 të këtij ligji.
3. Magjistrati informon për gjendjen e papajtueshmërisë ambientale brenda një muaji nga krijimi i Këshillave respektivë.
4. Magjistrati njofton për detyra jashtë funksionit për të cilat duhet marrë leje në përputhje me këtë ligj brenda një jave nga hyrja në fuqi e këtij ligji nëse vazhdon të kryejë detyrën dhe kërkon leje pa vonesë për aktivitetet e ardhshme jashtë funksionit të tij.
5. Pjesa II, kreu III, e këtij ligji për pagat dhe për përfitime të tjera është i zbatueshëm për magjistratin i cili kalon me sukses procesin e rivlerësimit siç përcaktohet nga ligji “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pavarësisht kësaj në asnjë rast jo më shpejt se 1 Janar 2019. Përjashtim nga ky rregull bëjnë magjistratët në institucionet për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar të cilët përfitojnë pagat dhe përfitimet e tjera sipas këtij ligji me caktimin në mënyrë të përhershme në këtë pozicion. Gjatë periudhës së rivlerësimit, për magjistratin i cili ende nuk është rivlerësuar, do të zbatohen parashikimet ligjore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji në lidhje me pagat dhe përfitime të tjera.
6. Magjistrati që ka kaluar procesin e rivlerësimit pas datës 1 janar 2019, gëzon të drejtën për të marrë diferencën mes pagës dhe përfitimeve të tjera sipas parashikimeve ligjore të zbatueshme para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe pagës dhe përfitimeve të tjera sipas parashikimeve të këtij ligji, brenda tre muajve nga vendimi i formës së prerë të rivlerësimit.

**Neni 170**
**Dispozitat kalimtare në lidhje me fazën e rekrutimit të kandidatëve magjistratë**

1. Parashikimet e Pjesës III, Kreut I të këtij ligji do të zbatohen për procesin e pranimit për vitin akademik që fillon jo më vonë se 8 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Kriteri për kalimin e provimit të shtetit do të zbatohet për magjistratët kandidatë, të cilët kandidojnë për pranim në Shkollën e Magjistraturës, pas hyrjes në fuqi të ligjit që rregullon kriteret dhe procedurat e provimit të shtetit.

**Neni 171**
**Dispozitë kalimtare për vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve**

1. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, përfundon vlerësimin e gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit për periudhën 2007 – 2009 dhe 2010 – 2012 bazuar në rregullat ekzistuese para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit në këtë periudhë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë publikon një raport në pajtim me nenin 98 të këtij ligji brenda tre muajve.
2. Menjëherë me ngritjen e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Apelimit, Këshillat duhet të mbështesin këto organe për realizimin e vlerësimit të aftësive profesionale në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” duke ndjekur udhëzimet dhe kërkesat e këtyre organeve. Dhënia e ndihmës për këto organe ka përparësi.
3. Në të njëjtën kohë me vlerësimin etik dhe profesional të periudhave 2007-2009, 2010 – 2012, Këshillat duhet të vlerësojnë magjistratët për periudhën e përcaktuar në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

4. Këshilli përzgjedh në mënyrë rastësore çështjet në përputhje me parashikimet e nenit 91 të këtij ligji dhe analizon dokumentet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit në zbatim të Ligjit "Për rivlerësimin Kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Këshilli gjithashtu përzgjedh në mënyrë rastësore edhe 5 dosje të subjektit të rivlerësimit në prani të një Komisioni të Pavarur të Kualifikimit. Këshilli paraqet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit të gjitha dokumentet së bashku me një raport analizues të dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti rivlerësimit si dhe 5 dosjet e përzgjedhura në mënyrë rastësore në respektim të kërkesave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Këshilli, me kërkesë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, paraqet dokumentacion të mëtejshëm. Këshilli ndjek listën sipas rradhës së kërkuar nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit.
5. Pas vlerësimit të aftësive profesionale të kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në kuadër të procesit e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ose Kolegji i Apelimit në rast se është ushtruar e drejta e ankimit i dërgon Këshillit, dosjen me vlerësimin e kryer të magjistratit, çdo dokument të përdorur në vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe vendimin e formës së prerë të procesit të rivlerësimit. Nëse magjistrati kalon me sukses procesin e rivlerësimin, Këshillat vazhdojnë të bëjnë vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve në zbatim të ligjit për aq sa është e mundur, me qëllim që të përcaktojnë gradën e vlerësimit përkatëse.
6. Vlerësimi etik dhe profesional i kryetarit në cilësinë e këtij funksioni do të realizohet në mënyrë të pavarur nga procesi i rivlerësimit dhe do të kryhet paralelisht. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë brenda tre muajve nga krijimi i tyre, miratojnë programin duke listuar magjistratët që vlerësohen në cilësinë e kryetarit në pajtim me këtë ligj. Në përgatitje të këtij programi do të mbahen parasysh raportet për punën e kryetarit, rishikuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë sipas parashikimeve të nenit 30/1, pika 4, të ligjit Nr. 8811 datë 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar.
7. Periudha e vlerësimit pas vlerësimit etik dhe profesional të kryer në kuadër procesit të rivlerësimin do të jetë periudha e përcaktuar në nenin 84 të këtij ligji. Këshilli fillon procedurën për vlerësimin etik dhe profesional për periudhën respektive, brenda vitit kalendarik, që ndjek vitin e mëparshëm, i cili është mbuluar nga periudha e vlerësimit të mëparshme.
8. Të dhënat statistikore përpunohen nga gjykata ose prokuroria ku ushtron detyrën magjistrati që do vlerësohet si dhe dërgohen nga kryetari tek Këshilli përkatës, deri në momentin që Këshillat kanë akses të drejtpërdrejtë në të dhënat e sakta dhe të sigurta statistikore në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve në gjykata dhe në prokurori. Të dhënat statistikore për magjistratin që është në proces vlerësimi i dërgohen Këshillit respektiv nga kryetari i gjykatës ose i prokurorisë, në të cilën magjistrati ka ushtruar detyrën gjatë periudhës për të cilën kryhet vlerësimi. Këshilli përcakton me vendim kohën dhe procedurat e marrjes drejtpërdrejtë të të dhënave statistikore nga sistemi.
9. Treguesi i numri të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikat mundësohen në mënyrë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve identifikohet dhe vlerësohet vetëm në lidhje me çështjet e zgjedhura me short.
10. Deri në përdorimin e shortit elektronik, shorti sipas nenit 91 të këtij ligji do të pasqyrohet në procesverbal që do të nënshkruhet nga të gjithë të pranishmit dhe bëhet pjesë e dosjes së vlerësimit.

**Neni 172**
**Dispozita kalimtare për procedimet disiplinore**

1. Hetimet disiplinore të papërfunduara në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nga Ministria e Drejtësisë, Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe inspektorët në Zyrën e Prokurorisë së Përgjithshme, përfundohen brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas dispozitave në fuqi para hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Procedimet disiplinore të papërfunduara në Këshillin e Lartë të Drejtësisë ose në Prokurorinë së Përgjithshme në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji kryhen brenda afatit 6 mujor pas hyrjes në fuqi e këtij ligji. Organet përgjegjëse sipas nenit 160 të këtij ligji, zbatojnë rregullat proceduriale të parashikuara në këtë ligj.
3. Për shkeljet disiplinore të parashikuara sipas këtij ligji, që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të tij, dhe që parashikoheshin si të tilla në kohën e kryerjes së tyre, do të zbatohen dispozitat e këtij ligji, me përjashtim të parashikimeve të pikëve 1 dhe 2 të këtij neni.
4. Organet kompetente për procedimin disiplinor zbatojnë parimin e zbatimit të ligjit më të favorshëm për magjistratin që ka kryer shkeljen disiplinore.

## KREU II
## DISPOZITA TË FUNDIT

### Neni 173
### Shfuqizime

1. Ligji nr 8811. Datë 17.05.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë" shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji, me përjashtim të neneve si më poshtë:
Neni 2 shkronjat "b", "ç", "d", "dh";
Nenet 3, 4, 5, neni 6 pika 3, neni 7 pika 1, neni 8 pikat 1 dhe 2, nenet 9, 10, 11, 12, 13, 17, 18, 19, 20, 22, 23, 24, 25, 26 dhe 27 të Ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001 "Për organzimin dhe funksionimin dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë".
2. Ligji Nr. 8811 datë 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimit e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", shfuqizohet në tërësi menjëherë pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
3. Deri në zbatimin e sistemit të ri të pagave dhe përftiimeve të tjera për magjistratët sipas parashikimeve "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokorëve në RSH" që hyn në fuqi në datën 1 janar 2019, do të qëndrojnë në fuqi dispozitat sa më poshtë:
a) Rregullimet e parashikuara në nenet 26 dhe 27 për pagat e gjyqtarëve të ligjit Nr. 9877, datë 18.02.2008 "Mbi organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
b) Rregullimet e parashikuara në nenin 22 të ligjit për 8588 datë 15.03.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gykatës së lartë;
c) Rregullimet e parashikuara në nenin 9 të Ligjit Nr. 9110, datë 24/07/2003 "Për organizimin dhe funksionimin e të gjykatës së krimeve të rënda"
d) Rregullimet e parashikuara në nenin 52 të Ligjit Nr.8737, datë 12.02.20013 "Për organizimin dhe funksionimin e zyrës së Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

### Neni 174
### Aktet nënligjore

1. Ngarkohen Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë të miratojnë rregullat e detajuara sipara parashikimeve dhe afateve të këtij ligji.
a) brenda tre muajve nga krijimi i Këshillave, aktet që lidhen me aktivitete jashtë funksionit, krijimin e dosjeve personale, caktimin e përkohshëm në detyrë i të emëruarve të rinj në pozicione të komanduara, magjistratët në skemën e delegimit, ngritjen në detyrë në nivele më të larta ose të specializuara, emërimin e anëtarëve jogjyqtarë të Gjykatës së lartë, emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm, dhe caktimet në pozicionet e përkohshme.
b) brenda një viti nga krijimi i Këshillit, aktet e tjera.
2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë aktet nënligjore brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi këtij ligji, në zbatim të neneve 17 pika 7 dhe 20 pika 2 të këtij ligji.
3. Ngarkohet Inspektori i Lartë i Drejtësisë të miratojë akte nënligjore brenda tre muajve nga krijimi i tij, në zbatim të nenit 137 pika 3 e këtij ligji.
4. Ngarkohet Shkolla e Magjistraturës të miratojë aktet nënligjore brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi këtij ligji.
5. Deri në miratimin e akteve nënligjore, parashikimet e këtij ligji do të zbatohet rast pas rasti.
6. Çdo akt nënligjor i miratuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji zbatohet për sa nuk bie në kundërshtim me këtë ligj.

**Neni 175**
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**ILIR META**